



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 21 MAJ 2015**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 21. MAJA 2015. GODINE**

**MAJ - MAJ
2015**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat personale,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave,
6. Shqyrtimi i raportit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2014,
7. Shqyrtimi i raportit të Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2014.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja izvan dnevnog reda,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona o porezu na lični dohodak,
5. Prvo razmatranje Nacrta zakona o porezu na dohodak korporacija,
6. Razmatranje izveštaja Agencije za mendžiranje memorijalnih kompleksa Kosova za 2014. godinu,
7. Razmatranje izveštaja Sudskog instituta Kosova za 2014. godinu.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta, diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjat deri në 5 minuta, ndërsa diskutimi i deputetit deri në 3 minuta. Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarohen se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën.

Deri më tani kemi të lajmëruar Labinotë Demi-Murtezi për fjalë. Urdhëro, zonja Labinotë!

LABINOTË DEMI-MURTEZI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ngjarja që tronditi qytetarët e Kumanovës vazhdon të mbetet po aq tronditëse edhe pas 10 ditësh që ka ngjarë. Qytetarëve të Kumanovës ende nuk u janë tharë lotët.

E kam vizituar Lagjen e Trimave para dy ditësh, ngase si bashkëkombëse e tyre kam përgjegjësi të dyfishtë edhe për lidhjet fafëfisnore që kam me shumë prej banorëve të asaj lagjeje, por jo vetëm unë, por edhe shumë qytetarë të tjerë të qytetit të Gjilanit.

Aty mbretëronte një pasiguri e madhe. Shumë prej tyre kishin humbur krejt çka kanë pasur, dhe jo vetëm kaq. Ata tashmë janë barrë e fqinjëve e familjarëve të tyre për strehim, derisa Qeveria e vendit të fillojë të ndërmarrë ndonjë hap konkret për t'i ndihmuar ata.

Unë e respektoj vendimin e Kuvendit që debati për Kumanovën të bëhet atëherë kur do t'i kemi parakushtet gati. Jam e vetëdijshme se duhet të jemi të përmbytur përkohësisht për të mos i penguar hetimet rreth rastit. Mirëpo, gjendja e atyre qytetarëve të lënë komplet pas dore nuk pret.

U mungon ushqimi, veshmbathjet, ilaçet, e çka jo tjetër, ngase mbi 30 shtëpi ishin të shkatërruara të tëra e shumë të tjera ishin tepër të dëmtuara. Era shkrumb gjithandej ua zinte frymën, ata tashmë kishin filluar t'i largonin vetë pjesët e dëmtuara të shtëpive të tyre. Frika për ndonjë sëmundje ngjitëse u rrinte mbi kokë.

Andaj, konsideroj se Kosova si shtet ka mundësi të ndërmarrë hapa konkretë me kontingjente ndihmesh të ndryshme për t'ua zbutur gjendjen sadopak.

16 vjet më parë, ato familje dhe ato shtëpi ishin përplot me kosovarë të dëbuar nga vatrat e tyre. Kjo na jep një përgjegjësi shtesë që ne të veprojmë konkretisht dhe sa më shpejt, qoftë nëpërmjet

Kryqit të Kuq si organizatë me shtrirje ndërkombëtare, qoftë edhe me fonde konkrete, nëse ekziston mundësia, nëpërmjet Qeverisë sonë.

E di se askush prej nesh nuk ndihet mirë të rri duarkryq përballë kësaj situatë, po ashtu e pashë shumë të nevojshme çdo iniciativë të mundur për vëllezërit tanë dhe motrat tona atje.

Andaj po e ngre këtë çështje në Kuvend sot që bashkë t'i përpunojmë idetë dhe mundësitë dhe t'i ndihmojmë ashtu siç jemi të obliguar moralisht. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ndërkohë Blerim Grainca e ka kërkuar fjalën.

BLERIM GRAINCA: Zoti kryetar!

Të nderuar kolegë,

Jam sot këtu para jush që ta përcjell dhe ta ngre edhe një herë një shqetësim, një problem që lidhet me çështjen e punëtorëve të Fabrikës së Gypave.

Sikur e dini dhe sikur jeni të njoftuar, punëtorët e Fabrikës së Gypave nga Ferizaj ka kohë që janë duke e bërë një protestë, një grevë këtu në tendën pranë Kuvendit dhe pranë Qeverisë së Republikës së Kosovës, e që lidhet me kërkesën e tyre për pagesën e borxhit që ata konsiderojnë se u takon në bazë të vendimit të gjykatës.

Të nderuar kolegë,

Dje, punëtorët e Fabrikës së Gypave si pjesë të protestës dhe skenarit të tyre kanë hyrë edhe në ndërtesën e Kuvendit të Komunës së Ferizajt për ta vazhduar grevën aty, në mënyrë që ta sensibilizojnë opinionin, deputetët e Ferizajt dhe Qeverinë lidhur me problemet që kanë.

Në takimin që unë kam pasur dje me ta, ata e kanë përsëritur një kërkesë të cilën e kemi nënshkruar edhe ne deputetët më herët për një takim urgjent me kryeministrin e Republikës së Kosovës, me qëllim që të diskutohet ky problem një herë e përgjithmonë t'i jepet një kahje.

Si kërkesë urgjente e punëtorëve të Fabrikës së Gypave dhe kërkesë besoj edhe e kolegëve deputetë nga Ferizaj, në këtë rast, është që urgjentisht të formohet Bordi i Agjencisë së Privatizimit, në mënyrë që ky problem të trajtohet në rrugë ligjore, në rrugë që i takon.

Unë nuk dua ta bëj një kronologji të problemit, sepse ju e dini se të gjithë ata punëtorë e kanë një vendim të gjykatës, ata punëtorë e kanë një vendim të këtij Kuvendi nga viti 2014, e kanë një vendim të Qeverisë të kaluar dhe, megjithatë, deri më tani nuk kanë pasur mundësi t'i realizojnë të drejtat e tyre.

Unë ju lus edhe një herë kolegë deputetë që të solidarizoheni me këtë problem. I bëj apel Qeverisë që sa më shpejt t'i presë dhe t'i takojë ata dhe njëkohësisht apeloj që sa më shpejt të bëhet Bordi i Agjencisë, në mënyrë që ky problem të marrë rrugë të drejtë dhe kështu njëherë e përgjithmonë këta punëtorë të largohen nga rruga, sepse po bëhet një vjet që janë aty. Familjet e tyre janë të stresuara, po vuajnë dhe gjendja e tyre shëndetësore gjithnjë e më shumë po vështirësohet.

Prandaj, për të mos ju marrë kohë, siguroj se deputetët e Ferizajt janë në mbështetje të kërkesës së tyre për një takim dhe ju siguroj se janë në mbështetje për formimin e Bordit të Agjencisë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fatmir Rexhepi e ka kërkuar fjalën.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje kolegë deputetë,

Përshëndetje ministra të Kabinetit qeveritar,

Duke u nisur nga shqetësimet, por edhe kërkesat e mëhershme në zonën e trekëndëshit që përfshin Karadakun, e cila ka banorë kryesisht me shqiptarë Kumanovë-Shkup-Gjilan. Është kërkesa më e hershme që mendoj t'i shtrohet edhe sot Qeverisë për ta hapë pikën kufitare në Stançiq ndërmjet dy shteteve, pra Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Kosovës, e cila është më se e nevojshme për këta qytetarë, në mënyrë që ata të kenë lëvizje të lirë dhe t'u mundësohet atyre qytetarëve, që shumë më shpejt të komunikojnë me qytetarët në këtë trekëndësh, në këtë hapësirë të trevave të cilat ata banojnë.

Është me shumë rëndësi, sepse ne i kemi edhe pika të ngjashme kufitare të hapura edhe me Serbinë, edhe me Shqipërinë. Tani në kohë të fundit, për Maqedoninë i kemi vetëm dy. Prandaj, mendoj që kjo zonë e Karadakut ka nevojë të madhe që të hapet kjo pikë administrative, e cila fillimisht duhet të bisedohet me Qeverinë e Maqedonisë, prandaj Qeveria e vendit e shikon se çfarë logjistike i duhet kësaj pike kufitare, në mënyrë që t'i bëjë përgatitjet gjatë takimit me Qeverinë e Maqedonisë, të fillojë nga ky vit dhe diku në verën e vitit të ardhshëm ta hapin këtë pikë kufitare, ta përgatitin gjithë logjistikën me ato investimet që kërkohen. Sigurisht nuk është një kosto e madhe, por kjo i takon më shumë Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë për Integrim, Ministrisë së Financave dhe Qeverisë që ta ndërmarrin një hapë të tillë dhe unë mendoj që me këtë do ta kryejë një punë të madhe për arsye se kjo është me interes, edhe ekonomik, edhe social, por edhe politik për këtë trevë, e cila në asnjë regjim nuk ka gëzuar ndonjë të mirë nga ajo që ka pasur nevojë si qytetarë dhe si trevë për t'u zhvilluar edhe në pikëpamje administrative, që do të thotë komunikimi me qytetarë.

Prandaj, edhe një herë po e shtroj këtë kërkesë, në mënyrë që Qeveria jonë ta shqyrtojë me prioritet në takimin e parë dhe t'u mundësojë këtyre qytetarëve hapjen e pikës kufitare, pra pikës administrative që do të mundësonte një impakt më të madh zhvillimit ekonomik dhe social të kësaj treve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ndërkohë Ismajl Kurteshi e ka fjalën, po Ismajl je në rend tash. Më vjen keq, tash Administrata do ta konfirmojë, e kam porositur me ju sjell edhe ..

ISMAJL KURTESHI: Këtë Kuvend kryetar askujt baba s'ia ka bërë, prandaj është mirë të respektohen rregullat, procedurat dhe njëfarë rendi, e jo kujt t'i teket kështu të bëjë çfarë të dojë.

Megjithatë, gjatë qëndrimit dyditor në Mal të Zi, Komisioni për Parlamentar i Arsimit e vizitoi Ulqinin, Tuzin, Gucinë, Plavën, Rozhajën dhe Podgoricën.

Gjatë kësaj kohe u takuam me kryetarët e Komunës së Ulqinit dhe Këshillit Kombëtar të Malit të Zi, si dhe përfaqësuesit e Tuzit, Gucisë, Plavës dhe Rozhajës.

Në takimin me Këshillin Kombëtar Shqiptar në Mal të Zi u tha se shqiptarët përbëjnë mbi 5% të popullatës së Malit të Zi dhe se atje jetojnë mbi 30 mijë shqiptarë, por shqiptarët atje përballen me shumë probleme të natyrës politike dhe ekonomike.

Në katër shkolla të mesme dhe 12 shkolla fillore, ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhën shqipe, histori kombëtare, gjeografia dhe muzika mësohen pak.

Në tekstet shkollore të përkthyera në gjuhën shqipe nuk lejohet përdorimi i toponimeve dhe emrave shqip.

Çerdhet e fëmijëve në gjuhën shqipe mungojnë në shumë vendbanime shqiptare. Drejtorët e shkollave, ku mësohet shqip, nuk janë shqiptarë. Ka edhe mësimdhënës që japin mësim në paralelet me mësim në gjuhën shqipe, por nuk dinë të flasin shqip dhe nuk janë shqiptarë.

Në Universitetin e Malit të Zi ekziston vetëm një program në gjuhën shqipe për kualifikimin e mësuesve.

Në Komisionin Parlamentar të Arsimit të Malit të Zi nuk është asnjë anëtar shqiptar. Simbolet kombëtare në Mal të Zi janë të lejuara për individë, por në institucione publike përdorimi i tyre kufizohet vetëm në festa kombëtare.

Aktivitetet kulturore të shqiptarëve nuk financohen nga institucionet, kurse në Ministrinë e Kulturës nuk punon asnjë shqiptar.

Shqiptarët e kanë vetëm një gazetë javore, kurse Radio Mali i Zi i ka vetëm 30 minuta në ditë në gjuhën shqipe, po aq ka edhe televizioni publik.

Shqiptarët që largohen përkohësisht nga vendi shlyhen nga evidenca dhe u merret nënshkrimi. Shqiptarët janë pak të përfaqësuar në organet shtetërore. Për shembull, shefi i Policisë së Ulqinit, ku 90% e banorëve janë shqiptarë, është malazez, po ashtu 90% e gjykatësve të Komunës së Ulqinit janë malazias.

Në Gjykatën e Lartë të Malit të Zi, nuk është asnjë gjykatës shqiptarë. Në Qeverinë e Malit të Zi nuk është asnjë ministër dhe asnjë zëvendësmministër shqiptar.

Ulqini është komuna më e varfër bregdetare e Malit të Zi, edhe pse 43% e të mirave detare të Malit të Zi gjenden në komunën e Ulqinit.

Po ashtu, edhe komunat tjera ku jetojnë shqiptarët, Tuzi, Plava, Gucia dhe Rozhaja janë komunat më të varfra në Mal të Zi. Prandaj, nga këto komuna shpërngulja e qytetarëve shqiptarë është shumë e madhe.

Shqiptarët e Malit të Zi, në shumë raste nuk mund t'i realizojnë të drejtat çfarë i lejon Kushtetuta e Malit të Zi. Ata kërkojnë të drejtat që në Kosovë u njihen pakicave kombëtare, ku bën pjesë edhe komuniteti malazias.

Ata kanë nevojë për tekste shkollore dhe lektura shkollore, kërkojnë përkrahje nga Shqipëria dhe Kosova për hapjen e një universiteti në gjuhën shqipe.

Qeveritarë nga Kosova e Shqipëria që shkojnë kohë pas kohe në Mal të Zi, por Asnjëherë nuk e vizitojnë Malësinë dhe komunat tjera ku jetojnë shqiptarët, prandaj edhe nuk i njohin problemet e tyre, por bazuar në informatat që i marrin në Podgoricë nga zyrtarët malazias flasin në superlativ për pozitën e shqiptarëve në Mal të Zi, gjë që nuk është e vërtetë. Siç ka ndodhur me ish-ministrin e Punëve të Jashtme dhe me ministrin aktual të Punëve të Jashtme të Kosovës, të cilët pa u takuar dhe pa i vizituar komunat shqiptare, përveç Ulqinit, flasin në emër të tyre për pozitën e tyre.

Komisioni Parlamentar i Arsimit të Kuvendit të Kosovës kërkoi nga nënkryetari i Kuvendit të Malit të Zi, me të cilin u takova në Podgoricë dhe Komisionin Parlamentar të Arsimit të Malit të Zi, përfaqësim më të madh të shqiptarëve në institucionet shtetërore të Malit të Zi dhe lejimin e teksteve shkollore për nxënësit shqiptarë të shkollave fillore në Mal të Zi.

Ne kërkuam reciprocitet në fushën e të drejtave politike dhe ekonomike me...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI. Regjia, vazhdoja fjalën edhe 5 minuta!

ISMAJL KURTESHI: Nënkyetari i Kuvendit të Malit të Zi dhe anëtarët e Komisionit Parlamentar për Arsim shprehën gatishmërinë e Kuvendit të Malit të Zi për avancimin e të drejtave të pakicës shqiptare në Mal të Zi. Mbetet obligim i Qeverisë së Kosovës që të angazhohet në këtë drejtim. Është shumë e rëndësishme që kur qeveritarët tanë shkojnë në Mal të Zi t'i takojnë shqiptarët që jetojnë atje dhe t'i dëgjojnë kërkesat dhe hallet e tyre, para se të flasin për pozitën e tyre.

Shqiptarët e Malit të Zi nuk janë të kënaqur me interesimin e dy shteteve shqiptare për ta deri në këtë moment dhe presin një angazhim më të madh në të ardhmen. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ne e kemi marrë një raport nga vizita juaj atje, por zoti Nait Hasani ka qenë shumë i shkurtër. Do të ishte mirë për ne deputetët ta kemi këtë ekspozë, si edhe zëvendëskryeministri dhe ministri i Punëve të Jashtme, se u ndihmon.

Valdete Bajrami është e lajmëruar. Unë po shkoj në bazë të radhitjes elektronike, edhe pse tash secili mund të gjykojë sikur Ismajli më herët, por në bazë të radhitjes elektronike ashtu si janë lajmëruar.

Atëherë, e bëjmë me marrëveshje, edhe ashtu shkojmë. Po, urdhëro!

VALDETE BAJRAMI: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar kryetar,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Kanë kaluar 16 vjet nga masakra e Burgut të Dubravës, 16 vjet nga ekzekutimi i qindra njerëzve në burgun famëkeq, i vendosur vetëm disa kilometra larg Istogut.

Është e drejtë e çdo deputeti çka do të flasë dhe çka do të prezantojë, i nderuar.

Burgu i Dubravës kishte pavijone, e secili nxinte më shumë se 1 mijë të burgosur, pavijone ku janë kryer krime dhe ku janë masakruar qytetarët tanë për të cilët as sot e kësaj dite nuk po kërkohet të japin llogari ata policë, ushtarë e gardianë, të cilët e kanë kryer këtë masakër, e që sot e kësaj dite jetojnë lirshëm në shtetin serb.

Kjo masakër, ky krim është kryer me urdhër të Qeverisë së Serbisë, gjë të cilën e pranon edhe Prokuroria për Krime Luftë e Serbisë, e cila e ka siguruar dokumentin që e ngarkon ministrin e atëhershëm serb të Drejtësisë, Drago Lubjakoviç, dhe zëvendëskryeministrin e Republikës Federale të Jugosllavisë, Nikola Shadinoviç, për krimet, të cilat janë kryer në Burgun e Dubravës.

Ju e dini që sipas informacioneve, numri i të burgosurve shqiptarë në Burgun e Dubravës ishte mbi 900, ndaj të cilëve zbatohej keqtrajtim dhe dhunë e paparë. Deri në prag të fillimeve të masakrës serbe, të burgosurit ishin të vendosur në katër pavijone: C1, C2, B2, dhe në pavijonin pranues, në kushte jetësore tepër të rënda dhe keqtrajtoheshin në mënyrën më çnjerëzore.

Kjo masakër, ky krim, është dëshmia e cila tregon implikimin e vetë shtetit serb në ekzekutimin dhe gjenocidin ndaj shqiptarëve, ndërkaq është mbajtur dhe po mbahet fshehur edhe më tutje, duke përfshirë këtu edhe heshtjen e pakuptueshme të institucioneve të vendit tonë dhe moskërkimin e llogarisë nga pala serbe, heshtje e cila e dëshmon se në Kosovë kemi sistem të drejtësisë selektive dhe të politizuar.

Të nderuar qytetarë,

Krimi, masakra e Dubravës, për nga përmbajtja e dhembshme është pa dyshim njëra ndër tragjeditë më të tmerrshme që njeh historia e njerëzimit. Janë dëgjuar zëra që thonë se numri i të vrarëve në këtë masakër nuk mund të jetë një argument i mjaftueshëm që ajo të radhitet në mesin e tragjeditë më të tmerrshme, e ata të cilët mendojnë kështu dhe deklarojnë gabojnë shumë rëndë.

Pikërisht ana përmbajtësore është ajo që këtë tragjedi e veçon nga tragjeditë tjera më të mëdha në përmbajtjen sasiore. Masakra e Dubravës e shënon jo vetëm kulmin e shfryrjes shtazarake të një grupi të njerëzve ndaj një grupi tjetër, por veçanërisht natyrën juridike, e cila është argumenti më i fortë që dëshmon projektin shtetëror serb për gjenocid ndaj shqiptarëve, si dhe teknologjinë faktike të ekzekutimit të atij gjenocidi.

Kur e keni ndërmend, zoti kryeministër, që të ndërmerrni diçka në këtë drejtim? Kur do ta merrni guximin t'i kërkonit Serbisë që të japë llogari dhe t'i dënojë ata, të cilët ishin kreatorë dhe kasapë të masakrës së Dubravës, por edhe të masakrave dhe krimeve të tjera, të cilat u bënë në shtetin tonë nga pala serbe?

Si shtet dhe ju si kryeministër, kur do të filloni të silleni si i tillë dhe mos pritni që Serbia do të lejojë të krijojë ose të kërkojë të krijohet një gjykatë speciale ashtu siç po kërkohet dhe po veprohet tek ne, jo ajo nuk e bën një veprim të tillë edhe përkundër faktit se e gjithë bota e dinë se kush ka qenë agresori e kush jo.

Zoti kryeministër, e dimë se shumica prej tyre janë gjallë, e kam fjalën ata të cilët e kanë kryer këtë krim dhe masakër, e nga këtu u janë përmendur emrat e atyre të cilët janë të përfshirë në këtë krim, emra për të cilët ju duhet të ngrehni padi për ta, por edhe për të gjithë ata të tjerët, të cilët kanë kryer krime lufte gjatë luftës në vendin tonë, sipas sistemit të shtetit serb të asaj kohe.

Unë prapë po i përmend disa emra, të cilët edhe kolegët e mi i kanë përmendur në seancat e kaluara: ish-ministri i Drejtësisë Drago Lubjanković; ish-drejtori i Policisë, Obrad Stefanović; ish-komandanti i Policisë në qytetin e Pejës, Boro Vlahović; drejtori i atëhershëm i Burgut të Dubravës, Aleksandër Raković.

Deri më tani, asnjë aktakuzë nuk është ngrehur për asnjë nga këta emra, të cilët i përmenda unë sot dhe të cilët janë përmendur nga shumë kolegë këtu te ne. Emra prej të cilëve na janë masakruar, por edhe na janë zhdukur intelektualët tanë, ashtu siç është rasti i profesor Ukshin Hotit, për të cilin edhe kemi pasur debat parlamentar. E sot e kësaj dite nuk kemi një përgjigje për të gjithë ata familjarë, të cilët i presin të zhdukurit dhe më të dashurit e tyre.

Andaj, zoti kryeministër, është koha të kërkonit nga shteti serb në ato bisedime, të cilat po i keni, burgosjen e të gjithë atyre që kanë marrë pjesë në masakrën e Dubravës, por edhe në të gjitha masakrat tjera, të cilat janë bërë nga ushtria serbe ndaj popullatës civile shqiptare, gjithashtu edhe kthimin e mbi 1 600 trupave, të cilët...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Do të shkojmë në bazë të partive. Atëherë, Donika Kadaj-Bujupi e ka fjalën.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit! Është një çështje, të cilën e kam trajtuar edhe në Kryesinë e Kuvendit, të nderuar kolegë, prandaj konsideroj që sot, pasi është edhe ministri Demolli këtu, t'i japim edhe disa sqarime shtesë rreth kërkesës tonë.

Është fjala për nevojën dhe domosdoshmërinë e kohës për formimin e Ushtrisë së Kosovës. Unë jam e vetëdijshme se kjo çështje e tejkalon një parti, e tejkalon një deputet, ka nevojë për 2/3 e Kuvendit të Republikës së Kosovës, por, megjithatë, është një çështje e prioritetit nacional dhe është moment, kur ne duhet të bëhemi bashkë përtej partive dhe interesave të ngushta dhe ta kalojmë sa më parë Ligjin për ushtrinë dhe Kosovën ta bëjmë me ushtri.

Nuk po jap sqarime shitesë, sepse të gjithë e dimë, më mirë e dinë edhe ekspertët, se është e nevojshme. Por, arsyeja pse e mora fjalën është që proceduralisht t'i jap disa shpjegime. Pas kërkesës sonë dhe informatave që kanë dalë nga Kryesia e Kuvendit, ka pasur një reagim nga ministri përkatës, i cili në "Koha Ditore" e thotë që fillimisht duhet të procedohen amendamentet kushtetuese, të cilat janë në Kuvend dhe të votohen, e kjo qëndron, mirëpo sipas Rregullores së Kuvendit proceduralisht Qeveria duhet t'i riprocedojë amendamentet dhe unë ju thërras ministër dhe kryeministër që t'i riprocedoni këto amendamente, sepse përndryshe Kuvendit nuk mund t'i trajtojë.

Jemi të gjithë dëshmitarë se të gjitha ligjet të cilat edhe nëse kanë kaluar në lexim të parë në mandatin e kaluar, për shkak të procedurave të Kuvendit dhe Rregullores, duhet të riprocedohen, e kjo është arsyeja se pse ne si Kuvend nuk mund t'i trajtojmë, ose t'i sjellim për votim. Prandaj, ju thërras edhe një herë që sa më parë të riprocedohen, në mënyrë që ligji të vijë sa më shpejt dhe të aprovohet e ta mbyllim një kapitull, që është jashtëzakonisht i rëndësishëm për shtetin e Republikën e Kosovës.

Mendoj që në materialin, të cilin e kemi si program legjislativ, janë paraparë edhe afatet kohore, data 31 mars ka qenë e paraparë që ta kemi këtu Ligjin për ushtri, mirëpo për shkak të këtyre amendamenteve, po shihet që ka pasur një ngecje dhe unë konsideroj, në emër të Aleancës, që tani është momenti i duhur që t'i sillni sa më parë, fillimisht për riprocedim amendamentet, e pastaj ligjin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Donikë! Për njoftim, dje Kryesia e ka kërkuar këtë çështje në mënyrë zyrtare nga Qeveria. Ta kini parasysh. Atëherë, Veton Berisha e ka fjalën.

VETON BERISHA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë flas në emrin tim dhe po e shfrytëzoj këtë mundësi që t'i paraqes dy shqetësime, apo thënë më mirë mesazhe. E para, unë kam qëndruar gjatë majit për një kohë në Gjermani, ku e kam pas rastin t'i vizitoj pjesëtarët e komunitetit të cilët janë larguar kohën e fundit nga Kosova, e po ashtu qendrat e emigracionit dhe organizatat, të cilat i mbrojnë të drejtat e njeriut atje. Shqetësimi kryesor i tyre është që të paktën Qeveria e Kosovës të ketë konsideratë ndaj këtij grupi, në mënyrë që të jepet një mundësi, ose të negociohet me shtetin gjerman, apo me vendet në të cilat janë atje që të paktën të qëndrojnë për një kohë të caktuar deri 3-vjeçare, kohë kjo optimale, kur edhe ne si Qeveri kemi mundësi të përgatitemi më mirë që këto kategori të njerëzve t'i presim më mirë dhe në mënyrë që këto kategori të njerëzve të kenë mundësi të integritit më të plotë.

Dhe, besoj se do të kemi mirëkuptim, sepse vërtet kthimi i tyre i paplanifikuar dhe i pamenduar mirë mund të na vërë në një pozicion kur ne nuk mund t'i përballojmë situatat e palakmueshme.

Ndërsa, shqetësimi i dytë, zoti kryeministër, është që ne akoma po ballafaqohemi me raste të një çështjeje, e cila vërtet është shqetësuese, kur akoma hasim në raste të pengimit të posedimit të pronave. Ne gjatë gjithë kohës në vazhdimësi marrim mesazhe dhe vërejtje, si dhe ka kërkesa për

mbështetje, e në këtë aspekt kemi akoma raste të pengimit të posedimit të pronave, si një veti dhe dukuri e cila është e patjetërsueshme, shumë e nevojshme për t'u mbrojtur, prandaj kërkojmë që këto raste t'i trajtojmë me prioritet, që çdonjëri nga ne ta posedojë pronën në mënyrën më të mirë të mundshme dhe të papenguar nga askush.

Besoj që tani është koha që më këto raste të mos ketë në mesin tonë dhe është vërtet shqetësuese se akoma marrim dhe janë me numra, që çdo ditë lajmërohen dhe raportohen te mekanizmat se ka akoma pengim në posedim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tani fjalën e ka Faton Topalli.

FATON TOPALLI: të nderuar deputetë,

Të nderuara deputete,

Sot po flasim, respektivisht do të flas për një krim të klasit të parë, për një krim të organizuar mirë, për një krim që vazhdon për 15 vjet me radhë dhe që përbën një prej plaçkitjeve më të mëdha të qytetarëve prej përfundimit të luftës e deri më sot.

Të plaçkitur janë mbi 800 mijë mërgimtarë shqiptarë, gati gjysma e popullsisë së Kosovës, ndërsa vlera e plaçkitjes është mbi 200 milionë euro. Plaçkitës janë Byroja e Sigurimit të Kartonit të Gjelbër, që përbën një strukturë mafioze, e cila mbështetet nga përfaqësuesit e shtetit. Secili mërgimtar që vjen në Kosovë detyrohet ta paguajë për Kartonin e Gjelbër në Kosovë, edhe pse secili prej tyre e bën këtë pagesë në vendin e jashtëm ku jeton. Mërgimtari pagan dyfish dhe pagan kot. Arsyeja e vetme pse duhet ta bëjë një pagesë të tillë është pasurimi i mafisë së sigurimeve të automjeteve.

Në qershor të vitit 2001 ishte marrë një vendim nga Asambleja e Përgjithshme e Byrosë në Gjenevë për ta instaluar një model të veçantë për Kosovën për Kartonin e Gjelbër. Ky vendim nuk u shfrytëzua kurrë dhe nuk u bë asnjëherë publik. A e dini pse? Sepse mafia e sigurimeve dhe përfaqësuesit e saj politikë brenda shtetit, nuk do të mund t'i plaçkitnin 200 milionë euro.

Në fillim të muajit prill të vitit 2014, Këshilli i Byrosë Evropiane ishte pajtuar që të lejohet shitja e Kartosit të Gjelbër për Kosovën, por Marrëveshja nuk u finalizua, për shkak të refuzimit nga kompanitë e sigurimit të Kosovës.

Ky është një akt kriminel, zonja dhe zotërinj. Po, a e dini pse nuk është arritur kjo marrëveshje? Sepse, 200 milionë euro fitim nuk e ka ngopur akoma barkun e tyre. Ata i duan 300 milionë, 400 milionë, 500 milionë, ata janë të pangopshëm.

Kosova kishte mundësi të bënte marrëveshje bilaterale me vendet tjera, për ta rregulluar këtë çështje. Nga 46 shtete të anëtarësuara në Gjenevë, 12 prej tyre kanë vetëm marrëveshje bilaterale. Kosova ka memorandume mirëkuptimi vetëm me Shqipërinë dhe Maqedoninë.

Pyeteni ministrin e Jashtëm, pse nuk ka bërë marrëveshje bilaterale? Nuk ka bërë marrëveshje bilaterale, sepse krimi dhe pasurimi i pafund i mafisë dhe politikanëve të përfshirë brenda saj, do të përfundonte, pra kjo është arsyeja.

Krijimi i monopolit, i kartelit, më mirë të them nga ana e sigurimeve, në kundërshtim me ligjin, aprovimi në heshtje i shkeljes ligjore për monopolin nga ana e institucioneve të kapura nga pushteti, sabotimi me qëllim të plaçkitjes i marrëveshjes së Gjenevës, përfitimi i më tepër se 200 milionë eurosh në mënyrë të paligjshme, nuk janë vetëm çështje e përfitimi i më tepër se 200 milionë euro në mënyrë të paligjshme, nuk janë vetëm çështje e një debati parlamentar dhe qëndrimeve politike, por çështje urgjente e Prokurorit të Shtetit.

Në emër të mërgimtarëve dhe në emër të të gjithë atyre qytetarëve të Kosovës, që paguajnë çmime marramendëse për të dalë, qoftë edhe në Kroaci dhe që e ndejnë veten të mashtruar, të plaçkitur dhe diskriminuar, ftoj Prokurorin e Shtetit që t'i fillojë hetimet.

Aktorët e krimit janë të njohur, midis tyre, zoti Pacolli dhe vëllai i ministrit të Jashtëm, Gani Thaçi, shuma e krimit prej 200 milionë eurosh është e njohur dhe del nga raporti i BQK-së, shkeljet ligjore janë të dokumentuara, përfaqësuesit politikë të dyshuar për krim mund t'i gjeni të fotografuar dhe me emra në konferencën e kompanive të sigurimeve, më 28 mars 2013. I panjohur është vetëm fakti, se a do të bëni detyrën tuaj, si prokurorë.

Zoti Lumezi, ju ftoj publikisht të deklarojeni, se a do të filloni hetimet apo do të heshtni!?

KRYETARI: Faleminderit, zoti Topalli! Por, më së pari drejtojeni Prokurorisë me letër, mos bëj ftesë publike. Dhe, nën dy, nuk është që 15 vjet, po pas 17 shkurtit 2008-ës, veç sa për korrektësi, për hir të publikut.

Realisht, ka mundësi, ta jap fjalën sa të duash, ama shumë akuza po bëni këtu e kurrë nuk shkoni asnjëri në Prokurori, se e keni vetëm sa për konsum, t'i fyeni njerëzit. Urdhëro fol, por mos akuzo, shko në Prokurori!

FATON TOPALLI: Siç e thashë, në vitin 2001, Byroja e kartonëve të gjelbra ka pranuar, ka aprovuar, është pajtuar që të bëhet kartoni i gjelbër për punën e Kosovës, është bërë një vendim i veçantë. Ky vendim nuk është shfrytëzuar kurrë, është i kohës së UNMIK-ut. Në vitin 2014 përsëri Byroja në Gjenevë ka qenë e gatshme që të bëhet marrëveshja, këta nuk e kanë bërë marrëveshjen, për arsye se nuk do t'i fitonin 200 milionë.

Prandaj, mendoj se kjo është vërtet çështje e Prokurorisë, për arsye se ka shkelje të ligjit, se ka pasurim të paligjshëm, se është krijuar monopol dhe se Byroja e kartonit të gjelbër në Kosovë, qëllimisht nuk e ka kryer detyrën, duke mundësuar që t'i mbi 200 milionë euro. Vetëm 10% janë shpenzimet e dëmeve, që i bëjnë mërgimtarët këtu, vetëm 10%. Tash merreni me mend sa është shumë prej përmbi 200 milionëve.

Mali i Zi ka pasur gjithashtu, pak a shumë, të njëjtën politikë, sa i përket Kartonit të gjelbër, kanë paguar 10-11 euro, ndërsa, ne edhe sot paguajmë 45 euro. Kjo është krim.

Prandaj edhe prokurori, jo që duhet të deklarohet, por duhet të fillojë hetimet, duhet të deklarohet publikisht, nëse dëshiron të fillojë hetimet, apo nëse dëshiron të vazhdojë sikurse prokurorët tjerë. Në deklarimin e tij, kur ka filluar punën, ka thënë se nuk do të jem si prokurorët tjerë, do të

veproj në interes të shtetit. Pra, mos i shkelni 800 mijë mërgimtarë, të cilët ju i lavdëroni gjithmonë, por gjithmonë i shkelni.

KRYETARI: Ishalla, ti i mbron, vetëm në atë Zvicrën prej nga vjen ti, me aq sa e njoh unë, kështu s'kishe guxuar të flasësh, pa fakte.

Vazhdojmë. Haxhi Shala e ka fjalën.

HAXHI SHALA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Në kuadër të këtyre diskutimeve, sot kam zgjedhur një çështje të ndjeshme, që është preokupim i çdo familjeje dhe biznesit saktësisht, që do të merrem me sistemin bankar.

Sistemi bankar ka nevojë për më shumë fleksibilitet, sidomos nga ana rregullative. Për këtë qëllim, Banka Qendrore e Kosovës duhet menduar për një rivlerësim të kornizës rregullative lidhur me funksionimin e tregut të parasë, të politikave të kreditimit dhe të tregut valutor.

Një nga faktorët, që ka nevojë për përmirësime të menjëhershme, është kultura bankare dhe njohuritë e nevojshme të marrëdhënieve me bankat dhe zbritjen e menjëhershme të kamatave për kreditë.

Kultura e ulët bankare në vend bën që llogaritë e depozitave apo kreditë të mos mbeten thjesht një marrëdhënie besimi, ndërmjet klientit dhe bankës.

Shpeshherë lajmi merr dhënë, përmbyllet ende veprimet bankare, bankat shpeshherë thonë se të dhënat bankare konsiderohen si konfidenciale dhe askush nuk ka të drejtë të mësojë për llogaritë, depozitat apo kreditë e një personi.

Ju e dini, që as një punonjës bankar nuk ka të drejtë të japë informacione për llogaritë apo kreditë personale apo të bizneseve, përveç me një vendim gjykatë. Njohuritë e nevojshme në marrëdhëniet me bankat, pjesa më e madhe e njerëzve, kur marrin kredi jo vetëm që nuk e lexojnë me vëmendje kontratën, por nuk kanë idenë e shumë termave financiarë, siç është “euro-libori”, normat bazë të interesit, kamatat rrëshqitëse apo si t'i funksionojnë depozitat me afate, pa afate, mujore, si do të ndryshojnë interesat, e tjerë...

Mjafton të jesh i pranishëm një ditë në një sportel dhe do të përballesh me shumë keqkuptime të bankave dhe klientëve të saj, vetëm si pasojë e mungesës së informacioneve të duhura. Bankat komerciale që veprojnë në vendin tonë janë tërësisht banka fajdexhinjsh, të cilët që na themelimi i tyre kanë dhënë kredi me kamata aq të larta deri në 20%, shumë vështirë kanë mundur t'i përballojnë bizneset dhe shumë prej tyre edhe kanë falimentuar.

Kurse, sot bëjnë publicitet, kinse për ulje të normave të kamatave njëshifrore dhe në të njëjtën kohë ka ulje drastike të depozitave të qytetarëve nga 5% më pak se 1%. Sot bankat komerciale

bëjnë fitime shumë të larta në një vend siç është Kosova, me një ekonomi shumë të ultë dhe një krizë të thellë financiare.

Ne kërkojmë nga bordi përkatës, që sa më parë t'i propozojë organeve kompetente këtë shqetësim të qytetarëve dhe bizneseve tona, për përmirësimin e kësaj gjendjeje të rëndë, të krijuar nga bankat komerciale. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që ta ngre një çështje të cilën e kam ngritur edhe në mandatin e kaluar, rreth plaçkitjes së qytetarëve edhe në Kosovë, pra nga KEDS-i, përkatësisht janë shtresa më e ndjeshme e qytetarëve tanë, janë pensionet e moshës, të cilat janë pensione, pra të garantuara dhe janë që plaçkitja përmes KEDS-it po shkon me vendime të gjykatave themelore dhe bankave, gjykatat themelore komunale, pra po lëshojnë vendime dhe bankat me atë vendim po ua ndalin pagesat e pensioneve për borxhet e vjetra të rrymës.

Këtë çështje e kam ngritur edhe në mandatin e kaluar dhe thërras ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, i cili për momentin nuk është këtu, por unë i kam këtu edhe vendimet, të cilat edhe sot edhe kësaj dite, pas një viti, kjo po vazhdon dhe asnjëherë Ministria përkatëse nuk u mor seriozisht me këtë çështje.

Unë thërras edhe njëherë ministrin, që të merret seriozisht me këtë çështje, se këto vendime të gjykatave po bëhen pa pëlqimin dhe miratimin e personave përgjegjës. Pra, kjo është një shkelje elementare dhe kështu nuk duhet të ndodhë, Qeveria duhet seriozisht të merret me këtë çështje. Pra, uroj që ministri të merret edhe njëherë pra, me këtë çështje, të cilën e kam ngritur dhe asnjëherë nuk u mor seriozisht me të. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Shukrije Bytyqi është diskutuesja e fundit e lajmëruar.

SHUKRIJE BYTYQI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Çështja që do të ngre unë sot ka të bëjë me gjendjen e rëndë të mësimdhënësve të gjitha niveleve, që punuan gjatë viteve '90-ta.

Shumica e mësimdhënësve të pensionuar të Kosovës, janë në gjendje të mjerueshme materiale. Këtë nuk e merituan, kur dihet sakrifica e tyre e vazhdueshme në arsimin, në ato kushte të rënda, nën presionin brutal të regjimit dhe okupatorit serb, vetëm e vetëm që në shkollat shqipe në Kosovë, në asnjë çast të mos ndërprisnin punën e tyre.

Mësuesit tanë të gjitha niveleve të shkollimit punuan pa hezitar dhe pa kurrfarë kompensimi apo shpërblimi material, për vite të tëra.

Në vitin 2013 nisma nga ana e Parlamentit të Republikës së Kosovës për aprovimin e Ligjit për kompensimin e punës së tyre, vërtet i gëzoi të gjithë ata mësimdhënës dhe të gjithë ish-nxënësit e tyre, që sot janë edhe menaxherë dhe udhëheqës të instancave të larta shtetërore, por kjo në realitet nuk po ndodh.

Kompensimi i propozuar për punën e arsimtarëve gjatë periudhës 1990-1999 të bëhet pa ngecje dhe pa vonesë, duke filluar nga janari i vitit 2015, ashtu siç edhe janë dhënë premtime. Kjo vërtet do të kishte ndikuar në relaksim, sidomos të atyre mësimdhënësve të shtyrë në moshë, që janë në gjendje të rëndë materiale dhe shëndetësore.

Të gjithë arsimtarët, që punuan në periudhat e atyre kohëve të vështira, të paguhën sa më shpejt, sidomos atyre që janë të pensionuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Për fund, fjalën e ka ministri i Forcës së Sigurisë, zoti Haki Demolli.

MINISTRI HAKI DEMOLLI: Faleminderit!

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Të nderuar kolegë ministra,

E nderuar deputete Donika Kadaj,

Lidhur me shqetësimin tuaj, unë mund të them, se ne si Ministri e FSK-së, draft-ligjin për transformimin e FSK-së në Forcë të Armatosur të Kosovës, ka dy muaj që ia kemi dorëzuar Qeverisë.

Mirëpo, është fakt i ditur se para shqyrtimit të tij, duhet të aprovohen amendamentet kushtetuese, që kanë të bëjnë me procesin e transformimit të FSK-së në Forcë të Armatosur.

Për këto amendamente, dihet se Gjykata Kushtetuese ka vendosur pozitivisht dhe të njëjtat, Kuvendi ia ka proceduar Qeverisë së Kosovës dhe thjesht, jam i bindur, por edhe në marrëveshje me kryeministrin, jam i sigurt se Qeveria e Kosovës këto amendamente do t'i shqyrtojë në mbledhjen e radhës, apo në mbledhjen e parë të saj e sigurisht më pastaj do t'ia procedojë Kuvendit për aprovim.

Pasi jam këtu po shfrytëzoj rastin, që përveç kësaj çështjeje, t'i them disa fjalë edhe për një çështje tjetër, e cila ka qenë apo të paktën, ka qenë mjaft aktuale këtyre ditëve në mediet tona.

Ditëve të fundit, në mediat tona ka qarkulluar një lajm, sipas të cilit gjatë procesit të transformimit të FSK-së në Forcë të Armatosur të Kosovës, kinse do të krijohet një ushtri e veçantë për serbët e veriut, respektivisht një batalion serb brenda Forcës së Armatosur të Kosovës.

Ndonëse, nga raportet e mediave u bë e ditur se gjeneza e lajmit apo zanafilla e tij paska qenë një bisedë joformale në një ndejë rasti, që populli edhe mund ta quajë: “bisedë” apo “muhabet i kafenesë”. Për shkak të përfoljeve të shumta të lajmit dhe me qëllim të sqarimit të kësaj informate të pasaktë, unë do t'i theksoj disa gjëra.

1. Mua si ministër të FSK-së, askush deri më sot, qoftë nga përfaqësues të mekanizmave ndërkombëtare, qoftë nga përfaqësues të subjekteve politike qeveritare, parlamentare apo joparlamentare, nuk më ka bërë një kërkesë apo propozim të tillë apo, madje, nuk e ka trajtuar as si çështje diskutimi.

2. FSK-ja aktuale, por edhe Forca e ardhshme e Armatosur e Kosovës konform dispozitave të Kushtetutës së Kosovës reflektojnë dhe do të reflektojnë diversitetin etnik të popullatës së Kosovës, duke rekrutuar pjesëtarët e vet nga të gjitha grupet etnike, që jetojnë dhe veprojnë në Kosovë.

Ministria e FSK-së dhe vetë FSK-ja krenohen me faktin, që paraqet një forcë të integruar, e cila përbëhet nga përfaqësues të të gjitha komuniteteve të Kosovës dhe në vazhdimësi kemi eksploruar rrugët dhe mënyrat më të përshtatshme dhe më atraktive për të tërhequr në radhët tona më shumë rekrutë nga minoritetet etnike.

Pavarësisht diversitetit të saj etnik dhe gjinor, FSK-ja është dhe do të mbetet një forcë në shërbim të të gjithë qytetarëve të Kosovës, me një komandë të vetme dhe unike për të gjithë pjesëtarët e saj.

Dhe, krejtësisht në fund, më duhet t'ju siguroj se unë personalisht në asnjë situatë dhe asnjë rrethanë nuk do të pajtohem me një propozim të tillë, pavarësisht propozuesit të tij. Faleminderit!

KRYETARI: Donikë, vetëm shkurt se futemi në rend dite.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit!

Vetëm desha ta falënderoj ministrin për sqarimet. Ne po presim që pas takimit të parë të Qeverisë ose mbledhjes së parë të Qeverisë, si Kuvend t'i marrim amendamentet, të riprocedohen dhe më pas të pasohen me ligjin përkatës, i cili po ashtu, jemi njoftuar edhe më herët nga ju, është i gatshëm prej muajit mars. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, për këto qartësime të cilat janë me rëndësi për publikun e gjerë, veçanërisht.

Jemi në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Në bazë të nenit 45, paragrafi 1 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje parlamentare zgjat 60 minuta.

Për këtë seancë janë parashtruar 24 pyetje parlamentare.

Deputeti Elmi Reçica, pyetje për ministrin Imet Rrahmani.

ELMI REÇICA: Faleminderit, zoti kryetar!
Përshëndetje për Kabinetin qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë kam parashtruar, duke e shfrytëzuar të drejtën, një pyetje për ministrin e Shëndetësisë, që është në rrjedhë, mirëpo vetëm sa për sqarim.

Çështja është - ndërtimi i Spitalit Regjional të Ferizajt.

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Shëndetësisë, në rishikimin e buxhetit të vitit 2013, kishin ndarë mjete për fillimin e ndërtimit të Spitalit regjional të Ferizajt.

Gjithashtu është premtuar edhe nga Qeveria e Urdhrit të Kalorësve të Maltës, se do të investojë në këtë projekt, në vlerë prej 35 milionë euro.

Ky spital është i rëndësisë së veçantë, përveç aspektit historik, është i domosdoshëm për regionin e Ferizajt, i cili ka mbi 250 mijë banorë rezidentë, si dhe për banorët e qytetareve të tjera që janë në regionin e Ferizajt.

Dhe, pyetja është kështu, i nderuar zoti ministër Rrahmani:

Çfarë keni ndërmarrë ju si ministër për këtë çështje, kur do të fillojnë punimet për ndërtimin e këtij spitali dhe a është paraqitur ndonjë pengesë, që nuk mund të tejkalohet për fillimin e ndërtimit të këtij spitali? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Urdhëro, zoti ministër!

MINISTRI IMET RRAHMANI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti deputet,

Faleminderit për pyetjen dhe shqetësimin e ngritur për nevojën e madhe të ndërtimit të spitalit të ri në komunën e Ferizajt.

Spitali i përgjithshëm i Ferizajt aktualisht veprimtarinë e kryen në një objekt që nuk i plotëson nevojat e funksionimit efikas dhe nuk garanton mundësinë e zhvillimit të mëtejshëm në drejtim të arritjes së standardeve të synuara në ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore sekondare.

Prandaj Ministria e Shëndetësisë, edhe më herët, është munduar të gjejë zgjidhje për këtë çështje, kështu që është ndarë nga buxheti vlera që fatkeqësisht as për së afërmi nuk i ka plotësuar nevojat e parapara në projektin e hartuar nga komuna dhe Spitali i Ferizajt.

Meqenëse kemi pasur edhe një lokacion jo të përshtatshëm më herët për fillimin e ndërtimit të spitalit, edhe mjetet e parapara që kanë qenë shumë të vogla të dedikuara për atë ndërtim, është shtyrë fillimi i ndërtimit të spitalit dhe mjetet janë ridestinuuar më herët për projekte tjera, prej vitit 2013.

Sot komuna e Ferizajt ka arritur të sigurojë një lokacion krejtësisht të ri, shumë më të përshtatshëm, me sipërfaqe mbi 9 hektarë, për të cilin edhe është dhënë leja e ndërtimit.

Unë qysh në takimin e parë që e kam pasur me kryetarin e Komunës së Ferizajt, në muajin janar dhe në takimet e mëvonshme, kam shprehur gatishmërinë e Ministrisë së Shëndetësisë, që ky projekt të përkrahet dhe fillohet me ndërtimin e spitalit të ri.

Meqenëse kemi të bëjmë me një projekt të kushtueshëm, që tejkalon shumë herë vlerat të cilat janë paraparë për tri vjetët në vijim, kemi konsideruar se duhet shikuar mundësinë e shfrytëzimit të donacioneve eventuale.

Sipas informatave që i kemi në Ministrinë e Shëndetësisë, ka disa vite që flitet për mundësinë e investimit të donatorëve nga Malta, që është aktualizuar në fillim edhe të këtij viti, por edhe kohëve të fundit.

Ministria e Shëndetësisë, duke pasur parasysh se kemi të planifikuar 450 mijë euro për këtë vit dhe gatishmërinë e komunës të marrë pjesë me një sasi të konsiderueshme mjetesh, kemi iniciuar procedurat e përgatitjes së procesit tenderues dhe fillimin e punimeve në ndërtimin e spitalit, duke shpresuar se së shpejti do të kemi diçka shumë konkrete edhe nga donatorët që po përfolën kohëve të fundit.

Ne në Ministrinë e Shëndetësisë jemi shumë të hapur që kur të kemi diçka konkrete t'i bashkërendojmë aktivitetet dhe të shfrytëzojmë edhe donacionin eventuale, mirëpo tash për tash jemi duke u përgatitur me forca tona të fillojmë ndërtimin e spitalit. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro deputet, se edhe ne jemi kurioz, sepse është një projekt gjigant dhe lutemi për atë projekt.

ELMI REÇICA: Faleminderit, zoti kryetar!

Është projekt i përbashkët, pavarësisht se është në regjionin e Ferizajt. Nuk kam pyetje shtesë, por kisha dashur vetëm ta informoj ministrin.

Çështja e vendit - lokacionit. Çështja e lokacionit është çështje tjetër dhe nuk do të isha futur unë në çështjen për ta diskutuar këtë. Lokacioni ka qenë dhe është i përshtatshëm fillimisht kur është marrë vendimi, ndërsa, lokacioni që është ridestinuuar, ndoshta pikërisht ai ka qenë vendimtar që nuk ka filluar ndërtimi i spitalit.

Esenca është, sepse unë i kam parashtruar në legjislaturën e kaluar, ish - ministrit të FSK-së dhe gjeneralit të karrierës zotit Çeku një pyetje, e tash s'është ministri aktual që sigurisht është i njoftuar dhe i di shumë më mirë se sa ne që, kushtimisht jemi staf civil të kësaj çështjeje, që nuk preferohet afër kazermave ushtarake të ndërtohen spitale. Janë dy poligone qitjeje. Ne së shpejti do të bëhemi ushtri e vërtet, dhe pikërisht është Qendra e trajnimit dhe doktrinës e locuar në Ferizaj, ku bëhen edhe qitjet. Sigurisht, mendoj, se do të rritet edhe kalibri i armëve, që do të përdoren, dhe shumëçka tjetër.

Nuk është informimi adekuat për vendin. Çështjen e vendit na e lini neve. Esenca është që ju si ministër, do të duhej të bëni të gjitha përpjekjet, qoftë përmes buxhetit të rishikuar të vitit 2013, qoftë përmes donacionit t'i shfrytëzoni të gjitha ato që i keni potencial dhe mos hezitoni ta qitni nënshkrimin për donatorë ose për donacione të cilat janë humanitare, janë shëndetësore dhe janë në të mirë të zhvillimit të Kosovës.

Pra, çështjen e vendit na e lini neve. Na e diskutojmë me kryetarin e Komunës, siç e kemi diskutuar dhe nuk kemi asnjë problem. Po nuk është e saktë ajo që për shkak të lokacionit s'ka filluar, se atje janë 3 hektarë, plus janë të mundshme me Partneritet Publiko-Privat të merren edhe 2 hektarë tjerë, ose përmes formave tjera dhe të bëhen 5 hektarë që mjaftojnë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: OK. Faleminderit! Donika, i ke dy pyetje me radhë për kryeministrin. A do t'i bësh tash? Urdhëro, Donika KadaJ-Bujupi!

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Kryetar!

Po dua të theksoj se nuk është aspak korrekt. Kryeministri deri tash ishte këtu, dhe pyetjet janë pyetje të cilat po ngritën prej qytetarëve të Kosovës tash e një kohë të gjatë.

Ka të bëjë me pensionet e Zvicrës. Njerëzit kanë punuar gjithë jetën dhe këto pensione u janë ndaluar. Dhe ka dy-tri javë që e kam parashtruar pyetjen, dhe kemi nevojë të kemi përgjigjen, për t' u treguar qytetarëve tanë se çfarë po ndodh dhe Qeveria a po i kryen obligimet e kërkuara nga Qeveria zvicerane në mënyrë që kjo marrëveshje të marrë formë zyrtare dhe njerëzit t'i marrin pensionet.

Nuk është korrekt të ikë në momentin e fundit, pra të qëndroj këtu, e pastaj për të shkuar dhe për t' i injoruar kështu kërkesat e qytetarëve.

Unë s'po di si të vazhdoj të bëj pyetje, kur ai asnjëherë nuk vjen për të dhënë përgjigje.

Pyetja konkrete është, qenkan edhe ministrat, për pensionet e Zvicrës, a i keni kryer obligimet si Qeveri, në mënyrë që marrëveshja ndërmjet dy shteteve të marrë formë zyrtare dhe njerëzit t'i marrin pensionet e tyre. Pra, shtetasit të cilët kanë punuar një kohë të gjatë në Zvicër e tash janë kthyer në pension në Kosovë, duan t'i marrin pensionet e tyre dhe gjykata atje ka vendosur pro qytetarëve tanë. Prandaj, s'është kjo korrekt, është papjekuri. S'po di, me të vërtetë është e tepërt.

Edhe e dyta ka të bëjë me borde, përsëri për moskompletimin e tyre. Në këtë rast edhe me AKP-në. Ju e dini sa reagime po vijnë nga bizneset të cilët kanë me mijëra raste kontestuese, e Qeveria s'po flet. Jemi futur më në muajin e katërt a të pestë të punës dhe asnjë veprim në këtë kuptim. Prandaj, kishim dashur të marrim një përgjigje si Kuvend.

KRYETARI: Faleminderit Donika! Atëherë, Luljeta Veselaj-Gutaj, pyetje për ministrin Imet Rrahmani.

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje të nderuar kolegë deputetë,

Përshëndetje kabinet qeveritar,

Zoti ministër,

Një çështje e ngritur si shqetësim kohëve të fundit, është në lidhje me furnizimin e barnave për pacientët të cilët vuajnë nga leukemia kronike.

Deri në muajin janar të vitit 2015, pacientët të cilët vuajnë nga leukemia kronike janë furnizuar me barna nga Ministria e Shëndetësisë, kurse nga janari i vitit 2015 më nuk janë duke u furnizuar nga kjo Ministri. Pacientët janë të detyruar që këto barna t'i sigurojnë në mënyrë private, nga shitësit pa kompetencë, duke e ditur se ky lloj i barërave nuk lejohet të shitet në barnatore dhe kushton shumë.

Pyetja konkrete, për zotin ministër është: Pse është ndërprerë furnizimi me këtë lloj të veçantë të barnave ku varet jeta e pacientëve dhe çka është duke ndodhur me këto barna? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit për pyetjen! Urdhëroni, zoti ministër!

MINISTRI IMET RRAHMANI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

E nderuar deputete,

Mund t'ju them konkretisht se ky bari tash është në Klinikë dhe pacientët janë të furnizuar ose e marrin barin Glivek.

Është evidente që në fillim të vitit kemi pasur probleme me lidhjen e kontratave me operatorët ekonomikë dhe furnizimi me barëra jo vetëm me ata citostatikë ka ngecur dhe kemi pasur mungesa pak më të mëdha.

Tash, është në përfundim ky proces dhe e kemi një gjendje shumë më të mirë. Në muajt e parë të vitit kemi pasur, një vërshim kërkesash nga qytetarët për rimbursim ose kompensim të blerjes së citostatikëve dhe barnave tjera të cilët kanë qenë në listë esenciale dhe kanë qenë të domosdoshme dhe të shtrenjta.

Ne e kemi bërë edhe një analizë të atyre kërkesave dhe në ndërkohë, për të gjitha barërat që jemi të furnizuar, ua kemi bërë me dije, ua kemi kthyer përgjigjen se barërat janë nëpër klinika, për barërat që ende nuk kemi furnizim, jemi duke i vlerësuar dhe do t'i përkrahim, do t'i kompensojmë nga Fondi për trajtim jashtë institucioneve publike.

Po them se këtë bari tash u bë një javë që e kanë në dispozicion klinikat dhe pacientët.

KRYETARI: A ka pyetje shtesë?

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Faleminderit, kryetar!

Pyetja shtesë është:

Ku mund t'i marrin saktësisht pacientët këto barëra, në Ministri apo në klinikat në spitalet regjionale?

KRYETARI: Urdhëro, zoti ministër!

MINISTRI IMET RRAHMANI: Jo, këto barëra mund të merren në Klinikë, sepse spitalet regjionale unë nuk besoj që japin citostatikë. Nuk do duhej të jepnin! Dhe tash i marrin në

Klinikë dhe unë besoj se i kanë marrë, sepse është shqetësim që është e ngritur edhe nga deputetët tjerë, konkretisht për këtë bari.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Zoti Çoçaj, pyetje për ministrin Arsim Bajrami. Nuk është këtu. Atëherë, deputeti Kurteshi, pyetje për kryeministrin Mustafa. Kryeministri s'qenka këtu. Zoti Kurteshi, nëse dëshironi, e keni fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Kjo ikja për të cilën foli Donika, e që po u ndodh shpesh ministrave dhe kryeministrit po m'i përkujton disa nxënës që ndonjëherë nuk janë të përgatitur për orë të mësimi dhe e lëshojnë orën e mësimi.

Është mirë të vijnë të përgatitur dhe mos të lëshojnë vendin, siç ndodhi tash me kryeministrin.

Unë do ta lexoj pyetjen që e kam të drejtuar për kryeministrin.

Duke bërë koalicion me Listen Serbe, zoti kryeministër, ju i keni zëvendësuar përfaqësuesit e minoritetit serb me përfaqësuesit e shtetit të Serbisë dhe kështu i keni sjell dëm të madh vendit, po edhe minoritetit serb.

Këto ditë keni deklaruar se strukturat e sigurisë së Serbisë do të shuhen, po në të vërtetë ato do të punësohen në institucionet e Kosovës. Të njëjtit me siguri do të vazhdojnë të punojnë për Serbinë, siç po bëjnë deputetët dhe ministrat e Listës Serbe.

Zoti kryeministër,

Ku e keni bazuar të drejtën për të futur në institucione struktura të Serbisë, që hapur po punojnë kundër shtetit të Kosovës? A keni për këtë kategori që po e punësoni pa asnjë kriter dhe pa proceduar, të paraparë me ligj, sepse dihet shumë mirë se si dikush mund të punësohet në institucionet publike të këtij vendi.

KRYESUESI: Faleminderit! Tani pyetje shtesë, s'ka nevojë. Deputeti Ismajl Kurteshi, përsëri pyetje për ministrin Bajrami, ministri nuk është këtu, po më duket. E dëshironi fjalën, zoti Kurteshi? Zoti Kurteshi e ka fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Po e lexoj, sepse dy pyetje i kam pasur herën e kaluar, dhe nuk kanë qenë as ministri, as kryeministri.

Zoti ministër,

Me gjithë faktin që në Kosovë ka kuadro të kualifikuara për shkollat fillore dhe të mesme për të gjitha lëndët. Ka shumë raste kur drejtoritë e arsimit kanë punësuar në mënyrë të paligjshme shpesh pa konkurs individë të pakualifikuar. Po ashtu, ka raste që dihen se individë të caktuar kanë diploma të falsifikuara ndaj të cilëve jo vetëm se nuk është ndërmarrë asgjë, por të njëjtit punojnë derisa të kualifikuarit presin me vite të tëra për një vend pune.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Lah Ibrahimaj, pyetje për ministrin Krasniqi. Lahiu, nuk është këtu. Zonja Bytyqi, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa. Zonja Bytyqi, e dëshironi fjalën? Urdhëroni!

SHUKRIJE BYTYQI: Faleminderit, kryesues!

Unë po ndërlidhem me zotin Ismajli, i cili tha se nxënësit e lëshojnë orën, dhe vërtet nxënësit e papërgatitur e lëshojnë orën kur kanë pyetje. Pikërisht këtë po e bën e Qeveria e Republikës së Kosovës.

Unë e kam ngrehur këtë çështje edhe në seancën e kaluar dhe vërtet është një problematikë që është aktuale.

Domethënë viteve të fundit është përhapur epidemia e etheve hemorragjike ‘krime-kongo’, e cila i ka përfshirë pesë komunat e Republikës së Kosovës.

Sipas të dhënave nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik dhe të rajonit të Prizrenit prej vitit 2001 deri në vitin 2014 kanë vdekur 34 qytetarë të Republikës së Kosovës, 18 prej tyre kanë qenë nga komuna e Malishevës.

Këtë vit Qeveria e Kosovës ende s’na ka lajmëruar që për buxhetin që ka ndarë. Pyetja është: Sa keni paraparë buxhet për këtë vit për spërkatjen e zonave endemike të komunave të prekura nga ethet hemorragjike ‘krime-kongo’. Normal se s’ka përgjigje se nuk është kryeministri këtu, por ne do të shtrojmë pyetje vazhdimisht.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bytyqi, pyetje për ministrin Imet Rrahmani. Urdhëro!

SHUKRIJE BYTYQI: Faleminderit, kryesues!

Pyetjen unë e kam bërë më 8 maj 2015, pyetja ka të bëjë me Këshillin Ndërmnistror. Kam informacion që Këshilli Ndërmnistror është takuar, pyetja e seancës së kaluar ka qenë se pse këtë vit ende nuk është mbajtur asnjë takim i Këshillit Ndërmnistror. Tani e di që Këshilli Ndërmnistror ka mbajtur takim. Pyetja që sot unë do ta bëjë është që pse asnjë përfaqësues i Komunës së Malishevës nuk është ftua në këtë takim të Këshillit Ndërmnistror.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI IMET RRAHMANI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Ethet hemorragjike ‘krime-kongo’ janë trajtuar me seriozitetin më të madh nga institucionet shtetërore të Kosovës. Me vetë faktin e themelimit të Këshillit Ndërmnistror dhe rikonfirmimit në muajin e fundit të këtij këshilli, në përbërje të shumë institucioneve kompetente flet që ne jemi duke e trajtuar këtë problematikë me seriozitetin më të madh.

Është bërë plani i veprimit, plani operacional dhe të gjitha fazat e planit të veprimit janë duke u implementuar në kohën ashtu siç janë paraparë dhe në mënyrën ashtu siç janë paraparë nga këshilli.

Ne më 13 shkurt të këtij viti e kemi bërë një vizitë në komunën e Malishevës si Ministri e shëndetësisë bashkë me përgjegjësitë e Institut Kombëtar të Shëndetit Publik, ku kanë marrë pjesë edhe gjithë përfaqësuesit e komunave, që tash ne i quajmë mendimike të rrezikuara nga kjo sëmundje.

Pse nuk ka qenë një përfaqësues i Komunës së Malishevës? Them që aty ne i kemi lidhjet dhe koordinimin e mjaftueshëm të Këshillit Ndërmintor dhe të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik me ekipet përkatëse nëpër komunat, jo vetëm të Malishevës, por edhe në komunat tjera entikime të prekura nga kjo.

Në Këshillin Ndërmintor nuk janë paraparë përfaqësuesit e pushtetit lokal dhe kjo është arsyeja pse s'janë të thirrur. Faleminderit!

KRYESUESI: Pyetje shtesë, zonja Bytyqi?

SHUKRIJE BYTYQI: Ne e dimë që vitin e kaluar, domethënë më 2013, është formuar Këshilli Ndërmintor dhe zakonisht në çdo takim kanë qenë përfaqësuesit e komunave të paktën ka qenë përfaqësuesi i Komunës së Malishevës si zonë endemike.

Pyetja shtesë që unë do ta shtroj është: A keni siguruar ju si ministri repelan për qytetarët e Kosovës, e veçanërisht për ata të cilët janë të angazhuar në terren për repelimin e kafshëve dhe për spërkatjen e zonave endemike.

KRYESUESI: Zoti ministër, urdhëroni!

MINISTRI IMET RRAHMANI: Më fal, zonja deputete, kërkoj falje, nuk e dëgjova pyetjen drejt.

SHUKRIJE BYTYQI: Duke e ditur rrezikshmërinë e qytetarëve sidomos të atyre që janë të angazhuar edhe në repelimin e kafshëve edhe në spërkatjen e tokave e zonave endemike, a keni siguruar repelan për qytetarët anëtarë që janë të angazhuar në këtë sezon?

MINISTRI IMET RRAHMANI: Repelimin e kafshëve e bëjnë ekipet e profesionistëve dhe janë planifikuar katër faza të repelimit të kafshëve që do të bëhen nga profesionistët përkatës dhe tri faza e para do të financohen nga buxheti i paraparë më herë ndërsa një është donacion nga organizatat e huaja.

Është duke u bërë edhe dezinfektimi selektiv në terren dhe në koordinim me komunat përkatëse janë duke u zgjedhur edhe ngastrat të cilat do të trajtohen. Kështu që qytetarët sigurisht që janë të informuar për rreziqet edhe masat mbrojtëse, ndërsa këto procedura janë duke u bërë nga profesionistët, të cilët edhe normalisht që e kanë mbrojtjen.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Shaip Muja, pyetje për ministrin Imet Rrahmani.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryesues!

Po pres ministri derisa të ulet se e kupton pyetjen drejt korrekt mandej.

Faleminderit, zoti kryesues!

Pyetja ime bazohet kështu: Ne sot angazhohemi që t'i ruajmë kuadrot specifike të qëndrojnë dhe të punojnë në republikën e Kosovës. Sipas të dhënave të sakta që kam ka mjek që bëjnë specializim të cilët janë duke u specializuar në Kosovë me një kontratë pa pagesë. Më intereson sa veta janë duke u shkolluar pa pagesë në sistemin shëndetësor dhe ku jeni bazuar për një vendim të tillë, duke u specializuar?

Dhe dy, sipas ligjeve në Kosovë, Ligjit të punës dhe ligjeve për të drejtat e njeriut dhe kundër diskriminimit, a ka elemente për shkelje ligjore në këto vendime për këto kuadro. Çfarë planesh keni që në rishikim të buxhetit të përfshini në pagesë bile të nivelit të mjekut të familjes, këto kuadro specifike? Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI IMET RRAHMANI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

I nderuar deputetë,

Problematika e specializimeve dhe specializantëve edhe në mbledhjen e kaluar është trajtuar, pas pyetjes të parashtruar nga zonja deputete, zonja Emini.

Natyrisht që kjo çështje donë trajtim edhe shumë herë dhe shumë më gjatë sepse kemi të bëjmë me ndërlidhjen e pakontestueshme të Ministrisë së arsimit respektivisht Dekanatit të Fakultetit të Mjekësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë.

Specifikat e edukimit dhe përgatitje profesionale nga niveli bazikë, specialistik dhe deri te ai supspecialistik i profesionistëve shëndetësorë kërkon analizë të mirëfilltë të nevojave të sistemit shëndetësor, planifikim mbi bazën e këtyre nevojave të numrit të studentëve e më vonë numrit dhe profilin e specializimeve dhe sistemimin e këtyre specialistëve në sistemin shëndetësor. Tek pas kësaj analize do të duhej të jepen specializimet dhe sigurisht që do të planifikojë edhe mënyrën e mbështetjes respektivisht financimit të specializimit.

Me qenë se profesioni dhe profili i specializimit gjithmonë paraqet edhe shprehjen e vullnetit individual me qëllim që t'u jepet mundësia atyre që dëshirojnë specializim jashtë asaj që ka mundësi sistemi publik respektivisht Ministria e Shëndetësisë. Janë paraparë edhe format e specializimeve me vetëfinancim. Neni 10, i udhëzimit administrativ 10/2014. Kjo është baza.

Sot janë duke u shkollua pa pagesë 195 specializantë nga grupi B, 137 specializantë nga grupi C dhe 8 nga grupi Ç.

Shuma vjetore për pagat e specializantëve nga Grupi A, për të cilat Ministria e Shëndetësisë ka obligime ligjore për pagesë është 2 milionë e 64 mijë euro, kurse të planifikuara janë tash për tash një milionë e 594 mijë e 819 euro.

Për specializantët e paguar nga performansa dhe transferet janë një milion e 703 mijë e 725 euro të parapara. Ky grup i specializantëve ka kontratë deri në gusht dhe është duke u zvogëluar numri i tyre varësisht prej diplomimit të specializimit respektivisht.

Shifrat që i thashë më lart japin përgjigje edhe në pjesën e fundit të pyetjes. Ne përpos përgjegjësave njerëzore dhe kolegjiale duke u bazuar në kontratat e nënshkruara në mes të dy palëve si Ministri e Shëndetësisë nuk kemi asnjë obligim ndaj këtyre specialistëve.

Në rishikim të buxhetit do të angazhohemi në mbushje të zbrazëtirës për specialistët e kategorisë A dhe 37 të tjerëve nga kategoria A, që ende janë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Pyetje shtesë, Shaip?

SHAIP MUJA: Zoti ministër, nga shpjegimi që dhatë tregon do të thotë që ju nuk keni një analizë të bazuar pse i edukoni kuadrot se thatë ashtu vetë ashtu, duhet një analizë shumë e fugët do të thotë paraprakisht nuk e keni të bazuar në analizë por keni marrë një vendim i cili bërë shkarje ligjore qoftë nga ju, apo nga ministri paraprak.

Dhe e dyta, kur thoni se nuk keni asnjë obligim. Unë mendoj që sot kam mendua ju do të paraqitni që në digasterët e veçantë të Republikës së Kosovës në sistemin shëndetësor të Kosovës mungojnë kaç, janë duke u shkolluar kaç, pensionohen kaç dhe ne kemi obligime. Për këtë arsye mendoj që qasja që po i bëhet trajtimit të kuadrove, jo që është e dëmshme, por jemi duke e zbrazur Kosovën nga kuadrot dhe të jesh i bindur për këta kuadro që thatë ju që nuk keni asnjë obligim, janë disa...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

MINISTRI IMET RRAHMANI: I nderuar deputet, Asnjë obligim nuk kemi në kuptimin e financimit të tyre, si dhënies së pagave, për shkak se ne po zbatojmë vendimet dhe kontratat të cilat janë marrë më herët dhe thash kanë kontrata deri në gusht.

Me udhëzimet administrative të mëhershme unë nëse ju lodh kisha për të thënë që nga viti 2003 janë ndërruar shtatë udhëzime administrative, të cilat e kanë rregulluar këtë fushë, respektivisht specializimin e kuadrove edhe në shëndetësi.

Me udhëzimin e fundit 10/2014 parashihet që financimi i specialistëve mund të bëhet nga burimet, si: buxheti i ministrisë, buxheti i komunave, institucione shëndetësore publike dhe private dhe burimet vetanake financiare.

Kur thash që duhet të planifikohet, duhet ta keni parasysh se është ky muaji i gjashtë që unë jam në krye të Ministrisë së Shëndetësisë dhe jam duke i zbatuar dhe i menaxhuar vendimet e mëhershme dhe udhëzimet ose ligjet e mëhershme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Haxhiu, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

E di që kryeministri heziton me u përgjigj në pyetjet e deputetëve, mirëpo duke pasur parasysh se është ekspert shumë i madh edhe njëkohësisht e ka edhe një zëvendëskryeministër edhe një staf që e ka çmua shumë, kam pritë që do të na përgjigjet në pyetjet.

Unë këtë pyetje e kam bërë kohë më parë dhe kam thënë që do ta përsëris vazhdimisht. Pyetja ka të bëjë me moskompletimin e Kabinetit qeveritar, përkatësisht me numrin e zëvendësministrave.

Qytetarët janë të interesuar të dinë se kush janë ata zëvendësministra t'i publikon në WEB faqen e kryeministrit e ka obligim dhe është mirë me e ditë pra sa është numri i tyre, sot e kësaj dite edhe pas kaq muajve kryeministri nuk është në gjendje të i qetë emrat e tyre por vazhdimisht një nga një fshehurazi i emëron, ndoshta po pret që të kryhen edhe zgjedhjet e brendshme të LDK-së sepse edhe në atë formë po i shantazhon edhe militantët partiakë. Pra, po e shfrytëzon kryeministrin edhe për interesat të partisë së vetë, kryesisht të interesit personal në kuadër të partisë. Nuk është mirë, nuk është serioze t'i përziej këto gjëra, unë prapë do ta bëj këtë pyetje, derisa kryeministri të jetë i gatshëm të përgjigjet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Teuta Haxhiu, pyetje për ministrin Mahir Yagcilar.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit !

Qeveria e Republikës së Kosovës më 24 dhjetor 2012, ka nxjerrë Rregulloren numër 33/12, e cila ka të bëjë me shtesat në pagë dhe kompensime tjera për nëpunësit civilë.

Ndër të tjera në nenin 9, të kësaj thuhet: "Shtesa për përvojë të punës". Në pajtim me nenin 18 të Ligjit për pagat e nëpunësve civil për çdo vit pune në shërbimin civil duke përjashtuar vitet e përvojës në punën praktike, nëpunësi civil do të marr një shtesë nga 0,5% të pagës bazë.

Në po këtë rregullore në nenin 24 të saj thuhet: "Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit", përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, neni 9 i kësaj rregullore fillon së zbatuari nga 1 janari i vitit 2014. Pyetja ime për ministrin është: A po zbatohet kjo rregullore, ministër?

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, urdhëroni!

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

E nderuar deputete Haxhiu,

Rregullorja numër 33 viti 2012 për shtesat dhe kompensimet tjera të nëpunësve civil ka paraparë që shtesa prej 0,5% të fillojë së zbatuari nga data 1 janar i vitit 2014. Por, në mungesë të klasifikimit të vendeve të punës, të zbatimit të plotë të Ligjit për pagat të nëpunësve civil edhe ndoshta prej çështjeve financiare deri në këtë muaj nuk është zbatuar. Por me vendimin e Qeverisë javën e kaluar ku janë përcaktuar kriteret sa i përket përvojës së punës, për të gjithë përfituesit nga buxheti i Republikës së Kosovës edhe vendimi i djeshëm nga Qeveria prapë për përcaktimin e fondeve sa i përket realizimit të pagesës 0,5%, në qoftë se nuk krijohet ndonjë problem teknik për këtë muaj do të zbatohet, jo vetëm për shërbyesit civilë ose nëpunësit civil, por për të gjithë përfituesit nga paga, nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

Për këtë muaj ndoshta mund të ndodhë disa probleme teknike por edhe me dërgimin e gjithë dokumentacionit të nevojshëm kjo çështje pritet të kompletohet në tërësi prej muajit ose faktikisht prej 10 qershorit të muajit të ardhshëm. Por, zbatimi fillon nga ky muaji për çdo pagesë për fituesit e pagave nga Buxheti i Republikës së Kosovës, jo vetëm për nëpunësit civilë.

KRYESUESI: Pyetje shtesë, zonja Haxhiu?

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Ju po i përmendni ministër, që mund të ketë ndoshta ndonjë çështje teknike për këtë muaj, derisa në mbledhjen e Qeverisë javën e kaluar keni deklaruar që janë diku 11 milionë para të gatshme përderisa për pagesën e gjithë shërbyesve civilë kërkojnë diku rreth 30 milionë. Unë prapë do të ju pyes a do të fillohet kompensimi për 0,5% të pagës bazë nga 1 janari në mënyrë retroaktive, sepse ju obligon Rregullorja.

Dhe, çështja e klasifikimit të vendeve të punës, pse ministër nuk e keni bërë edhe pas kaq vitesh klasifikimin e vendeve të punës. Cilat janë arsyet pse nuk po e bëni pra këtë klasifikim të vendeve të punës që ju obligon Ligji për shërbimin civil, ligj i cili është miratuar në vitin 2011 dhe kërkesa për t'u ndryshuar është gati që një vit dhe ju ende nuk e keni proceduar, derisa edhe ato rregullore që i keni në fuqi nuk po i implementoni.

Pra, edhe një herë, a do të filloj, a do të bëhet pagesa në mënyrë retroaktive duke i obliguar, pra kjo rregullore nga 1 janari 2014.

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Pagesa do të realizohet siç kanë thënë prej këtij muaji, faktikisht me pagesën për muajin maj do të realizohet 0,5%.

Ndërsa sa i përket klasifikimit të vendeve të punës është një temë shumë më e gjerë dhe në këtë aspekt unë tash nuk mundem përbrenda dy minutshi të jap përgjigje. Por, tash është përfunduar katalogu i vendeve të punës dhe pritet të bëhen të gjitha klasifikimet nëpër institucione. Ka probleme teknike, ekzistojnë edhe probleme për institucione sepse me vonesë janë dërguar të gjitha të dhënat sa i përket klasifikimit.

Por, besojmë që brenda vitit, sepse kërkohet edhe me reformën e Administratës Publike dhe nga Raporti i Progresit evropian të përfundojmë sa më shpejt. Katalogu është përfunduar, tash pritet klasifikimi të vendeve të punës për shërbyesit civilë nëpër institucione. Por, ka nevojë edhe përkrahje nga institucionet me hartimin e klasifikimit edhe propozimet në përputhje me ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bekim Haxhiu, pyetje për ministrin Imet Rrahmani.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar Haliti!

I nderuar ministër,

Me Ligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015 janë paraparë investimet në kardiokirurgji dhe në muajin nëntor 2014 është nënshkruar marrëveshja ndërmjet Shërbimit

Spitalor Klinik Universitar të Kosovës dhe Qendrës Spitalore Klinike Universitare të Tiranës për ofrimin e shërbimeve kardiokirurgjie nga ekspertët të QSTU-së, në kuadër të shërbimit të kardiokirurgjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

Dhe, gjashtë muaj pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje qytetarët nuk arrijnë që këtë shërbim ta marrin institucionet publike.

Ndërsa ju, i nderuar ministër, në seancën e Kuvendit të Kosovës dy javë më parë deklaruat se e keni formuar një këshill për kardiokirurgji dhe deklaruat se buxhetin e paraparë për kardiokirurgji nuk e keni shfrytëzuar qëllimisht deri më tani, sepse në rishikimet e buxhetit planifikoni ta destinoni në projekte të tjera.

Mosfunksionalizimi i këtij shërbimi në bazë të asaj që deklaruat edhe ju dhe që dihet botërisht është në mungesë të kuadrit përkatës.

I nderuar ministër,

A e dini se me ridestinin të këtyre mjeteve ju po i privoni pacientët tanë që këtë shërbim ta marrin në institucione publike. Më intereson të di kush ju bindi që të hiqni dorë nga ky projekt pasi që me rastin e miratimit të buxhetit për vitin 2015, ju e keni mbrojtur si projekt me vlerë dhe me rëndësi.

Prandaj, i nderuar ministër, ju pyes: Kur do të mund pacientët tanë ta marrin këtë shërbim në institucionet publike në Klinikën e Kardiokirurgjisë? Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI IMET RRAHMANI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputetë,

Faleminderit për pyetjen e parashtruar,

Kardiokirurgjia dhe problemi i funksionalizimit të saj u diskutua edhe në takimet e kaluara të Kuvendit, pas pyetje të parashtruara nga disa anëtarë të Kuvendit.

Shqetësimi ishte se pse nuk kemi funksionale kardiokirurgjinë dhe problematikën e gjetjes së një zgjidhje të shpejtë. Duke mos dëshiruar që të përsëriten dhe t'ju marr kohë mund të shtoj këtë. Kardiokirurgjia nuk ka qenë funksionale edhe më herët, ne po synojmë që të funksionalizojmë këtë klinikë duke u marrë seriozisht me krijimin e kushteve dhe mundësive që të kemi shërbime 24 orë, shtatë ditë në javë.

Këshilli për Kardiokirurgji është duke punuar intensivisht në vlerësimin e nevojave të domosdoshme për optimalizimin e kushteve dhe rrethanave për punë normale, duke filluar nga nevojat teknike, aparaturë, personel, trajnime të stafit deri te forma stimulative për krijimin e shërbimeve cilësore dhe të qëndrueshme. Kam deklaruar dhe deklaroj edhe sot se investimet në aparaturë shumë të kushtueshme për rrethanat tona e cila nuk mund të shfrytëzohet në mungesë

të profesionistëve në baza të përhershme në kohën kur ne kemi mungesa të aparaturës bazike për të cilën e kemi personelin në klinika është e pakuptimtë.

Gjithashtu, këtë vendim edhe këtë bindje e kemi marrë pas konsultimeve me ekspertët dhe profesionistët e klinikave përkatëse. Edhe herën e kaluar kam thënë se mjetet e parapara për sallën hibride duhet ri destinuar dhe duhet përkrahur në ato mjete kardiokirurgjia, kardiologjia invazive, dhe shumë klinika tjera që për aparaturë disa mijëra euro nuk ofrojnë shërbime të caktuara edhe pse mjekët tonë janë në gjendje me i ofruar ato shërbime.

Me angazhimin tonë jemi duke synuar që këtë shërbim që nuk iu ka ofruar deri më tash qytetarëve këto shërbime, të i bëjmë të mundshme brenda sistemit publik shëndetësor dhe me një kosto efektivitet të përballueshëm për të gjithë. Projekti i kardiokirurgjisë është nga një prioritet tona, po në këtë fazë jo edhe salla hibride, sepse Kosova nuk e ka luksin e marrjes së kredive për aparatura që nuk do të shfrytëzohen menjëherë dhe shërbejnë vetëm për marketing politik dhe media.

KRYESUESI: Deputet, pyetje shtesë?

MINISTRI IMET RRAHMANI: Faleminderit, i nderuar ministër!

Ishte ajo që e kam thënë në dëgjime buxhetore, sa i përket sallës hibride, por do të doja veçanërisht për interesin e qytetarëve të deklaroni, të prononcoheni publikisht, hapja e kardiokirurgjisë në vitin 2013, ka qenë marketing politik, apo ka qenë në interesin e qytetarëve.

Fakti tjetër që më intereson mua është se këto ditë kemi një fluks të ikjes së kuadrove të tjera profesionistëve shëndetësor, mjekëve të specializuar dhe kuadrit të mesëm, më intereson saktë të di se cila është strategjia juaj si ministër për ndalimin e ikjes së mjekëve nga Kosova, për arsye se tani po përballemi me këto në probleme në kardiokirurgji dhe shpejti me probleme të ngjashme do të përballeni në sektorë të tjerë nëse vazhdon ky trend i ikjes të specialistëve nga Kosova apo mjekëve specialistë nga Kosova.

Dhe unë mendoj që në udhëzimin e ri që ju do të duhej ta punoni administrativ duhet të parashihni që mjekëve të cilët i financon Ministria e Shëndetësisë të kenë edhe kontratë pas përfundimit të specializimeve 5 apo deri në 10 vjet të obligohen në institucione publike, përndryshe nëse nuk bëhet një strategji e tillë unë mendoj që Kosova vërtet do të ketë mungesë të kuadrove mjekësore. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI IMET RRAHMANI: I nderuar deputet, faleminderit për sugjerimet dhe më herët siç e dini kontratat me specialistë ka ekzistuar edhe klauzola ose neni që ka detyruar specialistët të shërbejnë në institucionet publike por nuk është zbatuar.

Mos zbatimi i kësaj ka prurë edhe te paradoksi siç jemi sot ku kemi specialistë të papunë dhe kemi spitalin e Mitrovicës që mezi po e mbulojmë.

Është trend i lëvizjeve të ndryshme të profesionistëve shëndetësor jo vetëm në Kosovë, por edhe në Evropë dhe unë e kam thënë edhe më herët që mundësia e shkuarjes së mjekëve në Gjermani është krijuar nga lëvizjet e mjekëve gjerman në vendet tjera ku është më mirë. Nuk është kjo vetëm çështje e Ministrisë së Shëndetësisë, por është çështje e shumë sektorëve dhe besoj se më shumë nuk kam se çka ju them. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Xhevahire Izmaku, pyetje për ministrin Lutfi Zharku.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar ministër, ju falënderoj për përgjigjen e shpejtë se po ju shoh që jeni këtu. Pyetja ime drejtohet lidhur me ndërtimin e magjistrales Prishtinë-Vushtrri-Mitrovicë, ka vite që ka filluar ndërtimi i saj dhe siç shihet tash ditëve të fundit ka një dinamik më të shpejtë të punimeve, mirëpo për shkak që vonesat janë shkaktuar dhe ne e kemi edhe si qytetarë edhe unë kam hezitime se cilat janë arsyet domethënë që ka një dinamikë kaq të ngadaltë të punimeve, sot pres një përgjigje për mua dhe për të gjithë bashkëvendësit e mi, të cilët ka vite që i dëmtojnë veturat e tyre, por sigurisht që kemi dëgjuar ka pasur edhe fatkeqësi të ndryshme në komunikacion, për shkak të devijimeve në udhëtim.

Unë sot pres nga ju një përgjigje se deri kur mund të dimë, kur do të përfundojnë punimet kryesisht në magjistralen Prishtinë-Vushtrri-Mitrovicë, kur do të jetë afati i fundit që presim një përfundim? Të shpresojmë që do të jetë ndoshta këtë verë për arsye që edhe bashkatdhetarët tanë kur të vijmë dihet që ka mijëra prej tyre, të cilët qarkullojnë dhe sigurisht do t'i zhgënjëjmë nëse edhe këtë verë dhe do të vozisin veturat e tyre nëpër pluhur, mirëpo kjo kryesisht është për qytetarët, të cilët udhëtojnë dhe kanë një vend pune në Prishtinë, çdo ditë. Pra, unë pres këtë përgjigje nga ju. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: Zoti nënkryetar,

Ministra,

Deputetë të nderuar,

E nderuar deputete Izmaku,

Ministria e Infrastrukturës është duke e implementuar projektin në zgjerimin e rrugës nacionale Prishtinë-Mitrovicë në pjesën e rrugës Milloshevë-Vushtrri e ndarë sipas segmenteve në vijim: segmenti Milloshevë-Babimoc, segmenti Babimoc-Lumi i Madh dhe punët nën nënkalim dhe në urë në lokacionin Stanoc dhe Lumi i Madh.

Realizimin e projektit e kanë përcjellë probleme të shumta që nga fillimi e në veçanti problemet e shpronësimit dhe pengesat e krijuara nga komuniteti lokal rreth ndërtimit të objekteve të caktuara, siç janë nënkalimi dhe rruga lidhëse për kycje nga rrugët lokale në rrugën nacionale. Thënë më saktë, në segmentin Milloshevë-Babimoc kemi probleme me shpronësim të pronave ku janë 10 pronarë të paluajtshmërive që pengojnë në zhvillimin e punimeve. Disa nuk janë të kënaqur me vlerësim të pronës, kurse disa të tjerë kërkojnë zgjidhjen e problemeve të ndryshme infrastrukturore, siç është ujësjellësi dhe pengojnë ndërtimin e sipas projektit zbatues.

Në segmentin Babimoc-Lumi i Madh, ku përfshin ndërtimin në nënkalimin në fshatin Stanoc-Lumi i Madh kemi probleme me vijën e shpronësimit, e cila është ndryshuar pas revidimit të elaboratit të shpronësimit, si dhe me kompensimin e paluajtshmërive për 7 pronarë. Me qëllim të tejkalimit të këtyre problemeve, Qeveria gjatë këtij viti në mbledhjet e saj të rregullta ka marrë vendime përfundimtare për shpronësimin e këtyre pronave dhe tanimë jemi në fazat përfundimtare të implementimit të tyre.

Ministria e Infrastrukturës është në koordinim të ngushtë me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si resorë përgjegjës për shpronësim të pronave dhe Ministrinë e Financave si resorë përgjegjës për vlerësim të pronave të shpronësuar. Që në afat shumë të shpejtë të tejkalohen shumica e këtyre problemeve.

Duke marrë parasysh angazhimet e shtuara tona në përfundimin e këtij projekti, si dhe faktin se kompanitë e kontraktuara posedojnë kapacitete që t'i përfundojnë projekte sipas dinamikës së re, ne besojmë se punimet do të përfundohen para zezonës verore ku edhe pritet ardhja e bashkatdhetarëve tanë nga diaspora. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Puhie Demaku, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa. Dëshironi ta bëni pyetjen?

PUHIE DEMAKU: Faleminderit, kryesues!

Po e përsëris pyetjen e javës së kaluar e cila është bërë tashmë nga 13 maji i këtij viti, ka të bëjë me çështjen e raportit të presidentit të Lidhjes Qytetare Shqiptaro-Amerikane, zotit Xhozef Diogardit, i cili e ka paraqitur një raport real mbi Qeverinë e Kosovës para Komisionit për Punë të Jashtme të Kongresit Amerikan, meqë rast ai ka konstatuar se elita politike shqiptare në Kosovë është bërë gjithnjë e më e pasur ndërsa shumica e popullit gjithnjë e më e varfër.

Departamenti i shtetit duhet të marrë përgjegjësi ka thënë Diogardi për përkrahjen që i ka bërë Qeverisë Thaçi, e cila është shndërruar në ndërmarrje haraçi. Zëvendësi i Thaçit në Ministrinë e Punëve të Jashtme, zoti Petrit Selimi u kundërpërgjigj duke e fyer zotin Diogardin dhe duke thënë se deklaratat e këtij të fundit janë të njëjta si ato të Vuçiçit, Gjuriqit dhe të Jeremiqit.

Edhe njëherë po e përsëris pyetjen time, a pajtohet kryeministri dhe a pajtohet Qeveria me këtë qëndrim të zotit Petrit Selimi?! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Qeverisë nuk ka asnjë që dëshiron me tu përgjigj, ministri nuk është këtu, kryeministri. Deputeti Mytaher Haskuka, pyetje për ministrin Arsim Bajrami.

MYTAHER HASKUKA: Pasi ministri nuk është këtu edhe ai pati premtuar se dëshiron të përgjigjet në këtë pyetje, e s'po di a ta lë prapë edhe këtë.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Selimi nuk është këtu, zoti Haskuka pyetje për ministrin Abdullah Hoti.

MYTAHER HASKUKA: Në bazë të Ligjit nr. 04/L-09 Ligjin për personat e verbër neni 6, lirim nga taksat dhe tatimi, po e citoj ligjin: “Personat e verbër lirohen nga çdo lloj takse dhe tatimi të drejtpërdrejtë në rast të vetëpunësimit ata lirohen nga çdo detyrim fiskal, ndërsa në rast të zhvillojnë veprimtari si persona juridik ata gëzojnë lehtësira tatimore, të cilat i realizojnë sipas ligjit në fuqi”, po ashtu edhe të drejtat që janë specifikuar në kodin doganor dhe të akcizave në Kosovë, pra në Kodin nr. 03/L-109 tek dispozitat e përgjithshme, respektivisht në nenet 75, 76, 77 dhe 78. Këto të drejta nuk po respektohen sidomos nga doganat, unë kohëve të fundit personalisht jam informuar nga disa qytetarë të verbër që nuk mund të bëjnë importin e automjeteve dhe veturave të tyre, të cilët bllokohen në Dogana me muaj.

Pse nuk aplikohen dispozitat ligjore për këtë grup të cenuar të popullatës, apo edhe më keq pse aplikohen benefitet në mënyrë selektive?

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

I nderuar zoti Haskuka,

Baza ligjore që rregullon çështjen e mallrave të destinuar për të verbrit dhe personat e tjerë me nevoja të veçanta është e rregulluar me kodin doganor dhe të akcizave me nenet 74 deri 78. Bazuar në këto dispozita, të verbrit nuk gëzojnë të drejtën e lirit nga taksa doganore për automjete, pasi në bazë të nenit 78 paragrafi 2, pika b, i aneksit A të kodit doganor dhe të akcizave parashihet që në dokumentin e regjistrimit të shënohet vërejtja se automjeti nuk mund të huazohet, të jepet me qira apo të transferohet te personat e tjerë.

Derisa në nenin 79.1 parashihet se malli i liruar nuk mund të huazohet apo jepet në shfrytëzim dikujt tjetër. Bazuar në dispozitat ligjore 74 deri në 78 të aneksit A të kodit doganor dhe të akcizave personat e verbër lirohen nga detyrimet doganore për artikujt e dizajnuar enkas për avancim arsimor, shkencor dhe kulturor të këtyre personave.

Ne jemi duke punuar në Kodin Doganor që ta ndryshojmë që të mundësojmë që këta persona të lirohen nga taksat doganore për automjete dhe të mundësohet që këto automjete të transferohen tek një person i afërt që kujdeset për ta. Pra, duhet të ndryshohet baza ligjore, e cila besoj që gjatë qershorit do të vijë në Kuvend. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Haskuka?

MYTAHER HASKUKA: E falënderoj zëvendëskryeministrin edhe ministrin e Financave, kështu vetëm unë faleminderit që treguat që jeni duke punuar në ndryshimin e Kodit ligjor ngase ka diskrepansa, domethënë në njërin anë thuhet unë referohem në nenin 76 si për shembull artikujt dizajnuar për avancim arsimor, punësim apo për avancim shoqëror të personave të verbër që nënkuptoj që automjetet faktikisht iu duhen atyre që të shkojnë deri te vendi i punës në një Kosovë ku 80% e vendbanimeve nuk kanë transport publik, e atyre u duhet, domethënë kjo nuk është edhe bazuar në këtë nen besoj që ata është dashur ta gëzojnë të drejtën edhe për automjete por edhe në Ligjin për persona me aftësi të kufizuara specifikohet, që kujdestari mund ta regjistrojë veturën në emër të ose kujdestari...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zoti ministër, i the! Në rregull! Atëherë, zoti Selimi nuk është këtu, zonja Baftija pyetje për ministrin Rrahmani.

BESA BAFTIJA: Faleminderit, kryesues!

Vetë fakti që po bëhen pyetje të shumta drejtuar ministrit të Shëndetësisë, tregon se problemet në sektorin e shëndetësisë janë shumë të mëdha, andaj edhe ministri e ceki se këto pyetje po përsëriten, mirëpo këto janë shqetësimet të qytetarëve të Republikës së Kosovës, të cilat pyetje do të përsëriten derisa këto shqetësime apo këto probleme të gjejnë zgjidhje.

Të nderuar deputetë,

Të dhënat zyrtare të Institutit të Shëndetësisë Publike, si dhe të Ministrisë së Shëndetësisë tregojnë se kemi apo konstatojnë një ulje të insidencës së tuberkulozit. Prapëseprapë, është shqetësues numri i të prekurve me këtë sëmundje, vetë fakti se kemi një numër prej 846 të prekurve me TBC në vitin 2014 tregon se është një ulje, mirëpo nuk është edhe e mjaftueshme.

Ajo që është shqetësuese është sepse kemi një rritje të numrit të atyre apo të moshës që është moshë më vitale siç është prej moshës 25 deri 35-vjeçare, si dhe kemi paraqitjen e rezistencës në të sëmurët apo në trajtim me barërat antitubekulare.

Ministër, siç e dimë Organizata Botërore e Shëndetësisë, si dhe Fondi Global ka hartuar një strategji për çrrënjosjen e tuberkulozit deri në vitin 2020. Dihet se Fondi Global e ka ndihmuar Kosovën me një shumë të konsiderueshme për hartimin e kësaj strategjie, andaj pyetja ime konkrete është ku është mbërri me këtë strategji, deri ku është mbërri, si dhe me sa fonde është ndihmuar hartimi i kësaj strategjie për çrrënjosjen e tuberkulozit. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI IMET RRAHMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

E nderuar zonja deputete,

Prej vitit 2000 në Kosovë përkrahur nga OBSH-ja dhe mjekët e botës ka filluar programi i tuberkulozit dhe aplikimi i programit të trajtimit të shkurtë të ashtuquajtur “dots” si formë e menaxhimit të trajtimit të pacientëve me mbikëqyrje të drejtpërdrejtë. Në vitin 2001 filloi për herë të parë funksionimi zyra dhe zyrtari për TBC-në në Ministrinë e Shëndetësisë. Ky program është përkrahur në vazhdimësi prej vitit 2004 dhe u funksionalizua me 2006 me grandet nga Fondi Global, i cili është edhe donatori më i madh në botë për luftimin e sëmundjeve të tuberkulozit, malaries dhe HIV AIDS-it.

Ka pasur disa përparësi Kosova nga viti 2004, po themi “përparësi” për të qenë përfituese të këtij grandit si arsye politike gjendja menjëherë pas luftës, popullata e varfër dhe numri i lartë i insidencës së të prekurve nga tuberkulozi. Vlera financiare e ofruar si grand, mbështetje nga

Fondi Global për programin e TB-së në Kosovë llogaritet për vitet 2006-2011 rreth 4 milionë euro. Ndërsa, për vitet 2013-2015 përafërsisht 2 milionë e 690 mijë euro.

Ndërsa, pritet që ne nga marrëveshja e re ose vazhdimi i ndihmës të fitojmë rreth 2 milionë e 400 mijë euro. Nga Ministria e Shëndetësisë është kërkuar në këtë bashkëfinancim të ofrojnë infrastrukturën, domethënë vlerën e spitaleve, repartet, dispanzerët në regjione dhe resurset njerëzore si mjek, pulmolog të specializuar, infermierë dhe stafin mbështetës.

Prej vitit 2006 janë trajnuar rreth 800 mjekë dhe infermierë që punojnë në kujdesin parësor shëndetësor, me qëllim që vazhdimi i trajtimit dhe përcjellja e pacientëve me TB-të të mund të bëhet në të ardhmen në këto institucione. Në Ministrinë e Shëndetësisë është formuar prej 8 vjetësh edhe mekanizimi koordinues për Kosovë për programet HIV dhe TB. Me zyrtarë dhe përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë, shoqëria civile, komuniteti fetar, institucionet qeveritare etj., OBSH-ja, Qeveria e Luksemburgut etj., ky mekanizëm mbledhet në mënyrë periodike dhe merr vendime të cilat janë shumë të rëndësishme për këto programe.

Në Ministrinë e Shëndetësisë prej janarit 2014 është formuar njësi për TB me organogram me strukturë funksionale që shtrihet në regjione, në 7 regjione të Kosovës. Është përfunduar plani i veprimit për programin kombëtar të TB-së për 2016-2018 dhe për herë të parë është vendosur si prioritet sëmundja e tuberkulozit dhe ky program me strategji sektoriale shëndetësore.

Është përfunduar koncepti notat për aplikimin të grandit, siç thash për përfitimin e vlerës 2 milionë e 400 mijë euro për 2016-2018. Ministria...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Vazhdoja fjalën ministrit...!

MINISTRI IMET RRAHMANI: Ministria u zotua se gjatë viteve 2016, 2017, 2018 të fillojë të bëjë blerjen e barërave antituberkulare të gjeneratës së parë, si dhe prej vitit 2018 edhe të gjeneratës së dytë.

Po ashtu, ministria është zotuar për fillimin e blerjes së reagjensëve të një X-ray ose rëntgenit në Spitalin e Pejës për 100 mijë euro në vitin 2016 dhe pajisjet në laboratorë, në total 539 mijë euro në buxhet.

Meqenëse koha është e limituar, e nderuar deputete, ju falënderojmë shumë që e ngritët këtë çështje, po ju themi që kontrolli i tuberkulozit është një storie e suksesit në Kosovë, numri i të sëmurëve me TB është 46 në 100 mijë banorë për vitin 2014 dhe të gjithë, domethënë 88 raste më pak se në vitin 2013, që kanë qenë 54,4 për 100 mijë banorë.

Rezultatet e trajtimit kanë qenë 86% të përfshirë, shkalla e vdekshmërisë është 1,43 në 100 mijë banorë. E rëndësishme është që për asnjë ditë të sëmurëve me TBC nuk u mungon terapia në institucionet tona publike. Në Kosovë ka gjithsej pacientë me rezistencë në terapi me shumë barna, që është numër i vogël në krahasim me regjione dhe vetëm një rast të ri e kemi pas në vitin 2014.

Dhe, është një diçka shumë me rëndësi - programi i TB-së është i vetmi program, i cili raporton rregullisht në baza vjetore në Organizatën Botërore të Shëndetësisë dhe të dhënat e tij dalin në ueb-faqen zyrtare të OBSH-së.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zonja Baftija.

BESA BAFTIJA: Faleminderit ministër për këto sqarime! Më intereson të di Fondi Global dihet se prej vitit 2001 deri në 2004 ka qenë nën menaxhimin e Ministrisë së Shëndetësisë, më pastaj ky Fond Global është menaxhuar nga Organizata Joqeveritare CDF dihet se ka pas mosmarrëveshje apo ka pas keqpërdorime siç flitet për atë arsye edhe Fondi Global ka kaluar në këtë organizatë.

Mirëpo, prapë po kemi informacione se ky fond po flitet se do të kalojë nën menaxhimin e Ministrisë së Shëndetësisë. A mund të më tregoni arsyen pse kjo po bëhet? Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI IMET RRAHMANI: Zonja deputete faleminderit, po nuk është e vërtetë që është qëllimi të kalohet në menaxhim të Ministrisë së Shëndetësisë, është kërkesë e Fondit Global që të rishikohet çështja e marrësit primar që në këtë rast ka qenë CDF dhe të bëhet rihapja e vlerësimit, respektivisht ri tenderimi i mundësisë të ose rikonfirmimi të CDF-së si marrës primar ose të gjetjes të një ofertuesi më të mirë, më të përgjegjshëm.

Kjo do të thotë që nuk e mohon mundësinë që edhe Ministria e Shëndetësisë me kapacitetet që ka të konkurrojë dhe nëse i plotëson kushtet edhe të jetë marrësi primar. Interesi i Ministrisë së Shëndetësisë është që të jetë marrës primar, sepse pas dy vjetëve pretendojmë që këtë projekt vetësisht të pavarur nga Fondi Global ta qojmë tutje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Pal Lekaj, pyetje për zëvendëskryeministrin Hashim Thaçi, E dëshironi fjalën?

PAL LEKAJ: Faleminderit, kryesues!

Edhe pse mungon zëvendëskryeministri dhe ministri i Punëve të Jashtme më duhet ta shtroj këtë çështje, sepse gjatë fushatës elektorale kanë premtuar shumë për krijimin e komunave të reja.

Ish kryeministri i Kosovës kishte kërkuar edhe zyrtarisht në Kuvendin e Kosovës krijimin e komunave të reja, madje edhe në ato lokalitete ku banorët nuk kanë parashtruar kërkesë, mirëpo vendimet e gjertanishme për krijimin e komunave të reja dhe premtimet për themelimin edhe të më shumë komunave, po bëhen pa ndonjë vlerësim adekuat nga ministrinë përkatëse, ashtu siç kërkohet me Ligjin për kufijtë administrativë komunalë.

Edhe përkundër që nuk ekziston bazë e mjaftueshme ligjore për krijimin e tri komunave të reja, është marrë vendim elektoral nga Qeveria e Kosovës.

Pyetja: Çka po ndodhë me këtë proces për krijimin e komunave të reja dhe a ka qenë premtim elektoral apo, ndoshta po e presin prapë fushatën tjetër? Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Topalli, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa. Dëshironi ta bëni pyetjen Faton?

FATON TOPALLI: Faleminderit!

Pyetja ime ka të bëjë me Kartonin e gjelbër. Ju që jeni kundër, mos u shqetësoni!

Në deklarin tim në pikën jashtë rendit të ditës, thashë ju që jeni kundër mos u shqetësoni, e kam fjalën për mazhorancën, në pyetjen respektivisht në deklarin jashtë rendit të ditës, shtrova një çështje shumë të rëndësishme, e cila ka të bëjë me një krim të organizuar, ndërsa kryetari i Kuvendit, zoti Veseli, tha që duhet të shkoj në Prokurori.

Mendoj që fola në organin më të lartë të vendit, në Kuvend, i cili është edhe përmbi prokurori, prandaj, normalisht kur një deputet shtron një çështje, prokurori i shtetit, jo që duhet të veprojë, por duhet të vrapojë për ta zgjidhur atë çështje.

Tani, sa i përket pyetjes. Deri më tani ka pasur disa deklarime në Kuvendin e Kosovës rreth Kartonit të gjelbër. Një deklarin në maj të këtij viti është bërë nga zonja Edita Tahiri, e cila ka deklaruar se kjo çështje nuk po rregullohet për shkak se Kosova nuk është anëtare e KB-së, gjë që nuk qëndron për arsye se as Zvicra nuk ka qenë deri në vitin 2002 anëtare e KB-së, megjithatë e ka pasur Kartonin e gjelbër.

Në shkurt të vitit 2014 zoti Rrahim Pacolli, drejtor i Byrosë së Sigurimeve, ka deklaruar që mërgimtarët shumë shpejt do të kenë mundësi të udhëtojnë gjatë vitit me Kartonin e gjelbër, gjë që nuk është realizuar.

Së fundi, morëm lajmin nga Kuvendi, se tash vetë Byroja e Sigurimeve në Kosovë ka gjetur një zgjidhje, duke premtuar se për disa ditë gjatë muajit korrik do t'i zvogëlojë për 50% tarifat. Pra, vetëm për disa ditë, gjatë muajit korrik, pra po na ofrojnë disa sheqerka për mërgimtarët, për ta marrë tortën për vete 12-13 milionëshe, siç e kanë bërë çdo vit. Edhe zoti Thaçi nuk është deklaruar, edhe pse kjo është detyrë e tij, aspak se çfarë ka bërë në lidhje me kartonin e gjelbër, si ministër i Punëve të Jashtme.

Pyetja ime për kryeministrin është kjo: Sa marrëveshje bilaterale është duke përgatitur institucioni që drejtoni ju, respektivisht vartësi juaj, ministri i Punëve të Jashtme, zoti Thaçi për çështjen e Kartonit të gjelbër dhe me cilat vende?

KRYESUESI: Faleminderit! S'janë... as kryeministri nuk është këtu. Në rregull, është edhe vetëm një pyetje dhe e përfundojmë.

Zonja Xhevahire Izmaqu, pyetje për ministrin Valon Murati. Po i përfundojmë të gjitha, se i kaluam pesë minuta.

XHEVAHIRE ISMAKU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Pyetja ime ka të bëjë me trajtimin e bashkatdhetarëve tanë, tani në kohën e verës, kur dihet që kemi një ardhje të shumtë të tyre, i nderuar ministër, unë dje e pashë një marrëveshje, memorandum që ju keni bërë me komunat.

Dhe, pyetja ime është shtruar para se të bëhet kjo marrëveshje, po sigurisht se s'ka asgjë të keqe, që ne të marrim informacione si deputetë, po edhe bashkatdhetarët tanë që presin me gëzim ditën kur ata do të vijnë në vendin e tyre.

Që nga paslufta ne e dimë që ardhja e bashkatdhetarëve ka paraqitur një festë për vendin tonë dhe bashkatdhetarët, ndoshta edhe janë mjaftuar në fillim vetëm me mikpritje dhe me pankartat “Mirë se erdhët në vendlindje”, mirëpo sigurisht që prej shpalljes së Pavarësisë e këndej, ata kërkojnë trajtimin e tyre më dinjitoz dhe është shumë e drejtë. Kjo ka filluar të bëhet dhe dihet që vitet e fundit në komuna bëhet një pritje e organizuar, rritet orari i shërbimeve, mirëpo unë konkretisht dua të di, duke parë që ju e keni marrë shumë për zemër punën tuaj dhe për këtë ju inkurajoj dhe ju përgëzoj, se çfarë vërtet ka në këtë memorandum? Deri ku kanë shkuar përgatitjet e kryetarëve të komunave për pritjen e bashkatdhetarëve tanë? A janë ata të informuar për të gjitha procedurat, kryesisht në hyrje me Serbinë, kur dihet se po kanë shumë probleme në daljet e tyre dhe, për shërbimet të cilat presin ata që t'u ofrohen?

Unë paraprkisht ju falënderoj për përgjigjen e shpejtë.

KRYESUESI: Faleminderit për pyetjen!

MINISTRI VALON MURATI: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

E nderuar deputete Izmaku,

Faleminderit për pyetjen dhe interesimin e juaj për përgatitjet që jemi duke i bërë, për pritjen e bashkatdhetarëve, që tradicionalisht vijnë në atdhe gjatë muajve të verës.

Gjatë këtyre ditëve së bashku me bashkëpunëtorët e mi kemi vizituar, po thuajse të gjitha komunat e Kosovës në përpjekje, që bashkërisht të kontribuojmë që kapacitetet komunale të jenë sa më të mobilizuara gjatë muajve të verës.

Duke qenë se një barrë e madhe e angazhimit bie tradicionalisht mbi komunat, gjatë verës kam vërejtur tek udhëheqjet komunale një gatishmëri për t'u përgatitur sa më herët dhe sa më mirë, për këtë periudhë.

Si rezultat i këtyre takimeve, dje së bashku me kryetarët e komunave gjatë takimit të Asociacionit të komunave të Kosovës, kemi nënshkruar edhe një memorandum bashkëpunimi, i cili përmban pika të ndryshme, duke u nisur nga shtimi apo riaranzhimi i kapaciteteve njerëzore, kjo gjithmonë edhe në vartësi të komunave; rregullimi i orareve të punës, gjithashtu në vartësi të specifikave të komunave; puna dhe shtimi i punës me intensitet më të lartë; e deri tek përpjekjet për të koordinuar Ministria jonë, së bashku me komunat aktivitetet e ndryshme kulturore, argëtuese, sportive, që do të bëhen gjatë muajve të verës.

Në funksion të kësaj, ne jemi duke përgatitur tash bashkë edhe me komunat një broshurë të gjitha aktiviteteve kulturore, argëtuese, sportive, që do t'u shpërndahet bashkatdhetarëve në pikat kufitare, që ata ta dinë se çfarë ndodhë në Kosovë gjatë muajve të verës.

Gjithashtu, së bashku me komunat, por edhe me ministrinë tjera jemi duke përgatitur një informator të shkurtër, që t'ua dorëzojmë që në pikat kufitare, por edhe në komuna për të ditur, se ku dhe çka mund në cilat institucione ata duhet t'i kryejnë shërbimet e tyre, të cilat ndonjëherë edhe nuk dinë dhe mbesin të humbur, duke shkuar nga institucioni në institucion.

Dua gjithashtu t'ju informoj se nga fillimi i muajit qershor ne do t'i shtojmë aktivitetet në procesin e regjistrimit të diasporës. Me këtë rast, ju ftoj, deputetë të nderuar, të angazhoheni aty ku mundeni me sensibilizimin e bashkatdhetarëve tanë për rëndësinë e këtij procesi. Zyrtarë për regjistrim të bashkatdhetarëve do të ketë që nga pikat kufitare e deri në komuna e sheshe të qyteteve, të cilët përpos që do të punojnë në procesin e regjistrimit të diasporës, do të jenë në shërbim të bashkatdhetarëve për informata të ndryshme, përfshirë këtu atë që thash, një kalendar të aktiviteteve, që do të shpërndajmë gjatë muajve të verës, si dhe materiale informuese, lidhur me procedurat për nxjerrjen e dokumenteve personale dhe mundësitë e ndryshme për investime në komuna. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ke pyetje shtesë, zonja Izmaku?

XHEVAHIRE IZMAKU: Kryesues, faleminderit për mundësinë! Nuk kam pyetje shtesë, vetëm desha ta përgëzoj, ta falënderoj për këtë përkushtim dhe pres që t'i mbani kryetarët e komunave në kontakt, gjatë kësaj periudhe. Faleminderit për përgjigjen!

KRYESUESI: Pika e tretë e rendit të ditës është:

3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme

Pra, kjo është shteruar, i dini rregullat. Ata që s'marrin përgjigje botohen në faqen zyrtare elektronike brenda 24 orëve, neni 45, paragrafi 11 i Rregullores së Kuvendit.

Pyes nëse keni vërejtje në procesverbal? Regjia, bini ziles që të kemi kuorum për votim.

(Ndërprerje e incizimit)

Atëherë, po e lëmë votimin kur të krijohet kuorumi.

Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

Para kësaj, urdhëro zonja Kadaç-Bujupi!

DONIKA KADAÇ-BUJUPI: Për rend dite e pata. Faleminderit!

Sipas Rregullores së Kuvendit, kërkesa e grupeve parlamentare e Lëvizjes “Vetëvendosje”, Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe Nismës, për të ftuar në interpelancë kryeministrin e Qeverisë së Kosovës zotin Isa Mustafa e dorëzuar më datën 7.5.2015, është dashur që të jetë sot

pikë e rendit të ditës, sipas Rregullores së Kuvendit dhe, edhe pse kryeministri në fjalë iku nga seanca dhe nuk është i gatshëm që të ballafaqohet me kërkesat e deputetëve, për të qenë në interpelancë për çështjen në fjalë.

Më lejoni të them, që një kryeministër i cili e mori besimin e qytetarëve duke folur më së shumti gjatë fushatës zgjedhore dhe në programin e tij për sundimin e ligjit dhe i cili pikërisht refuzon që të jetë në interpelancë kur thirret për të diskutuar për gjendjen e drejtësisë në vend, flet se ai, përveçse i ka mashtruar votuesit e vet, ka mashtruar edhe qytetarët e Republikës së Kosovës, po ashtu flet se kryeministri nuk ka as guxim, as vullnet politik dhe as energji, që të përballlet me nevojat e Kosovës.

Kjo është krejt e papranueshme. Përveçse nuk po përgjigjet në pyetjet parlamentare, nuk po vjen në interpelancë dhe nuk po jep llogari para Kuvendit dhe para deputetëve.

Prandaj, dëshiroj që të veprohet nga ana e Kuvendit, në mënyrë që Qeveria të respektojë Kushtetutën, të respektojë përgjegjësitë e kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ushtrimin e kompetencave kushtetuese, lidhur me nenin 94, paragrafi 1 dhe pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Deri më tani, ai po i shkel këto nene dhe në vazhdimësi po ikë nga përgjegjësia dhe llogaridhënia në raport me Kuvendin dhe deputetët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Po, po i kisha lutur deputetët, se u bë kuorumi, thash ta votojmë atë. Zoti Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Meqenëse edhe ligjërisht edhe i plotëson kushtet të futet si pikë e rendit të ditës, normalisht s'kemi asgjë kundër që edhe të futet si pikë e rendit të ditës interpelanca, por paragjykimi se kryeministri s'është këtu e po ikë, e s'vjen... Nuk e dini ju, zonja Kadaj-Bujupi, nëse futet në rend dite kjo pikë e që mund të futet, se a vjen a s'vjen kryeministri.

Ju shfrytëzoheni të drejtën e juaj, por mos bëni propagandë edhe ti tash po mashtron. Nëse futet në rend dite, jam shumë i vetëdijsëm çfarë po them, kryeministri është i përgjegjshëm edhe vjen. Po, të futet në rend dite, në qoftë se i plotëson kushtet. Edhe unë po them, se i plotëson ligjërisht ose proceduralisht kushtet, pastaj bisedojmë për këtë punë.

Prandaj, mos e shfrytëzo çdoherë momentin veç për të atakuar, pa asnjë argument të vetmin. Nëse futet në rend dite, jemi këtu, e bisedojmë, e çfarë thoni ju në interpelancë e çfarë kërkon, është çështje tjetër, është çështje juaja dhe vendos pastaj Kuvendi. Kaq, zoti kryesues!

KRYESUESI: Faleminderit! E ka fjalën Donika Kadaj-Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, zoti kryesues!

Sa për sqarim, dje deri në orën 16:00, kryeministri ka pasur obligim që të njoftojë zyrtarisht Kuvendin dhe, interpelanca të futet si pikë e rendit të ditës, bazuar në përgjegjësitë kushtetuese që i ka Qeveria në raport me Kuvendin. Kjo nuk ka ndodhur.

Dhe, kjo çfarë thash unë nuk është paragjykim. Kryeministri nuk qenka këtu, po besoj se po të ishte këtu ne do ta shihnim, do të ishte transparent, do të dukej, ndërkohë që, dje deri në orën 16:00 është e paraparë që ai të njoftojë Kuvendin, që sot do t'i përgjigjet kërkesës së deputetëve për interpelancë.

Këtë nuk e ka bërë dhe po e them me përgjegjësi të plotë, ju mund ta verifikoni.

KRYESUESI: Zoti Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Po, kjo është vazhdim i asaj që e thashë, nga zonja Kadaj-Bujupi. A s'është përgjigjur, ajo është çështje që ka vendosur kryeministri dhe ju e dini fare mirë, që nëse nuk përgjigjet, plotësohen kushtet që të futet në rend dite. Dhe, kryeministri as nuk dëshiron, as nuk mund ta pengojë futjen në rend dite.

Prandaj, ua lëmë procedurave, nëse futet në rend dite, ju sigurisht, gjegjësisht ne, sigurisht do ta shohim dhe do të vijë kryeministri. Ai nuk e ka për obligim të të tregojë ty, se a vjen a s'vjen. Jo, s'e ka. Ty, bash ty s'ka obligim hiç. Të futet në rend dite dhe vjen kryeministri. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Meqenëse, ka kuorum a e miratojmë procesverbalin e seancës së kaluar? Nëse ka dikush vërejtje? Nuk ka. Janë 65 deputetë në sallë, konstatoj se Kuvendi e miratoi procesverbalin e seancës të mbajtur më 6, 7, 8 dhe 14 maj 2015.

Sa i përket kësaj çështjes së ngritur, ne e kemi të obliguar, që në qoftë se s'ka kërkesë shtesë dhe s'miratohet ndonjë kërkesë shtesë nga ana e kryeministrit, që sot si pikë të fundit të rendit të ditës, sipas Rregullores së Kuvendit, të fundit ta rendisim pikën e kërkuar, që është - Interpelancë e kryeministrit të Kosovës Isa Mustafa, për ushtrimin e kompetencave kushtetuese lidhur me nenin 94, paragrafi 1 pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Pra, unë besoj që edhe administrata do të komunikojë me kryeministrin, ose ata që janë të ngarkuar dhe ne kemi obligim, s'mund t'i ikim kësaj, është obligim me Rregulloren e Kuvendit.

Atëherë, vazhdojmë!

Pra, pika e tetë e rendit të ditës për sot është: Interpelanca me kryeministrin. Procedoje sipas Rregullores.

Pika e katërt e rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat personale

Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim në parim.

Ftoj ministrin e Financave, zotin Hoti, që para deputetëve ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin. Zoti Hoti, e keni fjalën.

ABDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

Projektligji për të ardhurat personale është pjesë e ligjeve të pakos fiskale. Ky ligj derivon nga programi qeverisës 2015-2018, të cilin e kemi diskutuar në Kuvendin e Kosovës.

Unë dëshiroj të falënderoj Komisionin, që në afat shumë të shpejtë e ka shqyrtuar dhe ka proceduar këtë ligj në seancë të Kuvendit.

Projektligji ka freskuar definicionet ekzistuese duke eliminuar dykuptimësitë dhe paqartësitë. Me këtë projektligj të ardhurat e stafit vendor të angazhuar në misione të huaja nuk përfshihen në kategorinë e të ardhurave të lira.

Ndërkaq, në të ardhurat e përjashtuara nga tatimi janë përfshirë:

- Të ardhurat e personave me aftësi të kufizuara;
- Të ardhurat nga shpronësimi për interes publik;
- Kontributet e paguara nga punëdhënësi për sigurim shëndetësor dhe pensional;
- Përfitimet për dëmshpërblimet e marra përmes vendimeve të formës së prerë të gjykatave; si dhe kompensimet e caktuara për kostot gjyqësore;
- Të ardhurat nga shpërblimi nga institucione shtetërore për arritjet shkencore në sport dhe në kulturë;
- Të ardhurat e përfituara si rezultat i kompensimit financiar për ish të dënuarit politikë dhe për kategoritë e ngjashme; dhe
- Të ardhurat nga grantet, subvencionet dhe donacionet për tatimpaguesit, që nuk janë objekt i tatimit në të ardhurat reale, në harmoni me rregullat dhe kushtet e përfitimit.

Në anën tjetër, projektligji ka paraparë që shpenzimet e reprezentacionit të kompanive të jenë të kufizuara në 1% të të ardhurave bruto vjetore, ndërkaq shpenzimet e reklamës dhe të promocionit të jenë tërësisht të zbritshme.

Një ndryshim tjetër i rëndësishëm është edhe zbritja e lejuar për qëllime bamirësie në vlerën maksimale prej 10% të të ardhurave të tatueshme e kjo shumë mund të rritet edhe 10%, nëse është e paraparë me ndonjë ligj tjetër në fuqi.

Ky projektligj gjithashtu ka zgjeruar kategoritë e shpenzimeve të palejueshme, është freskuar dhe zgjeruar lista e kategorive të personave fizikë, që janë të obliguar të mbajnë tatimin në burim.

Në bazë të vlerësimeve që kemi bërë në Ministrinë e Financave implementimi i këtij ligji nuk paraqet kosto shtesë për institucionin që do ta implementojë, prandaj unë ju ftoj që ta votoni në parim. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Fjala është edhe e kryetarit të Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, zotit Osmani.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më 13.5.2015 ka shqyrtuar Projektligjin për tatimin në të ardhura personale dhe ka vlerësuar, se projektligji përmbush kushtet e domosdoshme formale-juridike të parapara me Rregulloren e Kuvendit, që do të thotë se projektligji si i tillë përmban memorandumin shpjegues për objektivat që synon t'i realizojë ligji. Po ashtu, projektligji përmban edhe opinionin për ndikimet buxhetore, që vlerësohet se Projektligji për tatimin e të ardhurave personale nuk do të ketë kosto buxhetore shtesë për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Projektligji përmban edhe opinionin ligjor të përputhshmërisë me legjislaturën e BE-së, që vlerësohet se çështjet e rregulluar dhe të adresuara me Projektligjin për tatimin në të ardhurat personale në mënyrë të konsiderueshme inkorporohet në dispozitat tatimore të aquit-së së BE-së.

Çështja kryesore e trajtuar në këtë projektligj janë vendosja e sistemit në të ardhurat personale në Republikën e Kosovës, aplikimi i politikës tatimore më të thjeshtë me procedura të thjeshta të deklarimit të tatimit nëpërmjet avancimit të sistemit elektronik të raportimit dhe kontrollit.

Prandaj, projektligji si i tillë përmbush kushtet për miratim në leximin e parë dhe Komisioni ka rekomanduar Kuvendit që të miratojë atë në parim dhe, të gjitha vërejtjet dhe rekomandimet që do të dalin të adresuara lidhur me projektligjin do të shqyrtohen me kujdes nga ana e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Aida Dërguti.)

KRYESUESJA: Vazhdojmë me shefat e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Labinotë Demi-Murtezi.

LABINOTË DEMI-MURTEZI: Faleminderit, kryesuese!

Grupi ynë parlamentar fton të gjithë deputetët e Grupit dhe deputetët tjerë edhe të partive tjera politike, që të votojmë projektligjin e parë për tatimin në të ardhurat personale.

Është një projektligj, që i paraprinë një ligji me rëndësi të veçantë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Nuk do të jap më shumë detaje, pas elaborimit që bëri ministri i Financave zoti Hoti dhe kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa. Edhe si anëtarë të komisionit të grupit tonë e kemi shqyrtuar edhe si deputetë të Grupit Parlamentar, andaj ju ftojmë që në parim ta votoni e të kalojë deri në leximin e dytë dhe të jepni kontributin me amendamente. Faleminderit!

KRYESUESJA: Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, kush do ta marrë fjalën? Në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje”? Në emër të LDK-së, fjalën e ka Naser Osmani.

NASER OSMANI: Sa për t'u deklaruar, zonja kryesuese, në atë që thashë edhe në emër të Komisionit për Buxhet e Financa që Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështet rekomandimin e Komisionit dhe iniciativën e Qeverisë, respektivisht të Ministrit të Financave për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit në fjalë dhe ne do ta votojmë në tërësi. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar Lëvizja “Vetëvendosje”, Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesuese!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Dy ligje që i kemi sot në rend dite, pra edhe Ligji për tatimin e të ardhurave personale e po ashtu ai për tatimin e korporatave, si pjesë e pakos fiskale që i ka sjell Qeveria në Kuvendin e Republikës së Kosovës, janë disa prej ligjeve dhe do të kisha thënë ligjet më të rëndësishme për sa i përket ekonomisë dhe gjendjes ekonomike dhe zhvillimeve ekonomike në vend, por edhe atyre sociale, kur kihet parasysh se politika fiskale si pjesë e politikave qeveritare, bashkë me politikat monetare janë dy mekanizma jashtëzakonisht të rëndësishëm që institucionet publike i kanë në dorë dhe përmes të cilave këto të fundit mund të ndikojnë kahen e zhvillimit ekonomik, por edhe zhvillimit në përgjithësi brenda një shoqërie.

Dhe, këto ligje që po i diskutojmë sot është vështirë të kuptohet se çka në të vërtetë po diskutojmë. Domethënë, edhe në paraqitjen e ministrit, por edhe me paraqitjen e kryetarit të Komisionit dhe të tjerëve u pa që përkundër disa ndryshimeve që janë bërë në këto ligje, të cilat janë sjell tash si ligje tjera nga Qeveria e Republikës së Kosovës, përgjithësisht ndryshimet janë ose teknike, por deri në një masë edhe kozmetike. Pra, nuk po them se janë ligjet tërësisht të njëjta, ka disa ndryshime në to, krahasuar me ligjet që janë në fuqi, mirëpo ato ndryshime nuk prekin aspak gjendjen aktuale që e kemi për sa i përket politikave fiskale në vend.

Dhe, këto ndryshime nuk kanë të bëjnë fare me sasinë. Pra, nëse i krahasojmë tekstet e dy ligjeve, mund të shohim se në tekstin aktual ose në ligjin aktual që është sjell në Kuvend, ka ndryshime ose ka riformulime të shumta të neneve të caktuara, ka disa ndryshime teknike të procedurave, të mënyrës si mbledhen tatimet, kujt i atribuohen tatimet, ka disa lirime në tatime për aktivitete të caktuara, mirëpo ndryshim domethënës të normave tatimore e as të procedurave në përgjithësi nuk ka. Pra, kjo i bie që me këtë pako fiskale që e ka sjell Qeveria e Republikës së Kosovës, me përjashtim me Ligjin për tatimin në vlerë të shtuar, Qeveria po na thotë se do të vazhdojë pak a shumë me mënyrën e njëjtë për sa i përket politikave fiskale në vend.

Dhe, tash, me një premtim tjetër, që kjo mënyrë e njëjtë do të na sjell rezultate tjera. Pra, është naivitet mendoj unë të mendosh se metodat e njëjta do të sjellin rezultate rrënjësisht të ndryshme e pikërisht këto janë të rëndësishme për Kosovën në gjendjen ekonomike dhe sociale në të cilën është ajo.

Tatimi për të ardhurat personale është një prej tatimeve më të rëndësishme, sepse e prek secilin qytetar të punësuar. Pra, secili qytetar që realizon të ardhura brenda një shoqërie ose brenda një shteti, ai preket nga tatimi në të ardhurat personale dhe si i tillë ky tatim bëhet jashtëzakonisht i rëndësishëm për shumë aspekte, por veçanërisht për aspektin ekonomik dhe atë fiskal. Tatimi për të ardhurat personale është një prej mekanizmave se si një Qeveri e caktuar e bën rishpërndarjen e pasurisë ose i krijon kushtet përbrenda vendit në të cilën pasuria e krijuar brenda një vendi dhe brenda një kohe të caktuar rishpërndahet te qytetarët e vet.

Kosova i ka bërë ndryshimet rrënjësore tatimore në vitin 2009. Pra prej 1 janarit të vitit 2009 Kosova ka një skemë të re tatimore. Deri në vitin 2009 tatimi edhe në korporata po edhe pragu i

lartë i tatimit në të ardhura personale kanë qenë 20% dhe prej vitit 2009 kjo është reduktuar në 10%. Pra, ky ka qenë dallimi thelbësor. Dhe edhe sot e kësaj dite e kemi të njëjtën normë tatimore, edhe në të ardhurat personale edhe në tatimin e korporatave.

Një dallim te të ardhurat personale është që këtu e kemi tatimin e përshkallëzuar, pra e kemi një lloj përshkallëzimi edhe të tatimit edhe të ardhurave personale. Po ky përshkallëzim është dëshmuar se nuk i ka kontribuar fare personave që marrin paga në Kosovë e që janë më të ulëta ose afër mesatares, mirëpo më së shumti u ka kontribuar atyre që pagat i kanë më të larta.

Pra ndryshimi që është bërë në vitin 2009 u është reduktuar rrënjësisht tatimi në paga, ta zëmë prej 1 mijë euro e tutje ose 700 euro e përmbi, por nuk është se ka pasur ndonjë ndikim kushedi sa pozitiv te pagat në nivelin e 500 euro, 450 euro, apo 300 euro, ndërkohë që te pagat më të ulëta, në fakt, ka pasur rëndim të tatimit.

Lëvizja “Vetëvendosje” rolin e politikave fiskale e sheh jo vetëm në gjenerimin e të hyrave të mjaftueshme buxhetore, por edhe në alokimin e resurseve buxhetore drejt ofrimit të shërbimeve publike, si dhe në këtë i shohin tri funksione tjera: mbështetjen e rritjes ekonomike, stabilizimin ekonomik dhe uljen e pabarazisë sociale. Pra, këtu do të ishin efektet dhe përqendrimet e politikave fiskale të një vendi e veçanërisht të një vendi që e ka ekonominë në gjendje të cilën e ka Kosova sot.

Tatimet fiskale ne i bazojmë në parimet e drejtësisë dhe barazisë në tatime e në shpërndarje, si dhe politikat fiskale duhet të punojnë drejt arritjes së stimulimit të prodhimit, investimit dhe krijimit të vendeve të reja të punës. Gjithashtu politikat fiskale duhet të bëjnë edhe balancimin e barrës së financimit të buxhetit në bazë të të mirave që qytetarët përfitojnë nga paratë publike.

Sot e kemi një situatë krejt tjetër në Kosovë. Sot, klasa më e varfër dhe klasat e mesme financojnë pjesën më të madhe të buxhetit të Kosovës edhe përmes tatimeve në të ardhura personale, po veçanërisht nëpërmjet tatimit në vlerë të shtuar i cili prej të gjitha tatimeve që mbledhen në Kosovë e përbën pjesën më të madhe, të them ashtu, të hyrave buxhetore, sepse është drejtpërsëdrejti i lidhur me konsumin nga i cili nuk përjashtohet askush.

Te tatimet në të ardhura personale duhet të kemi parasysh edhe një gjë që nuk po e bën Qeveria, pra përmes këtij përshkallëzimi të ulët që e mban Qeveria e i cili pak a shumë është i përafërt për një tatim të sheshtë do të kisha thënë, sepse janë katër norma tatimore 04%, 8% dhe 10%, pra që janë shumë të përafërta në përqindje, nuk arrihet asnjëri prej këtyre funksioneve për të cilat do të duhej t'i kryente tatimi në të ardhura personale.

Pra, as nuk arrihet e as nuk sigurohet një shpërndarje më e barabartë e pasurisë në mes të qytetarëve, sepse siç e përmenda, këto norma tatimore shumë më shumë i konvenojnë pagave më të larta. Pra, nuk janë të dizajnuara sipas parimit që kush fiton më shumë të paguajë më shumë për të mirën e përgjithshme, por në anën tjetër nuk krijon as kushte të volitshme ekonomike për sa i përket rritjes së konsumit masiv ose konsumit agregat të një shoqërie në mënyrë që kjo të jetë bazë e rritjes ekonomike brenda një shoqërie.

Pra, kjo pabarazi që krijohet edhe përmes tatimeve e që po ndodh edhe në Kosovë, por kjo rritje e hendekut në mes të varfërve dhe të pasurve në Kosovë e ka dimensionin e vet jo vetëm të padrejtësisë sociale, por në anën tjetër edhe të dëmit ekonomik, sepse merr më shumë para në ato shtresa të shoqërisë të cilat kanë nevojë më shumë për konsum, ndërkohë që jep më shumë para në ato shtresa të shoqërisë të cilat e orientojnë konsumin jo kah prodhimet vendore, por kah prodhimet luksoze që vijnë nga jashtë ose importohen nga jashtë, gjë që nuk i kontribuon fare ekonomisë së vendit, në këtë rast ekonomisë së Republikës së Kosovës.

Për ta balancuar barrën buxhetore në mes të klasave më të varfra dhe atyre që kanë më shumë mundësi, Lëvizja “Vetëvendosje” angazhohet që t’i rrisë shkallët tatimore dhe që të shtojë përshkallëzimin, pra numrin e niveleve tatimore të cilat aplikohen përbrenda një vendi.

Në alternativën qeverisëse të Lëvizjes “Vetëvendosje” ne e kemi përcaktuar që paga minimale, e cila përcaktohet me dekret të Qeverisë ose me dekret të kryeministrit sipas konsultimeve ose pas konsultimeve me Këshillin Ekonomik Social që të jetë zero, pra e liruar nga tatimi.

Aktualisht e kemi një pagë, ose 80 euro të cilat janë të liruara nga tatimi në të ardhura personale, që është jashtëzakonisht e ulët si e ardhur, ta zëmë, në mënyrë që të ketë kushedi çfarë ndikimi në të ardhura të përgjithshme të qytetarëve të Kosovës.

Me Lëvizjen “Vetëvendosje” paga e cila do të jetë e liruar nga tatimi, do të jetë 170 euro, sikur që është aktualisht paga minimale në Kosovë.

Pastaj përshkallëzimi tjetër prej 5% do t’u aplikohet pagave prej 170 deri në 500 euro.

Përshkallëzimi i tretë, prej 10% pra do t’i aplikohet pagave prej 500 deri në 850 euro.

Përshkallëzimi i katërt i pagave prej 850 deri 1 700 euro, i cili do të jetë në nivelin 20% dhe

Përshkallëzimi i pestë i pagave mbi 1 700 euro, i cili do të jetë 30%.

Pra, nga ky lloj përshkallëzimi ne sigurojmë që drejtësia dhe barazia sociale aplikohet në vend, ndërkohë që sigurojmë po ashtu që ata që paguhen më shumë dhe ata që arrijnë të fitojnë më shumë përbrenda një ekonomie të një vendi, ata bartin pjesën më të madhe të përgjegjësisë karshi të mirave publike dhe karshi buxhetit të vendit. Pra, do ta zhvendosim barrën nga klasë të mesme dhe të varfra në ata persona ose në atë grup personash, shtresa të shoqërisë të cilët fitojnë më shumë dhe të cilët dorën në zemër i kanë mundësitë.

Pra, në këtë mënyrë ne do t’u japim mundësi më shumë atyre që kanë nevojë që të konsumojnë ushqim, veshmbathje dhe përgjithësisht kushte më të mira në familje, në ndërkohë që do t’ua reduktojmë pak, jo krejt por pak, luksin atyre të cilët e kanë atë të tepruar, siç ndodhë sot në shoqërinë e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESJA: Në emër të Grupit Parlamentar Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, fjalën e ka Bali Muharremaj.

BALI MUHARREMAJ: Faleminderit, kryesuese!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë të Parlamentit të Kosovës,

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, e ka shqyrtuar Projektligjin për tatimin në të ardhurat personale.

Norma ekzistuese e tatimit në të ardhura personale është përshkallëzuar apo ... Norma e tatimit në korporatë dhe në TVSH janë të sheshta.

Në projektligjin e propozuar norma e tatimit në të ardhurat personale nuk ndryshon. I vetmi ndryshim material është se në obligim tatimor është përfshirë tatimi dividend për personat rezidentë dhe jorezidentë.

Po ashtu ndryshimi paraqet dispozitat në të cilat bëjnë përjashtime nga obligimet, për punësimet, kontributet për shërbimet shëndetësore, dëmshpërblimet, për vendimet gjyqësore, për shpërblimet, për rritje, kompensimet për ish të burgosurit politikë e tjera.

Ndryshime tjera esenciale në këtë ligj nuk ka. Për ne është e diskutueshme vënia e tatimit në dividendë. Një alternativë do të mund të ishte që dividenda e destinuar për riinvestim të lirohet nga obligimi, ndërsa pjesa ose kur dividenda tërhiqet, si të ardhura personale të tatimoret.

Për Grupin Parlamentar të Aleancës, ligji i ri nuk paraqet ndonjë ndryshim esencial që nënkupton reformë përmes ndryshimeve sipërfaqësore.

Grupi Parlamentar i Aleancës, në parim e përkrah këtë projektligj dhe do të jap kontributin në leximin e dytë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Si duket në emër të Listës serbe askush nuk e ka kërkuar fjalën dhe nuk janë prezent në sallë. Atëherë, në emër të Nismës, fjalën e ka Enver Hoti.

ENVER HOTI: Faleminderit e nderuar kryesuese!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar Nisma e ka trajtuar Projektligjin për tatimin e të ardhurave personale dhe parimisht e mbështesim dhe gjatë leximit të dytë ne do t'i paraqesim me shkrim propozimet tona. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, fjalën e ka Mufera Shiniq.

MYFERA SHINIK: Teşekkür ederim!

Kişisel Gelir Vergisi Yasa Tasarısını 6+” Parlamenter Grubu olarak birinci okunuşunu kabul ediyoruz, ikinci okunuşuna kadar gerekli komisyonlara katkımızı sunarak amandmanlarla bunu desteklemeye çalışacağız. Teşekkür ederim!

KRYESUESJA: Fjalën e ka kërkuar deputeti Faton Topalli.

FATON TOPALLI: Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Nuk ka dyshim që Kosova ka nevojë për një ligj i cili e rregullon çështjen e tatimit në të ardhura personale. Tashmë janë bërë shumë përpjekje për ndryshime në këtë drejtim, megjithatë duket se janë të pamjaftueshme, duke pasur parasysh edhe Projektligjin që e kemi para nesh.

Të ardhurat e krijuara të cilat duhet të taten, hyjnë zakonisht në familje, madje në shumicën e rasteve edhe kur personi i punësuar nuk ka familje që buron prej tij.

Duke pasur parasysh se shuma e mjeteve që hyn në familje është një prej faktorëve përcaktues për mirëqenien e saj, unë e kam shikuar ligjin pikërisht nga ky aspekt dhe atë kryesisht nga pikëpamja nëse ligji, për të cilin Kuvendi do të votojë në parim sot, i sjell lehtësime familjes apo nuk i sjell, e trajton familjen në mënyrë të barabartë apo të pa barabartë.

Në shikim të parë, sipas mendimit tim, ligji duket sikur i trajton të gjithë tatimpaguesit njësoj. Neni 6 pika 1, përcakton shkallën e tatimit.

Nga aspekti i numrave duket që gjithçka është në rregull, duket sikur tatimpaguesit trajtohen njësoj. Pikërisht, ndoshta mungesa e diferencimit e bën këtë ligj të dëmshëm dhe diskriminues për shumë familje duke krijuar dallime të mëdha në mes tyre.

Sa për ilustrim dua të marr një shembull. Ta zëmë që kemi një familje tre anëtarëshe, e cila përbëhet nga dy bashkëshortë dhe një fëmijë që shkon në shkollë. Të dy bashkëshortët janë të punësuar. Nëse secili prej tyre, në rastin ideal merr nga 350 euro, të ardhurat e tatueshme janë 700 euro.

Karshi kësaj familje do të vendosim një familje tjetër, pra me dy bashkëshortë të punësuar, me të hyra të përbashkëta prej 700 eurosh, por me tre fëmijë. Pra, kemi një familje treanëtarëshe dhe një familje pesëanëtarëshe, të cilat paguajnë njësoj tatim, por që kanë ngarkesa shumë të ndryshme ekonomike.

Familja e parë, e cila është treanëtarëshe është në favor me familjen e dytë pesëanëtarëshe. Sikur ligji të kishte parasysh barazinë, trajtimin e njëjtë dhe pagesën e tatimit sipas një çelësi të caktuar, atëherë familja e cila ka ngarkesa më të mëdha ekonomike do të duhej të paguante më pak tatim se sa familja që ka ngarkesa më të vogla ekonomike.

Këtë çështje ligji mjerisht nuk e rregullon. Në disa vende perëndimore, duke dashur të mbrohet familja, do të trajtohet drejt dhe në mënyrë të barabartë, madje edhe në raport me ndërmarrjet ekonomike ajo trajtohet si bashkësi, pra edhe si bashkësi ekonomike e cila ka të hyra, ka të dala, ka pasuri, ka anëtarë të caktuar, ka fitim por ka edhe humbje.

Ndoshta do të ishte një model perëndimor i cili do të duhej të shikohej që familja të trajtohej në atë mënyrë që ajo të mos diskriminohet, siç diskriminohet tani me këtë ligj. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Meqë nuk ka deputetë tjerë të lajmëruar për diskutim, atëherë fjalën ia kalojmë përfaqësuesit të Qeverisë.

ABDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesuese e Kuvendit,

Unë falënderoj grupet parlamentare që në parim e përkrahin këtë projektligj. Më lejoni t'ju informoj që ky projektligj bashkë me tjetrin që është në pikën tjetër të rendit të ditës, e komplementojnë ligjin e TVSH-së, i cili shumë shpejt do vijë në Kuvendin e Kosovës.

Unë e përçolla me shumë interes edhe fjalimin e shefit të Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes” për këto norma tatimore, po mendoj që, nëse i shihini pak më në detale, unë po ju tregoj se punojnë kundër logjikës të cilën jeni duke e thënë sepse duke i ndryshuar normat 0,4, 8 dhe 10 në 0.4, 10 dhe 20, praktikisht ju jeni duke e ngarkuar më shumë punëtorin mesatar në Kosovë, sepse nëse e shihni shpërndarjen e pagave në Kosovë nuk kemi në Kosovë nuk ke në Kosovë mbi 20, 30% të njerëzve që marrin paga shumë të larta dhe tash ti po e zhvendos ngarkesën prej këtyre me paga të ulëta kah ata me paga të larta.

Ne i kemi analizuar dhe mendojmë se mbajtja e normave ekzistuese dhe harmonizimi i këtij ligji me Ligjin për të ardhurat e korporatave dhe me Ligjin e TVSH-së e prek edhe anën sociale edhe krijon potenciale zhvillimore. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Visar Ymeri, për replikë!

VISAR YMERY: Në fakt, ministri tha që më ka dëgjuar me vëmendje, por në fund doli se s'më kishte pas dëgjuar bash me vëmendje, ose s'i ka marrë shënimet qysh duhet, sepse e kritikoi një diçka që s'e kam thënë unë, tha ky e ka thënë, e pastaj e kritikoi veten në fakt, ose keqkuptimin që e ka bërë ai.

Zoti ministër, edhe një herë po ta përsëris, dhe po e lexoj tash me vëmendje. Është 170 euro, në vend të 80, siç e keni ju sot, është i liruar nga tatimi. Pra, 0%. Prej 170 deri në 500 euro, kjo pjesa 170 deri në 500 euro i ka 5%, jo 4%, siç e thatë ju. Pastaj, prej 500 deri në 850 euro, pjesa pra prej 350 euro deri në 500 dallimi i ka 10%. Prej 850 deri në 1 700 euro i ka 20% dhe përmbi 1 700 euro i ka 30% tatim dhe kjo e liron nga barra. Nëse e bëni kalkulimin, pra krahasone, bëni një krahasim nëse doni në rrogën 500 euro ta zëmë bruto, në rrogën 300 euro bruto dhe në rrogën 1 000 bruto edhe e shihni se rroga 500 euro dhe rroga 300 euro, me sistemin tatimor të vetëvendosjes paguajnë më pak tatim, ndërkohë që rroga 1 000 euro paguan më shumë tatim se sa që paguan sot, që i bie se me sistemin aktual që e kemi dhe që po e mbron edhe ju, rroga prej 500 euro paguan më shumë tatim sot, ndërkohë që rroga prej 1 000 euro paguan më pak tatim.

Këtë po e them, pra ata që fitojnë më shumë sot paguajnë më pak tatim, jo në shumë absolute, por relative se sa ata që fitojnë më pak dhe barra i bie atyre që fitojnë më pak dhe barra i bie atyre që fitojnë më pak, që i kanë përgjithësisht kushtet më të vështira të jetës ta mbajnë barrën tatimore ndërkohë që ata që i kanë punët shumë mirë, pra kushtet shumë më të mira të jetës, nuk e mbajnë këtë barrë tatimore.

Dhe, ky është dallimi në mes asaj çka po propozon Lëvizja “Vetëvendosje” dhe çka keni sjell ju në Kuvendin e Republikës së Kosovës, si propozim në formë të ligjit dhe Lëvizja Vetëvendosje nuk mund ta pranojë këtë ligj në këto përshkallëzime sepse ky është i padrejtë për qytetarët e Kosovës, për popullin e Kosovës për shkak se e etablon ose e mirëmban këtë pabarazi në tatime, të cilës...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Ministri e ka fjalën.

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Tani Visar mund t'i bëjmë ligjërata njëri -tjetrit sa të domi, por shihni shpërndarjen e pagave në Kosovë, numri i atyre që përfitojnë nga ulja, ta zëmë, deri në 170, prej numrit të atyre që ngarkohen praktikisht dhe zhvendosja e barrës nuk të jep asnjë efekt sepse shumica e njerëzve në Kosovë marrin paga rreth pagës mesatare plus-minus 5% - 10% dhe zhvendosja e barrës në njërin anë, në efekt nuk të jep asnjë rezultat.

Unë e di që ne kemi dallime konceptuale. Ne nuk jemi për ngritjen e normave tatimore, sepse aspektet sociale nuk rregullohen përmes kësaj. Ne po mundohemi të krijojmë potenciale zhvillimore, me ato edhe dy ligje tjera që thashë, njërin do ta diskutojmë sot dhe tjetrin besoj javën tjetër ose mbas dy jave, sa më shpejt që komisioni e sjell në Kuvend. Faleminderit!

KRYESUESJA: Meqë nuk kemi kuorum, atëherë vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave

Komisioni funksional për Buxhet dhe Financa, në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim në parim.

E ftoj ministrin e Financave, zotin Abdullah Hoti, që para deputetëve të Kuvendit të prezantojë dhe arsyetojë Projektligjin.

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesuese e seancës!

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

Edhe ky ligj është pjesë e pakos fiskale, bashkë me ligjin që sapo e diskutuam dhe është pjesë e programit qeverisës 2015-2018, të cilin e kemi diskutuar gjithashtu në këtë Kuvend.

Elementet kryesore të parapara në këtë projektligj, krahasuar me legjislacionin aktual, janë si vijon:

1. Një pjesë e konsiderueshme e definicioneve janë përgjithësuar, janë eliminuar dykuptimësitë dhe janë harmonizuar me legjislacionin tjetër në fuqi.

Tatimi në të ardhura të korporatave është përcaktuar të jetë 10% e të ardhurave të tatueshme, përjashtimisht kompanitë e sigurimeve të licencuara nga Banka Qendrore për një kategori të sigurimeve, i nënshtrohen normës tatimore prej 5% të primeve bruto të grumbulluara gjatë periudhës tatimore.

Dhe, tani ne po diskutojmë me Sektorin e sigurimeve për të parë dhe për të rregulluar këtë çështje më mirë.

2. Përveç të ardhurave tjera të listuara në projektligj, që lirohen nga tatimi në të ardhura të korporatave, janë përfshirë edhe të ardhurat e përfituara nga grandet, subvencionet dhe donacionet në harmoni me rregullat dhe kushtet e përfitimit.

3. Nëpërmjet këtij projektligji është lënë mundësia që ministri i Financave, në përputhje me praktikat ndërkombëtare dhe në linjë me programin qeverisës, të ketë kompetencë për përcaktimin e pushimeve tatimore dhe lehtësirave të veçanta për bizneset e reja.

4. Me këtë projektligj është zgjeruar lista e shpenzimeve të palejueshme që merren në konsideratë gjatë përcaktimit të të ardhurave të tatueshme, ndërsa shpenzimet e trajnimit janë lejuar në limitet e përcaktuara në këtë projektligj.

5. Kontributet e dhëna për aktivitetet me interes publik, cilësohen si shpenzime të lejueshme deri në 10% të të ardhurave të tatueshme të llogaritura përpara se të jetë zbritur ky kontribut. Për më tepër, tatimpaguesit që kontribuojnë në fusha të caktuara që do të kenë një lirim shtesë edhe 10% nëse kjo parashihet me ligje tjera të veçanta në Kosovë.

6. Shpenzimet e përfaqësimit që do të jenë të kufizuara 1% të të ardhurave bruto vjetore, kurse shpenzimet e reklamës dhe promocionit janë shpenzime tërësisht të zbritshme për qëllime tatimore.

7. Projektligji mundëson zbritjen e posaçme për pasuritë e reja. Kështu për tatimpaguesit që blejnë linja prodhuese dhe inventar tjetër për qëllime të aktivitetit ekonomik u lejohej një zbritje e veçantë e pakufizuar kohore prej 10% të çmimit të përvetësimit të pasurisë në vitin, e cila pasuria është vënë për herë të parë në shërbim.

9. Projektligji përcakton tatim prej 10% të të ardhurave nga lojërat e fatit dhe 10% në dividendën e tërhequr nga kompania vetëm kur ajo tërhiqet.

10. Tatimi në qira prej 9% tash po kufizohet dhe do të ndalet në...

Njësoj sikur me ligjin paraparak ky ligj nuk paraqet kosto shtesë për institucione që do ta implementojnë. Prandaj, unë ju ftoj që ta aprovoni në parim. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Pas prezantimit të projektligjit hapi debatin për diskutim në parim. E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, Naser Osmani, që ta marrë fjalën.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryesuese!

Po ashtu edhe Ligji për tatimin në të ardhurat e korporatave, e kemi trajtuar të njëjtën ditë sikurse Ligjin për të ardhurat personale më 13 maj 2015 dhe kemi konsiderua që ligji në fjalë ka përmbush të gjitha kushtet formalo juridike që të procedohet më tutje në Kuvend pas që është në përputhje të plotë me standardet për hartimin e legjislacionit dhe është në harmoni me ‘acquis communautaire’ e Bashkimit Evropian.

Çështjet kryesore të trajtuara në këtë projektligj janë vendosja e sistemit të tatimit në të ardhurat e korporatave dhe niveleve të ulëta tatimore, kështu që kushte këto të cilat janë të domosdoshme për rritjen e biznesit dhe bërjen e biznesit në vend duke kontribuar në territorin e Republikës së Kosovës.

Prandaj, Komisioni në mënyrë unanime ka vendosur që këto t'i përkrahë në parim, t'i procedoj në Kuvend së bashku edhe me ligje të tjera të pakos fiskale që do të vije në mbledhjen e ardhshme Ligji për TVSH-në.

Prandaj, ne bëjmë thirrje në emër të Komisionit me qenë se është votuar me konsensus që edhe deputetët e parlamentit ta votojnë në tërësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Ftoj deputeten Labinotë Demi-Murtezi, që të deklarohej në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

LABINOTË DEMI-MURTEZI: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Edhe shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave, është e një rëndësie të veçantë. Si grup parlamentar do ta mbështesim dhe do ta votojmë dhe ftojmë gjithë kolegët deputetët që ta mbështesin dhe të kontribuojnë në amendamentim ndërmjet dy leximeve. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Në emër të LDK-së, kush dëshiron ta merr fjalën, Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zonja kryesuese!

Lidhja Demokratike e Kosovës ka shqyrtuar Projektligjin për tatimin në të ardhurat e korporatave dhe natyrisht duke pasur parasysh që ky ligj ish një ndër ligjet e pakos fiskale i cili do të jetë në dobi të korporatave që do të ndikoj drejtpërsëdrejti në zhvillimin e biznesit në Kosovë.

Lidhja Demokratike e Kosovës e përkrahë në parim dhe fton gjithë deputetët që ta votojnë. Paraprakisht edhe tash momentalisht e pamë ministrin që prezantoi ndryshimet konkrete në këtë ligj, prandaj ky ligj është i mirëseardhur. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje”, fjalën e ka Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesuese!

Pra, edhe me këtë ligj siç e thashë nëse e krahasojmë ta zëmë me Projektligjin për tatimin në të ardhurat personale, po prapë në skemën e gjithmbarshme tatimore nuk është se ka ndonjë ndryshim i cili do të sillte kushedi çfarë rezultate tjera në ekonominë e Kosovës.

Ndërkohë që, natyrisht në gjendjen të cilën është ekonomia e Kosovës sot ka shumë nevojë për rezultate të ndryshme prej atyre që i kemi parë deri më tash dhe Qeveria po duket se nuk është duke menduar kështu pra pa do që të vazhdojë të njëjtën me disa përmirësime. Pra, do të thoshim me disa mekanizma të cilët do të duken fillimisht se do ta kenë një ndikim në zhvillimin ekonomik në përgjithësi në vend, mirëpo pastaj pas 3-4 vjetëve do ta kuptojmë që në fakt nuk është se kemi bërë ndonjë gjë në këtë drejtim.

Në vitin 2009 dhe që prej vitit 2009 po përgjithësisht në diskursin publik për sa u përket politikave fiskale tatimore që prezantohen në Kosovë të cilat janë mbrojtur në Kosovë, vazhdimisht thuhet edhe nga zyrtarët aktual të Qeverisë, por edhe nga zyrtarët e kaluar të Qeverisë se ulja e normave tatimore ndikon drejtpërsëdrejti në rritjen e investimeve, kjo është një prej arsyetimeve kryesore që përdoret për një si të them kështu skemë ose normë tatimore në këtë rast të korporatave por në përgjithësi të ulët dhe kështu nëse i rrisin investimet natyrisht se do të rriteshin pastaj edhe vendet e punës, pra do të ulet papunësia dhe do të zhvillohej ekonomia në përgjithësi. Ky është si të them arsyetimi kështu kryesor bazë i normave tatimore të sheshta, të ulëta, të thjeshta që proklamohen përbrenda një modeli të caktuar të zhvillimit ekonomik

Dhe, ne e dimë të gjithë pra që tatimi në korporata në Kosovë është ulur nga 20 në 10% në vitin 2009, ka filluar së aplikuari prej 1 janari të vitit 2009 e tash jemi në muajin maj ose në fund të majit të vitit 2015. Ndërkohë që pikërisht gjatë kësaj periudhe prej vitit 2008, prej vitit 2009 e deri sot trendi i investimeve ka rënë. Nëse shikohen ta zëmë vetëm nëse e marrim si për bazë investimet e huaja direkte ato kanë trend të rënies dhe vazhdimisht kanë rënë përgjatë këtyre viteve si shumë e agregates, si investim agregat në ekonominë e Kosovës. Dhe, tash natyrisht promovuesit dhe përgjegjësit e fshehtësisë në tatime dhe tatimeve të ulëta na thonë që kjo rrënjë është ndikua nga faktorët tjerë, jo domosdoshmërisht nga tatimet apo ndryshimi i normave tatimore. E këta faktor të tjerë kryesisht janë të lidhur me krizën globale ekonomike financiare që ka ndikuar drejtpërsëdrejti edhe nivelin e investimeve në Kosovë, edhe pse dorën në zemër nëse shikohet kështu globalisht nuk është se trendi i investimeve ka shënuar ndonjë rrënjë shumë të madhe, por ka pasur .. nga vendi në vend gjatë këtyre viteve.

Pra, tash e gjashtë vjet, nëse i marrim për bazë deri në fillim të vitit 2015, buxheti i Kosovës vjel më pak tatim nga korporatat për shkak të uljes së normës. Ndërkohë që në të njëjtën kohë kemi më pak investime në ekonominë e Kosovës në përgjithësi.

Ndërkohë që vendet më të zhvilluara me norma më të larta të tatimit në të njëjtën periudhë kohore kanë tërhequr më shumë investime se sa që ka tërhequr në Kosovë.

Lartësia e tatimit pra duket se nuk është faktori kryesor që e ndikon këtë ose që i nxit investimet në përgjithësi. Nuk po them që nuk është faktor fare, natyrisht është faktor por nuk është faktori kryesor sepse faktorët tjerë po e mundin këtë faktor të cilin ne sipas ... e kemi përmirësuar dukshëm, mirëpo nuk është se kemi parë ndonjë rezultat jashtëzakonisht pozitiv në ekonominë e vendit.

Dhe, tash Qeveria po mendon se duhet të vazhdojmë me të njëjtën normë, pra prapë po vazhdon me të njëjtat metoda duke shpresuar që do t'i kemi rezultatet pak më tjera, ose më ndryshme.

Faktori kryesor, natyrisht te investimet edhe që i nxit investimet është tregu. Mundësia që prodhimet ose shërbimet që i mundëson një kompani të kenë vend plasimi të plasohen ato, të shiten, të blihen dhe kështu të ndodhë transaksioni ekonomi i cili është baza e ekonomisë.

Dhe tatimi i korporatave në kushtet të cilat është Kosova ua rrit profitin financiar korporatave varësisht qarkullimit të tyre vjetor. Dhe ky profit jo domosdoshmërisht riinvestohet nëse nuk ekzistojnë mekanizma që e drejtojnë këtë riinvestim dhe ky kthehet pastaj në rritje të profitit i cili

përdor për qëllime tjera të cilat mund të quhen qëllime si të them kështu gjysmë ekonomike ose jashtë ekonomisë së vendit. për shembull në rastin e Kosovës po ta marrim gjendjen si e kemi sot tatimi në korporata prej 10% po ta krahasojmë me një 20% që ka qenë në vitin 2009 më së shumti u konvenon kompanive si Devolli grup që kanë qarkullim të lartë dhe fitim të lartë, Kompani si ELKOS-i të Ramiz Kelmendit që po ashtu kanë qarkullim të lartë, profit të lartë, kompanisë “Behtel”, që fiton shumë nga Kosova dhe paguan pak tatim, kompanive si KEDS, që po ashtu fiton shumë dhe paguan pak tatim, kompania si Aeroporti që po ashtu fiton shumë dhe paguan më pak tatim. Pra këto janë ato kompani që përfitojnë nga kjo ulje e normës tatimore.

Ndërkohë që kjo normë e tatimore e ulja e saj nuk është se ka pasur ndikimin e njëjtë real te ndërmarrjet e vogla dhe të mesme që është një pjesë më e madhe e ekonomisë në Kosovë të cilat do të kishin me pas potencial për zhvillimin e vendit po e se do të përdoreshin mekanizma që do të ju ndihmonin këtyre kompanive.

Riinvestimi natyrisht që nënkupton rritjen e kapaciteteve prodhuese, rritjen e punësimit, përmirësimin e prodhimit e të tjera. dhe këto janë drejtpërdrejta të lidhura siç e thash me tregun, pra me mundësinë e plasimit të këtyre prodhimeve a shërbimeve në mënyrë që kështu përmes plasimit, përmes shitjes të rritet nevoja për prodhim më shumë e rrjedhimisht të rritet nevoja edhe për punëtorë më shumë. Pra, kjo është paka shumë logjika se si do të duhet të funksiononte një ndërmarrje dhe një ekonomi në përgjithësi.

Dhe, këtu prapë ata që i mbrojnë dhe i promovojnë tatimet e ulëta thonë që tatimi i ulët u arrit konkurrueshmërinë në kompani sepse nëse paguajnë më pak tatim atëherë mund të dalin me produkte ose shërbime më të lira në treg dhe si të tilla janë më konkurruese në treg. Gjë që prapë mendoj unë është farsë, sepse këndvështrimi bazë që përdoret në këtë rast është ai i parcializuar, pra nuk e sheh ekonominë si të tërë, nuk e sheh ekonominë si të ndikuar nga shumë faktorë të ndryshëm por e parcializon vetëm në një pjesë të saj dhe si të tillë e bënë një keqkalkulim do të kisha thënë, edhe pse përbrenda mendësisë së kësaj pjesëve kalkulimi mund të duket i mirë dhe i rregullt i saktë.

Për tatimet janë njëri prej faktorëve dhe ka natyrisht shumë faktor tjerë pastaj që ndikojnë çmimin e produktit final siç është kostoja e punës, produktiviteti i saj, kostoja ... lënda e parë, kostoja e saj, infrastruktura fizike, procesi i prodhimit, tregu, hapësira në treg dhe të tjera.

Për të mos zgjatur shumë me këtë temë mjafton t'i krahasojmë disa vendet të zhvilluara dhe normën e tyre të tatimit te korporata. Për shembull po i marr disa prej vendeve të Bashkimit Evropian. Gjermani në vitin 2015, e ka 29,65%, Franca e ka 33,33%, pra prej vitit 2006 me sa kam unë të dhëna mbas edhe më herët nuk ka se ka pasur ndryshim në këtë normë të tatimit në korporata. Danimarka e ka 23,5%, Kroacia e ka 20%, Belgjika e ka 33,99%, Shtetet e Bashkuara të Amerikës një ekonomi shumë e madhe tatimin në korporata e ka 40%, përgjithësisht mesatarja në Bashkimin Evropian në vitin 2015 është 21,34% tatimi në korporatat.

Dhe njëkohësisht të gjitha këto vende që i përmenda por edhe të tjera që nuk po i përmendi këtu e kanë konkurrueshmërinë shumë të lartë në treg.

Pra, përkundër këtyre tatimeve më të larta në korporata konkurrueshmëria e atyre është shumë e lartë në treg dhe natyrisht që ekonomitë e tyre disa më shumë e disa më pak kanë rritje dhe kanë zhvillim të krijojnë vende të reja të punës.

Pra, në alternativën qeverisëse të Lëvizjes “Vetëvendosje” ne propozojmë një model tjetër për politika tatimore. Norma tatimore duhet të jenë më të larta, mirëpo politika si e tillë do të zgjerohet për t’i stimuluar hapjen e vendeve të reja të punës. Çdo kompani që dëshmon riinvestimin e fitimit për hapjen e vendeve të reja të punës sidomos në prodhim do të lirohet nga tatimi dhe do të ketë periudha kur do të jetë e lirë nga tatimi. Pak ngjashëm me atë që e përmendi edhe ministri si njërin prej ndryshimeve që i bëhet këtij tatimi në Ligjin për korporatat.

Po ashtu punëdhënësi që punësojnë punëtor të rinj ata ekzistues sipas numrit dhe statusit të ndërmarrjes do të përfitojnë subvencionimin progresiv tatimor, pra për secilin vend pune që krijohet do të kenë subvencionim tatimor për të kushtëzuar kështu ose për ta inkurajuar të them investimin e profitit ose qarkullimit të një kompanie ose një korporate brenda vitit në investim i cili është i orientuar drejt krijimit të vendeve të punës, pra të rritjes së kapaciteteve prodhuese edhe përgjegjësish rritjes së efikasitetit të ndërmarrjes.

Politika tatimore me Lëvizjen “Vetëvendosje” do të riformulohet në favor të rritjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme drejtë prodhimit dhe punësimit. Administratës shtetërore do të transformohet për t’i shërbyer ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në mënyrë që të sigurohet që evazoni fiskal të mos bartet tek ndëshkimet tatimore për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme që lejet dhe taksat komunale dhe qendrore të jenë të unifikuara dhe që shërbimet të cilat jepen nga administrata të jenë në funksion të zhvillimit.

Në nenin 7.3 të ligjit që po e diskutojmë dhe këtë e kam më shumë në formë të pyetjes për ministrin, thuhet që pushimet tatimore dhe lehtësira të veçanta për bizneset e reja do të përcaktohen me aktin nënligjor të nxjerr nga ministri. Mirëpo në ligj me sa e kam pa unë nuk ka kurrfarë kriteresh në çfarë raste, cilave kompani, për çka do t’u jepen këto lehtësira. Po thua në kompani të reja, po kompani të reja janë të ndryshme. Domethënë edhe kjo është, si po e kuptoj unë është edhe një dimension tjetër i kësaj fshehtësisë që do të përdorin masën e njëjtë për të gjitha kompanitë e reja pavarësisht ndikime që këto kompani mund ta kenë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Në emër të Grupit Parlamentar AAK, fjalën e ka Bali Muharremaj.

BALI MUHARREMAJ: Faleminderit, kryesuese!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Aleancës, ka shqyrtuar Projektligjin për tatimin në të ardhurat e korporatave. Në kuadër të politikave fiskale, tatimi në të ardhurat e korporatave zë një vend kyç.

Ndryshimi dhe reformimi i mënyrës së tatimit të korporatave bashkë me tatimin e vlerës së shtuar është bazë e reformës së sistemit fiskal.

Duke u nisur nga deklaratimet publike si gjatë shpalesjes së programeve para zgjedhore ashtu edhe në programet e Qeverisë së këtij koalicioni kemi pritë që të ndryshohet ligji për të ardhurat korporatave, të ofron ndryshime përmbajtësore e jo kozmetike. Siç e gjejmë këtë draft-ligj qoftë për nga përmbajtja, qoftë për kah forma.

Kërkojmë që ligji të plotësohet edhe me lejimin apo lirimin nga tatimi të korporatave për një periudhë 3 deri në 5-vjeçare për biznese të reja apo investime të reja nga bizneset ekzistuese të cilat me investimet e tyre garantojnë hapjen e 10 apo më shumë vendeve të reja të punës.

Po ashtu të lirohet përkohësisht prodhuesit e produkteve të destinuara për eksport. Secili investitor i jashtëm që investon një milionë e më tepër të lirohet nga tatimi në të ardhurat e korporatave për një periudhë tri vjeçare.

Të rishikohet propozimi për përfshirjen e obligimeve të dividendës në obligim, tatim prej 10%, kjo dekurajon pronarët, aksionarët për kursime dhe mendojmë që është masë më efekte negative.

Ligji i propozuar mban normën e deritashme të tatimit në të ardhurat e korporatave prej 10%, përjashtim këtu bënë zbritje në 5% për kompanitë e sigurimeve që bëjnë sigurimin e jetës dhe pronës.

Konsiderojmë si veprim të mirë zbritjen e normës së tatimit nga 10 deri në 5% për kontributet humanitare, arsim, shkencë e të tjera.

Kemi rezerva për nenin e ri 31/1 i vetmi nenë plotësisht i ri në krahasim me ligjin në fuqi me të cilën ngarkohen bizneset që të mbajnë në burim 3% nga qarkullimi i prodhuesve dhe kategorive të veçanta si bujq dhe grumbullues e të tjera.

Në nenin 35, është përcaktuar obligimi për mbajtjen e librave dhe regjistrave për bizneset që kanë të ardhura bruto mbi 50 mijë euro, me qenë se është zbritje e pragut të deklarimit të TVSH nga 50 mijë në 30 mijë euro që të mos harmonizohet edhe në këtë ligj ky nivel.

Edhe neni 36, të harmonizohet me nenin 35.

Një vërejtje jona esenciale dhe po ashtu kërkesë është zbritja e normës së deritashme prej 9% nga të ardhurat bruto të shërbimeve dhe veprimtarive profesionale në 5%.

Dhe në fund, neni 41 hyrja në fuqi, nuk mund të bëhet më 1 korrik 2015 siç është e propozuar. Mendoj që kjo duhet të ndryshohet për 1 janar të vitit 2016.

Grupi Parlamentar i Aleancës do ta japë përkrahjen në këtë projektligj në leximin e parë, ndërsa në leximin e dytë do ta japim kontributin. Faleminderit!

Kryesuesja: Faleminderit! Në emër të Listës Serbe, fjalën e ka kërkuar Milka Vuletiq, por nuk është e pranishme në sall. Atëherë në emër të Grupit Parlamentar Nisma, a dëshiron dikush ta merr fjalën. Deputetja Shukrije Bytyqi. Regjia, ju lutem jepjani fjalën deputetes Shkurije Bytyqit. Regjia, ju lutem Shkurije Bytyqi e ka fjalën.

SHUKRIJE BYTYQI: Faleminderit, kryesuese!

Grupi Parlamentar Nisma për Kosovën e ka shqyrtuar Projektligjin për tatimin në të ardhurat e korporatave dhe ne e përkrahim këtë projektligj në lexim të parë, ndërsa kontributin tonë do ta japim në Komisionin përkatës. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “6+” fjalën e ka Fikrim Damka.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

“6+” Parlamenti Grubu olarak işletmelerin gelir yasa taslağını incelediğimizi ve Kosovada böyle bir yasanın önümüzdeki dönemler içerisinde işletmelerin çalışması açısından kolaylıklar getireceğini inanmaktayız ve “6+” Parlamenti Grubu bu Yasayı desteklemektedir.

KRYESUESJA: Faleminderit! Atëherë vazhdojmë diskutimet sipas radhës, deputeti Besim Beqaj.

BESIM BEQAJ: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Unë e kam mirëpritur ndryshimin e Ligjit për tatimin në korporata i cili kryesisht ka të bëjë me atë që quhet qartësim të definimeve dhe mundësinë që besoj që është dhënë me këtë ligj që pushtimet tatimore të bëhen pa ndonjë procedurë burokratike por të merret me një akt nënligjor i cili e bënë ministri sigurisht në harmoni me Komisionin për buxhet dhe Financa sepse është logjike që Kuvendi të informohet për gjërat të cilat janë të një rëndësie të tillë.

Ajo çka kisha dashur që edhe një herë të rishikohet është tatimi në dividendën e tërhequr. Kjo ka qenë një levë e fuqishme për tërheqjen e investitorëve, ndërsa nga aspekti buxhetor nuk e besoj që do të ketë ndonjë ndikim të madh buxhetor sigurisht që po të kishte ndikim të madh buxhetor do të krijonte të hyrat të cilat janë të respektueshme dhe që duhet t'i trajtojmë, mirëpo si leje e humbur për trajtimin e investimeve të huaja ose investimeve në vend do të jetë element jo shumë i mirëpritur. Prandaj, në frymën e krijimit të ambientit sa më të mirë për biznes dhe për investime rikthimi i tatimit në dividendën e tërhequr besoj që nuk kontribuon shumë në zhvillim.

Pra, ju kisha lutë edhe ministrin edhe Komisionin gjatë dy leximeve që ta rishikojnë edhe një herë, ta shohin cilat janë arsyet e vërteta për të kthye këtë tatim në dividendë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ramiz Kelmendi.

RAMIZ KELMENDI: Përshëndetje kryesuese,

Ministra,

Zakonisht tatimi në dividendë të shtuar ja takon një numër të vogël të biznesmenëve. Ne nuk kemi radhë të madhe të investitorëve të jashtëm që janë duke pritë në Kosovë dhe janë duke tërhequr dividendat e mira nga Kosova sidomos ndoshta në lëmin e shërbimeve që ne të qesim taksë shtesë për arsye se kemi mundësi të krijojmë inkasim dhe rritje të buxhetit.

Diferenca nga 10% në 20% për investitorët e brendshëm që dëshirojnë të shkojnë jashtë shtetit të Kosovës dhe të zgjerojnë veprimtarinë e vet jashtë shteteve të Kosovës, e dëmton shumë

seriozisht. Për arsye se shumica e investitorëve vendor munden që me këto mjete të krijojnë dividendë në shtete tjera, të ju mundësojnë plasmanin e prodhimeve kosovare në shtetet e regjionit dhe të kthejnë dividendë në Republikën e Kosovës në një farë forme duke shtua kapitalin dhe investimet e brendshme këtu.

Këtë lloj të dividendës nuk është dashtë fare të implementohet sidomos te veprimtaritë prodhuese. Ne nuk kemi shumë kompani prodhuese botërore që vijnë në Kosovë që ne duhet t'i tatimojmë edhe me 10% për kapitalin që ato i tërheqin. Pra, duhet t'i motivojmë që ata të vijnë, t'i punësojnë njerëzit dhe të tërheqin dividendën me formën e kaluar që është 10%.

Prandaj, kisha kërkuar te Komisioni në leximin e dytë në punën e tyre që ta shqyrtojnë me seriozitet dëmin që mund të ju shkaktojnë investitorëve vendor në shkuarjen jashtë shtetit të Kosovës në investime që derivojnë jashtë shtetit të Kosovës. faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Dhe diskutuesi i fundit në këtë pikë është deputeti Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: E nderuar nënkryetare!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Mendoj se ky ligj ka bërë disa përmirësime të ndjeshme në aspektin e përkufizimeve siç u tha këtu, por edhe në stimulimin më të madh të investimeve në kapitalin njerëzor sidomos në trajnimet, në edukimin edhe në sponsorimet për ngjarje sportive të cilat kanë qenë kërkesë për një kohë të gjatë dhe në këtë drejtim ka sjellë risi pozitive.

Gjithashtu edhe pushimet në taksa janë të rëndësishme sa i përket tatimeve në të ardhura por në fitim edhe pse kryesore do të jetë sa do të bëjmë për nxitjen e investimeve të jashtme sidomos të jashtme por edhe vendore sa do të bëjmë progres në zbatimin e shtetit ligjor dhe luftën kundër korrupsionit.

Ajo që mendoj se duhet ndoshta të trajtohet edhe një herë është, edhe unë mendoj është çështja e dividendes të maten efektet, cilat janë efektet nga futja e dividendes dhe cilat mund të jenë eventualisht probleme. Sidomos tatimin në dividendë e kemi në këto dy ligje, ndoshta ka logjik me mbetë tatimi në dividendë të të ardhurat personale, në qoftë se dikush e tërheq dividendën në formë të ardhurave personale paguan si gjithkush tjetër. Po në qoftë se të tatimi në të ardhura në fitim po më mundet duhet të jemi të kujdesshëm sepse një herë paguhet 10% tatimin në të ardhurat e korporatës përkatësisht..., mandej jetë fitimi neto prej kah merren dividendat dhe tash në qoftë se dikush e tërheq dividendën si në formë të ardhurave personale natyrisht që ajo trajtohet si të gjitha të ardhurat tjera personale, por këtu edhe një herë tatimi mos po krijohet një konfuzion edhe të tatimi i të ardhurave dhe këtu nuk di sa ka vend po duhet të trajtohet edhe një herë kjo çështje. Faleminderit!

KRYESUESJA: Fjalën e ka përfaqësuesi i Qeverisë, ministri Hoti.

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Dy çështje desha t'i adresoj.

E para për këto lirimet tatimore të cilat ne i kemi planifikua të bëjmë akt nënligjor të ministrit të Financave normalisht në konsultim me Komisionin për Buxhet dhe Financa të cilat do të jenë të barabarta për të gjithë normalisht. Në bazë të programit qeverisës i kemi përcaktuar prioritetet, i dimë cilët sektor janë me prioritet, cilët do t'i mbështesin, cilat nevoja i ka Kosova dhe me ato akte nënligjore ne do t'i përcaktojmë sektorët për shembull bujqësinë, AIT-në përpunimin e ushqimit dhe sektor të tjerë ose regjione të caktuara, nivelin e investimeve, numrin e vendeve të reja që punësohen, duke i marrë krejt këto parasysh do të dizajnohen lehtësira për tërheqje investime të reja.

Dhe ky proces unë ju garantoj që del plotësisht transparent dhe në konsultim me Komisionin për Buxhet dhe Financa.

Te dividenta, kjo është normë tani që e re që e kemi futë, por është vetëm atëherë kur dividenta tërhiqet nga biznesi dhe vetëm kur tërhiqet për qëllime nëse muaj ta quaj konsumuese. Nëse dividenta tërhiqet nga një biznes për qëllime të investimit në biznesin tjetër kjo do lirohet normalisht. Nëse pronari i biznesit ofron çfarëdo evidence që këtë dividendë e ka investua në biznesin tjetër të tij ose në çfarëdo forme tjetër e ka investua, pra nuk e ka qua për qëllime konsumuese kjo do lirohet. Përndryshe është normale edhe nga aspekti i barazisë që çfarëdo e ardhur personale që dikush merr ajo të tatimoret. Përndryshe komentet e profesorit Muhamet do i shqyrtojmë besoj edhe me bashkë edhe me Komisionin edhe me grupin punues dhe do shohim si ta bëjmë një zgjidhje sa më të pranueshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Me që nuk kemi kuorum, atëherë a po pajtoheni që të vazhdojmë edhe me dy pika tjera të rendit të ditës dhe pastaj shkojmë në pauzë dhe kur të kthehemi vazhdojmë me votimin.

Kalojmë te pika e gjashtë:

6. Shqyrtimi i raportit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2014

Komisioni funksional për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinorë në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit, ka shqyrtuar raportin vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2014 dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

Gjithashtu edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2014 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Tash fjalën e ka kryetari i Komisionit Funksional për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor, zoti Fikrim Damka, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit e nderuar kryesuese!

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Bujqësi dhe Mjedis, në bazë të nenit 72 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 13 maj 2015 e shqyrtoi raportin vjetor të punës për vitin 2014 të Agjencisë për

Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqes këtë rekomandim.

Të miratohet raporti vjetor i punës për vitin 2014 të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës.

Në bazë të Ligjit për Agjencinë e Komplekseve Memorialë, kjo agjenci ia paraqet Kuvendit raportin vjetor të punës.

Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 13.5.2015, shqyrtoi raportin vjetor të punës për vitin 2014 të kësaj agjencie, ku janë parashtruar edhe pyetjet për zyrtarët e agjencisë nga anëtarët e komisionit.

Komisioni vlerësoj se raporti vjetor i punës për vitin 2014 i parashtruar nga kjo agjenci është më e avancuar krahasuar me vitin paraprak. Por kjo agjenci duhet të kompletohet me projekte që duhet të barten prej Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë dhe është në pajtim me ligjin e cekur më lartë.

Komisioni rekomandon Kuvendit për miratim. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit!

E ftojme kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, Naser Osmanin për arsyetimin e raportit me rekomandime.

NASER OSMANI: Faleminderit!

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës e ka dorëzuar në Kuvend raportin vjetor financiar për vitin 2014 brenda afatit ligjor.

Raporti pasqyron të dhënat për buxhetin e miratuar, ndryshime që ka ndodhur gjatë vitit si dhe të dhënat për shpenzimet e buxhetit sipas kategorive dhe nënkategorive ekonomike dhe krahasimin e tyre sipas viteve.

Buxheti fillestar i ndarë për agjencinë për menaxhimin e komplekseve memoriale të Kosovës për vitin 2014 ka pasur një milionë e 167 mijë e 86 mijë euro, ndërsa pas ndryshimit që janë bërë si rezultat i vendimit të Qeverisë për shkurtimet e buxhetit në kategorinë mallra dhe shërbime prej 4500 euro. Buxheti përfundimtar ka qenë një milion e 92 mijë e 574 euro. Nga kjo shumë janë shpenzuar 772 mijë e 991 euro apo 67%.

Ndërkaq agjencia ka bërë kërkesë në Ministrinë e Financave për transferin e mjeteve nga kategoria kapitale në komunal në shumë prej 22 mijë e 285 euro. Kjo shumë është bartur për shtyrjen e borxhit për kompleksin memorial Adem Jashari në Prekaz.

Komisioni për Buxhet dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më 15 prill, pasi e shqyrtoi raportin vjetor financiar të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë për vitin 2014, vlerëson se raporti përmbush obligimet ligjore për raportim që dalin nga Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe i rekomandon Kuvendit për aprovim. Faleminderit!

KRESUESJA: Faleminderit! Vazhdojmë me deklarimet e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka Emilija Rexhepi.

EMILJIA REDŽEPI: Zahvaljujem se potpresednice parlamenta.

Parlamentarna grupa PDK, razmotrila je godišnji izveštaj Agencije za menadziranje memorijalnih kompleksa Kosova za 2014. godinu i glasa će za preporuke koje Komisija za poljoprivredu i životnu sredinu preporučila Skupštini za usvajanje. Zahvaljujem!

KRYESUESJA: Faleminderit! Kush e do fjalën në emër të LDK-së? Zoti Adem Salihaj, urdhëro!

ADEM SALIHAI: Faleminderit, zonja kryesuese!

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar këtë raport në fakt raporti është me të dhëna mjaftë të kufizuara, të themi një raport jo edhe aq i pasur por është një raport real i cili e ka pasqyruar realisht gjendjen e kësaj agjencie.

Në fakt, agjencia punon në kushte shumë të këqia, ka vetëm dy zyra të vogla në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës, e ka një buxhet të kufizuar dhe pothuajse raporti përfshin në masë të madhe menaxhimin e kompleksit memorial “Adem Jashari” dhe shumë pak të komplekseve tjera memorialë në Kosovë.

Pra, kjo ka ndodhë si pasojë e mundësive të kufizuara që ka kjo agjenci edhe në aspektin e kuadrove edhe në aspektin e hapësirave të punës por edhe në aspektin e buxhetit të alokuar për të.

Në fakt ne mendojmë që kjo agjenci duhet të ketë një mundësi më të madhe se sa deri më tash, duhet të kompletohet me staf, duhet t’i epet një buxhet më i madh dhe në kuadër të kësaj agjencie të hyjnë nën menaxhim të gjitha komplekset memorialë që janë në Kosovë, duke përfshirë edhe përmendoret e ndryshme që janë të rëndësisë nacionale.

Në këtë kuptim pra, agjencia duhet të punojë edhe vetë shumë më tepër në mënyrë që ta realizoj në tërësi dedikimin që ka në bazë të ligjit për këtë çështje.

Unë mendoj që, edhe një aspekt i cili sigurisht duhet të trajtohet nga agjencia është menaxhimi i përmendoreve të ndryshme të cilat janë ngritur edhe privatisht nga familjet të ndryshme të dëshmorëve për arsyen e thjeshtë sepse institucionet e Kosovës nuk kanë treguar një kujdes të duhur për këtë çështje dhe mendoj se në të ardhmen nën menaxhimin e kësaj agjencie, por edhe të institucioneve tona duhet të trajtohen në mënyrë dinjitoze, sepse deri më tash duhet të themi realisht se nuk ka pasur një trajtim të tillë.

Duke marrë parasysh të gjitha këto, pra lidhur me punën e kësaj agjencie Grupi ynë parlamentar do të votojë për dhe do ta përkrahë aprovimin e këtij raporti. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, fjalën e ka Ilir Deda.

ILIR DEDA: Faleminderit, kryesuese!

Raporti i Agjencisë së Komplekseve Memorialë tregon që krijimi i agjencisë është bërë në nguti pa i përmbush kushtet për funksionim të mirëfilltë të kësaj agjencie.

Dhe në Komisionin për Buxhet dhe Financa kur e kemi diskutua njëjtë i kemi inkurajua që në qershor gjatë rishikimit të buxhetit agjencia t'i shtinë në planifikim burimet njerëzore shtesë që të ketë mundësi që ta kryejë detyrën e vetë dhe t'i zbatoj përgjegjësitë e veta.

Ne jemi kundër mundësisë të partizimit të komplekseve memorialë në Kosovë dhe në këtë frymë Lëvizja "Vetëvendosje" e inkurajon Agjencinë e Komplekseve Memorialë të Kosovës që të kërkojë fonde shtesë edhe për kompleksin memorial të Koshares dhe të tjerat, por në të njëjtën kohë duhet të jemi të vetëdijshëm që edhe komunat e Kosovës kanë rol në mirëmbajtje edhe ato duhet që ta kryejnë punën e vetë. Domethënë ne tash nuk mund të presim prej një agjencie, e cila është e paraparë t'i ketë vetëm nëntë zyrtarë që të merret me të gjitha, mirëmbajtjen e çdo kompleksi memorial në Kosovë, një pjesë duhet ta ketë komuna, po të njëjtën kohë për të mëdha duhet të ketë përgjegjësinë kryesore e ka agjencia.

Dhe ne shpresojmë se në qershor do të epet një fond shtesë që të filloj puna në Koshare sepse është e papranueshme që në Kosovë të ketë partizim të dëshmorëve dhe të komplekseve të ndryshëm memorialë. Duhet të dalim nga kjo praktika e përfaqësimit të partive politike për diçka që duhet ta konsiderojmë me shumë më shumë dinjitet dhe me shumë më shumë pietet.

Ne do ta votojmë raportin e Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, fjalën e ka deputeti Daut Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryesuese!

Edhe unë sinjerisht mendoj që ky raport as për së afërmi si përmbush kriteret për me marrë votën tonë por edhe në rast se votojmë kundër edhe ashtu nuk ndryshon asgjë.

E vërteta është që ky raport më shumë flet për mungesën e fondeve edhe flet për një memorial të caktuar, ndërsa në këtë Kuvend i kemi votua përfaqësisht siç e tha edhe zoti Salihu në të gjitha komunat e Kosovës, kjo agjenci e ka për obligim mirëmbajtjen, mbikëqyrjen e memorialëve.

Në rast se e këqyrim në detale ky thotë do ta bëjmë, do ta shqyrtojmë, do ta këqyrim, shpresojmë e kështu me radhë. E kaluara para një viti, kjo agjenci ka qenë në kuadër të Ministrisë së Planifikimit Hapësinorë dhe kur është bërë kjo ndarje është bërë deri diku me u krijuar një agjenci në kuadër të Kuvendit të Kosovës ku përfaqësimi i përgjithshëm politik mundet me kërkua prej kësaj agjencie që me u trajtua barabartë të gjitha ato vlera nacionale të cilat i quajmë.

Edhe një herë mendoj që ky raport, ne do t'i japim mbështetje për shkak se është tema siç është por shpresoj që edhe drejtori i agjencisë nuk do të vijë më me raporte veç na shpjegoi se çfarë mungesash ka, por do të merret me ndinjë punë konkrete se sinjerisht gjithçka është për raportin nuk është. I tërë raporti koncentrohet në një vend, ndërsa harron që ka thuaja në çdo komunë ka

vena që ka shtatore, ka memorialë, ka komplekse memorialë domethënë, kërkesat e këtij raporti janë se na duhen dy ciceronë, na duhen tri roja, na vyen një rojë, na vyen një ciceron, domethënë edhe përmbajtja kryesore e raportit pozitiv është se Kuvendi i Kosovës i ka dhuruar një makinë.

Domethënë kaq ky raport ka për t'u mburrur deri tash. Unë edhe një herë po them edhe nëse e votojmë kundër nuk e di çka ndryshon, por shpresoj që agjencia është duke na dëgjuar dhe herën tjetër të paktën e merr më seriozisht. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Në emër të Listës serbe, a dëshiron dikush ta merr fjalën. Atëherë në emër të Grupit Parlamentar Nisma, e ftojme deputetin Zafir Berisha,

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesuese!

Edhe ne si grup parlamentar mbështesim raportin e Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë.

Si do që të jetë për këtë agjenci, në një nga seancat e kaluara është debatua për shkak të një pozicioni buxhetor. Po më lejoni që me këtë mbështetje të jap edhe një sugjerim me që pas një kohe të shkurtër do të kemi edhe rishikimin e buxhetit. Po mendoj që kjo agjenci duhet të jetë më gjithë përfshirë. E ka me një farë forme edhe Dauti, por unë po mendoj se memorialët që përkujtojnë lavdinë e qytetarëve të Kosovës janë anë e mbanë Kosovës dhe agjencia në një bashkëpunim më të ngushtë veçanërisht me komunat ta bëjnë një agjendë dhe disa specifika që të jetë agjenci me të vërtetë e gjithë Kosovës dhe ne e kemi parasysh se memorialët janë që nga komuna më e largët domethënë atje Dragashi deri në Llap, Karadak e në Bjeshkët e Rugovës, për me marrë atë ngjyrën që i takon kësaj agjencie. Unë mendoj një bashkëpunim të ngushtë me kuvendet komunale, besoj se do ta merr atë kuptimin, sepse ne kemi parasysh se me 9 punëtorë që i ka kjo agjenci është e pamundshme dhe sigurisht në planin e vetë për gjashtëmujorin e dytë duhet t'i ndryshoj prioritetet pasi janë disa memorialë të paprekura, për mos me hy me i përmend me emra. Faleminderit!

KRYESUESJA: Në emër të Grupit "6+", dëshiron dikush ta marrë fjalën. Atëherë vazhdojmë me diskutime. Fjalën e ka deputeti Nezir Çoçaj. Fjalën e ka Xhevahire Izmaçu.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryesuese!

Unë bashkë me kolegët e mijë të Grupit Parlamentar, sigurisht që e kemi shqyrtuar raportin dhe pikërisht për arsyen që raporti është tejet i dobët dhe shumë pak profesional. Plotësisht pajtohem me mendimin edhe të kolegut zotit Haradinaj që e tha që ne si deputetë me të vërtetë s'di a e meritojmë me pas këtë shkresë në dorë.

Mënyra e cila është hartuar raporti tregon që brenda kësaj agjencie gjenden punonjës, zyrtarë të cilët nuk e kanë as bazën elementare të njohurive duke e ngatërruar edhe pjesën e parë pra misionin me vizion ku tek vizioni parashikojnë që të ndërtojnë edhe një faqe, një WEP faqe. Pra, krijimin e WEP faqes e shohin si vizion që nuk duhet mu diskutua në ditët e sodit. Pastaj, hartimin e planeve e shohin tek vizioni, ndërsa tek fushëveprimi që e mbulon institucionin e paraqesin organo-gramin, ku edhe ankohen që nuk kanë anëtarë të bordit. Sigurisht që vetëm edhe këta mungojnë me i shtua harxhime edhe shpenzime buxhetit të shtetit kur po shihet që me të vërtetë është shumë lehtë me kritikua edhe nuk është qëllimi që të dekurajohen këta punonjës

po me të vërtetë është për keqardhje, aspak edhe më së paku nëse i përngjan diçka një raporti është ky raport që e kemi sot. Por, shpresoj që ka me qenë i fundit për këtë vit që marrim nga një institucion i cili ka një qëllim shumë më madhor dhe pikërisht pse dëshirojmë që ta shohim këtë institucion në nivel shumë më të lartë edhe sigurisht që do ta votojmë. Mirëpo, nuk e meriton as që të flitet sot për këtë raport le më që të ngrihet dorë e të votohet.

Në vend që të kemi një planifikim dhe një ambicie më të mirë për trajtim të këtyre institucioneve të cilat kanë një vlerë jo veç institucionale por shumë edhe morale. Këtu flitet për hallet e tyre të cilat kërkojnë buxhetin e shtuar dhe numrin e punonjësve. Pra, tek aktivitetet për periudhën raportuese thotë punësimi i stafit të nevojshëm. Tash nuk e kuptojmë a është plan a është raport. Edhe punët, edhe prapë planet që parashikohen për vitin vijues po shihen që kërkohet rritja e buxhetit.

Pastaj, tek planifikimi thotë, bashkëpunime me institucione vendore dhe ndërkombëtare. Ne nuk e kemi asnjë të dhënë se a kanë pasur ndonjë tentativë që të ketë një bashkëpunim edhe sinqerisht unë dyshoj me këtë nivel që kanë shkrua këta zyrtarë që dikush nga institucionet vendore ose ndërkombëtare ka me pasur dëshirë me bashkëpunua. Mirëpo ne si deputetët sot i thërrasim e dimë që në bazën ligjore e kemi krijuar vetë edhe s'ka pasur nevojë me theksua gjysmën e raportit me bazën ligjore. Por nuk e dimë deri ku ka shkua pastaj plotësimi dhe realizimi i akteve sekondare që sigurisht ndoshta edhe i kishin ndihmua pak funksionalizimit të kësaj agjencie.

Me dëshirën që të filloj të punoj pak më mirë dhe që të kemi një raport që quhet tamam raport sigurisht do ta jap votën, mirëpo dyshoj që ka me pas një punë më të mirë t'u e pa që s'paska ambicie aspak personat që e udhëheqin thjeshtë ju mungon edhe baza elementare për drejtshkrim. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Të nderuar kolegë deputetë,

Dy vite pas themelimit të kësaj agjencie dhe pas shqyrtimit të trajtimit të këtij raporti e kam një pyetje.

Vërtetë a kemi bërë mirë që kemi themeluar këtë agjenci për të gjithë ne, për gjithë ne deputetët që e kemi votuar dhe kemi bërë me ligj që këtë agjenci. A ishte më mirë kur komplekset memorialë trajtoheshin kah Ministria e Ambientit, apo ne edhe sot duhet të mendojmë që pas kësaj mos pune dyvjeçare, masë gjendjes të cilët janë komplekset memorialë dhe gjendjen të cilën jashtë shtatoret e dëshmorëve tanë dhe heronjve tanë të cilat janë të mbuluara nga pluhuri dhe nuk ka kush t'i fshijë ato dhe qëllimi i themelimit të kësaj agjencie ishte mirëmbajtja e tyre. A e bëri kjo agjenci punën e vet si duhet? Dhe a kemi bërë mirë që kemi themeluar si të tillë dhe nëse nuk kemi asnjë masë ndëshkimore, ndëshkuese kur vërejmë të gjithë këtu si deputetë një mos punë të tillë si mund t'i largojmë këta njerëz ose t'i angazhojmë më tutje që ata të punojnë vërtetë për qëllimin për të cilën kanë marrë detyrën e tyre.

Sot komplekset memorialë janë në gjendje të rëndë dhe kjo agjenci për dy vjet nuk ka arritur që projektet të cilat kanë qenë të planifikuara edhe ligjërisht të barten nga Ministria e Ambientit të agjencia për dy vjet nuk ka arrit t'i barët. Projektet e tij nuk ka arrit me i bartë, me i transferua prej Ministrisë së Ambientit në agjenci i ka disa projekte që ende vazhdojnë të trajtohen nga Ministria e Ambientit dhe kur e shohin gjenden e varrezave në Koshare dhe atyre në Polac dhe e Kompleksit në Morinë vërtet nuk ka asnjë koment më tepër për funksionalizimin dhe punën e kësaj agjencie.

Realisht drejtori i kësaj agjencie nuk ka arrit me bë punën e tij për të cilën e merr pagën dhe nuk ka arrit as me funksionalizuar agjencinë se lere më edhe t'i bartë projektet dhe në të presim që ai në të ardhmen me bë diçka tjetër.

Në këtë raport ky drejtor paraqet një mosangazhim të punës së tij. Ai na ankohet neve në raportin e tij se punon në dy zyre të Kuvendit t'i cilit ja ka dhurua kryetari apo Kuvendi i Kosovës. Do të thotë për dy vjet nuk ka qenë në gjendje ta zgjedhë problemin e objektit të tij dhe pret që ky objekt t'ia zgjedhë problemin, t'ia zgjedhë Administrata Publike.

Është këtu një çështje që vërtetë ne duhet ta mendojmë si deputetë, kur themelojmë këto agjenci edhe funksionimin e tyre dhe formën masë raportimeve të tyre, masë këtyre raporteve negative që u thanë nga shumica e kolegëve që ky raport përmban shumë vërejtje dhe nuk e meriton të kalohet, vota do të shkojë e deputetëve vetëm për hir të atyre që kanë ra jo për shkak të punës që ka bërë agjencia. Por, ne nuk jemi duke trajtua këtu veprat heroike të dëshmorëve tanë, por jemi duke trajtua një punë të cilën është dashtë me e bë dhe me e vlerësua kjo agjenci.

Prandaj, unë mendoj që nuk do të jetë vota për, nuk duhet të jetë vota për këtë raport për arsye se nuk paraqet asnjë punë, është 'non sens' të votohet ky raport dhe mendoj që në të ardhmen ne pasi jemi duke trajtua edhe besoj që shpejtë do të na vjen edhe Rregullorja e Punës së Kuvendit të mendojmë për agjenci, të cilat i raportojnë Kuvendit. Nëse ato agjenci nuk e marrin votën pozitive, a do të thotë që ato prapë vazhdojnë me punua me atë trendë negativ, nëse ato agjenci të cilat do qofshin të pavarura që i raportojnë Kuvendit dhe ato marrin notë negative nga Kuvendi ai menaxhment nuk e meriton më të udhëheq. Duhet të punohet që të ndërrohet menaxhmenti aty ku të gjithë deputetët të Kuvendit të Kosovës mendojnë dhe vlerësojnë se nuk ka pasur punë dhe performansë pozitive.

Uroj që në të ardhmen vërtetë të kemi një punë më të mirë, por edhe do ishte kërkesë e imja që kur të kemi raportime të agjencive të cilat ne si Kuvend i kemi zgjedh në veçanti të drejtorëve që Kuvendi e zgjedh me votën e tyre, këtu prezent me qenë edhe vetë drejtorët. Mendoj që deputetët kanë shumë nevojë që edhe këto raporte por edhe për punën të cilën e kanë bërë njëvjeçare të raportojnë këtu para nesh, mos të kemi vetëm 30 faqe dokument të cilën e kanë kompletuar ata për një vjet punë dhe ajo të lexohet dhe pastaj të raportohet por të kemi vërtetë një transparencë edhe të punës më të madhe të këtyre drejtorëve të agjencive me qëllim që me e rritë performansën e këtyre agjencive dhe drejtorëve të cilët ata i udhëheqin. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Fisnik Ismajli.

FISNIK ISMAJLI: Faleminderit, kryesuese!

Unë nuk po dua me fol për cilësinë e raportit, edhe nuk po dua as me anashkalua memorialët tjerat por po dua në veçanti me fol për memorialin e Betejës së Koshares. T'u qenë se vetë kam qenë pjesë e asaj beteje edhe pse mua më së pakti më takon me fol t'u qenë se dy figurat më prominent këtu Rustem Berishën edhe Anton Qunin i kem deputet të dy partive tjera.

Arsyeja pse unë po flas është me tregua që Beteja e Koshares është mbi subjektet politike dhe gjithmonë ka mbet e tillë ashtu qysh ka qenë edhe lufta e saj. Edhe për fat të keq është memoriali i vetëm që ka qenë edhe ka mbet më i neglizhuar prej të gjitha memorialëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e t'u marrë parasysh për nga rëndësia e saj si betejë, t'u marrë parasysh që ka qenë një prej betejave më të lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, është shumë e padrejtë që është neglizhua për 16 vjet të plota reshtë.

Mua më ka gëzua fakti që Komisioni është zotu për me shtua buxhetin pikërisht për këtë memorial edhe po shpresoj që zotimi i tyre ka me dal i fjalës edhe pse 16 vjet e fundit ka pas premtime të shumta por puna ka qenë shumë e vogël, janë bërë disa punë të vogla, është rregullua rruga për me shkua deri te varrezat, janë mirëmbajtur varrezat, por kryesisht ka qenë punë e palodhshme e banorëve edhe ish-ushtarëve të betejës që jetojnë atje, të cilët prej vullnetit të mirë kanë punua shumë edhe e kanë mirëmbajtur edhe e kanë mbajtur në gjendje të mjaftueshme për me shkua së paku një herë në vjet ne edhe m'i i kujtua ata që janë..., por është shumë e padrejtë nëse vazhdojmë me neglizhua kështu, edhe shumë e padrejtë edhe ndaj atyre që janë sot të zhvarrosur edhe që po pritët të përfundojë ky memorial i cili po zvarritet pikërisht për mungesën e fondeve.

Prandaj, me përkrahje të plotë edhe me shpresë se keni mu zotua me e financua memorialin e me përfundua më në fund atë vend i cili me plotë meritë duhet ta ketë përkushtimin më të madh prej të gjitha memorialëve tjera të luftës çlirimtare, por shpresoj që edhe kryeministri i cili është zotua se ka me e përkrahë këtë punë e qon deri në fund. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Salihe Mustafa.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryesuese!

Të nderuar kolegë,

E kam analizuar me kujdes këtë shkresë të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës dhe mendoj se ky nuk është raport, por një kërkesë të cilën e ka përgatitur agjencia dhe e ka ngatërruar me raportin e punës të cilin është dashur të na ofrojnë neve sot si deputetë.

Në këtë shkresë janë përshkruar disa aktivitete që janë ndërmarrë në vitin e kaluar dhe në fund si aktivitet përshkruhet hartimi i planit për menaxhim të Kompleksit Memorial "Adem Jashari".

Është dashtë që së pari të hartohet plani i punës e pastaj të vazhdohet me përmbushje të atij plani.

Gjithashtu në planin e punës parashihen trajnimet e stafit, por së pari duhet të tregohet për punët e kryera nga stafi e mandej të vazhdohet me trajnime shtesë.

Dhe krejt ajo çka kuptova është se agjencia ka nevojë për zyra, për staf e tjera.

Andaj, të nderuar kërkoni nga ne, plotësimin e këtyre kërkesave të cilat besoj se do t'ua plotësojmë ne si Kuvend dhe mandej na sillni raportin e punës në Kuvend të cilin do ta diskutojmë. Përndryshe ky raport sot nuk plotëson kushtet për ta shqyrtuar.

Unë e kuptoj se agjencia është i pakonsoliduar, është agjencia i ri, por megjithatë me këtë staf ekzistues është dashur që sot të na raportojnë për punët e kryera me atë pak buxhet dhe me atë staf që e kanë.

Mendoj se kjo është fyerje ky raport që na është sjell neve sot si deputet. Ndoshta votën do ta japë për, për arsye të rëndësishme të kësaj agjencie për menaxhim të komplekseve memorialë por besoj që herën tjetër do ta kemi një raport me punët të cilët janë kryer. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Shaip Muja.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zonja kryesuese!

Unë jam anëtar i komisionit ku raportohet kjo agjencie, mirëpo jam i befasuar nga këndvështrimet që i bëhen raportit dhe ne e kemi kaluar pozitivisht që të aprovohet në seancë plenare ky raport dhe si i tillë duhet të pranohet, sepse shikuar nga këndvështrimi i leximit të problematikës edhe nga deputetët që folën do të thotë po thuaj se asnjëri nga deputetët nuk dha ndonjë propozim praktik përveç se ndonjë kozmetikë apo një hatër mbetje me menaxhimin e agjencisë.

Unë mendoj që agjencia nuk mund të gjejë persona më adaptë për ta menaxhuar se sa ka ky momental që është.

Mirëpo ne duhet të shohim cilat janë problemet tona. Një shoqëri e cila flet shumë për patriotizëm dhe për histori dhe për vuajtje e kulminacionin e vet të kurorëzimit e vë me këto institucione të cilat quhen memorialë dhe si të tilla jemi bartës ne në rolin e legjislativit, në përshkrimin e detyrave të punës, me ligjet që i kemi aprovua ne këtu në Kuvend dhe po ashtu ekzekutivi i cili është bartës i implementimit praktik së bashku me agjencinë.

Ne në këtë raport kemi vërejtur edhe mangësi të cilat ne i amnistojmë të gjithë kryetarët e komunave të cilët janë, momentalisht bartës të disa memorialëve ose përmendoreve të vogla por de fakto nuk mund një agjenci e cila duhet ta luajë rolin e politik bërësit e monitoruesit të punëve të kryetarëve të komunave ku shtrihen nëpër komuna.

Unë do isha shumë i befasuar sikur sot Kuvendi i Kosovës të kishte një propozim. Që të gjitha viktimat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, luftës më të re e cila është bërë në Republikën e Kosovës ta kenë një varrezë të përbashkët në hyrje të Prishtinës dhe çdo delegacion, i cili do të vijë nga jashtë mos të ketë ndonjë përshkrim anësorë por ta ketë një fotografi të qartë se ku ka ardhur dhe nëpërmjet saj mund ta kuptoj historinë pa biseduar fare edhe pa u munduar të diskutojë.

Prandaj, në punën me memorialët, përveç disa memorialëve, siç janë i Adem Jasharit dhe memorialët të cilët janë pak më specifike, është ardhur koha që të bisedohet në këtë parlament që

të gjitha varrezat të cilat janë në Republikën e Kosovës, të luftës së fundit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ta kenë një vend ku quhet varrezat e dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të radhitura sipas kategorisë.

Sa i përket problemit të financimit që është quajtur edhe problemeve të tjera, normalisht që në këtë raport duhet me përshkrua diçka edhe menaxhmenti apo kryetari i agjencisë dhe s'ka pasur mundësi çka të përshkruaj më shumë sepse edhe kështu nga deponimet që deputetët po thonë nuk duhet ta votojmë, ne duhet ta votojmë këtë sepse nuk po dimë si ta kundërshtojmë dhe nuk po dimë si t'i propozojmë që ajo agjenci të punojë më mirë dhe ajo agjenci të jetë shembull edhe për kulturën tonë të ardhshme edhe për forcimin e identitetit tonë kombëtarë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ismajl Kurteshi.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Deputetë të nderuar,

Nëse doni me e kuptua angazhimin e agjencisë dhe gjendjen e komplekseve memorialë në Kosovë, nuk keni nevojë me e lexua raportin por duhet të shkoni dhe t'i vizitoni komplekset memorialë, varrezat e dëshmorëve dhe përmendoret nëse arrini që nga thertë që një pjesë e tyre i kanë rrethuar balta dhe pamundësia për t'u ofruar, ju mund të afroheni afër tyre.

Mendoj që është koha e fundit që ky shtet e tani është angazhuar një agjenci bashkë edhe me komunat të investoj dhe t'i përfundojë dhe agjencia duhet të orientohet në tri çështje kryesore.

Të fillojë të angazhohet për fillimin e punëve në komplekset memorialë siç u përmend Kosharja, që të fillojnë dhe të përfundojnë. T'i përfundojë komplekset memorialë ose varrezat e dëshmorëve, të cilat kanë filluar para shumë viteve dhe kanë mbetur përgjysmë, siç janë për shembull varrezat e dëshmorëve në Gjilan dhe në shumë vende të tjera dhe të përkujdeset për secilën përmendore ose bust të dëshmorëve kudo qoftë në Kosovë, nëpërmjet mekanizmave që duhet t'i sigurojnë dhe natyrisht nëpërmjet buxhetit që do të duhej t'i ndajë ky Kuvend, sepse një pjesë e këtyre komplekseve, varrezave dhe përmendoreve janë vërtet në gjendje tepër të rëndë.

Ne mund ta bëjmë përgjegjësinë herë andej, herë këndej, po ajo përgjegjësi i takon institucioneve të këtij Kuvendi, kësaj Qeverie, kësaj agjencie dhe duhet patjetër që të ndërmerren hapa konkretë që kjo gjendje të ndryshojë përndryshe vërtet po del se më keq është që kemi filluar diçka të bëjmë e të mos i mirëmbajmë ato se sa po të mos i kishim filluar pa i krijuar kushtet e nevojshme të ndërtojmë e pastaj pjesë e plane të ndërtimit të këtyre komplekseve dhe të gjithë atyre që i përmenda duhet të jetë edhe angazhimi për mirëmbajtjen e tyre. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zonja nënkryetare!

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Edhe unë e kam shqyrtuar raportin e Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2014 dhe sinqerisht thamë është një raport që më së paku mund të quhet raport u tha edhe nga kolegët tanë që folën më herët.

Në faqen e parë të dytën kur ia nis me lexua edhe e sheh specifikat e agjencisë, unë mendoj që kjo është një tallje ose një fyerje për deputetët, sepse na tregon neve çfarë bën një agjenci të cilin e kemi themeluar vetë dhe e kemi punuar vetë në themelimin e kësaj, kështu që për mendimin tim kjo nuk është dashur të jetë fare pjesë e raportit të vitit 2014, sepse këtë e kemi ditë në vitin 2013 kur e kemi themeluar këtë agjenci, edhe e kemi votuar këtu në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Raporti më shumë i ngjan kërkesës për mbështetje financiare dhe akomodim se sa që e tregon qartë për punën që e ka bërë si agjenci, kur kemi parasysh gjendjen faktike në terren, të cilat gjendje që kanë një gjendje të tmerrshme të gjithë memorialët pothuajse me përjashtim të dy apo tri. Për mua është shumë e pakuptimtë që në këtë raport diku mes rreshtave lexova ku thotë i kemi mbjellë 59 fidanë në shenjë të përkujtimit të 59 të rënëve në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” dhe unë konsideroj që çdo fidanishte që ekziston në Kosovë po t’i thuash na i jep 59 fidanë se do t’i mbjellim për këtë rast asnjëherë nuk do të thotë jo, është një punë shumë e thjeshtë, është një punë shumë e vogël karshi rëndësisë së Kompleksit Memorial “Adem Jashari”, që është në Prekaz.

Pastaj është ana kronologjike e këtij raporti, këtu thuhet që kemi kryer këtë, këtë punë dhe pastaj në fund dikur raporton thotë e kemi bërë edhe planin e punës. Do të thotë punët kryhen para se të bëhet planifikimi i punëve, tani pastaj kur të bëhet planifikimi del që disa punë i kemi bërë gabim edhe duhet t’i kthehemi prej fillimit dhe gjithmonë puna në komplekse memorialë po mbetet në fillim dhe nuk po përfundon asnjëherë.

Unë e kam thënë edhe në një nga seancat paraprake, Kompleksi Memorial “Adem Jashari” nuk ka nevojë për bar, nuk ka nevojë për drurë për momentin, ajo që është emergjente dhe që duhet të bëhet është konservimi i shtëpive dhe thjesht unë kam frikë që Kosova do të humb një pjesë shumë të rëndësishme të historisë së saj nëse ne nuk marrim hapa konkretë për konservimin e këtyre shtëpive. Ajo çka më brengosë është që këto komplekse po fillohen dhe po mbeten përgjysmë ose thjesht po shkatërrohen fill pas përfundimit ose edhe pa përfunduar ende.

E kemi në një gjendje të mjerueshme Kompleksin Memorial në Morinë. Është një kompleks mbarë kombëtar i vetmi kompleks unik në Kosovë, i cili përmban emrat e të gjithë dëshmorëve të Republikës së Kosovës dhe ai është në gjendje të mjerueshme dhe është turpi ynë sa herë që ne kalojmë andej dhe sa herë që na bie ndërmend që ai kompleks ekziston.

Janë varrezat e dëshmorëve në Polac, obligim e kemi, ju kemi borxh atyre njerëzve, të cilët dhanë jetën për ne, e dhanë jetën për Kosovën, sepse thjesht ne nuk iu duhem asgjë dëshmorëve, dëshmorët janë ata që na duhen neve dhe duhet të na thërrasin në ndërgjegje se të kemi kujdes. Kam frikë, që nëpërkëmbja e historisë, nënçmimi që po iu bëhet dëshmorëve të vendit do të na kushtojë shumë rëndë dhe thjesht do të jemi përgjegjës para gjeneratave të reja.

Unë personalisht mendoj që duke i dhënë votën “për”, këtij raporti nuk do ta arrijmë efikasitetin e punës dhe thjesht nuk do të thotë rëndësia e komplekseve memorialë që na duhet patjetër ta votojmë këtë raport, unë besoj që atyre komplekseve do t’ju kontribuojmë dhe do t’ju bëjmë nder nëse vota jonë sot shkon kundër këtij raporti.

Prandaj, unë personalisht votën time do ta jap kundër, le ta marrë secili deputet në përgjegjësinë e tij se si do ta votojë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Salih Morina.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryesuese!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë nuk do të isha ndal shumë në raportin meqë u tha edhe nga parafolësit e tjerë që në raport më shumë janë paraqitur ankesa nga agjencia, do të thotë për mungesë zyre, mungesë stafi dhe çështje tjera, por ne duhet ta trajtojmë problemin e memorialëve dhe komplekseve në përgjithësi në nivel vendi.

Ne vitin e kaluar patëm hartuar ligjin dhe njëkohësisht patëm miratuar Ligjin për agjencinë dhe menaxhimin e kompleksëve memorialë dhe, në kuadër të kësaj, në kuadër të këtij ligji do të thotë patëm themeluar edhe zyrën e menaxhimit për komplekset memorialë që i raporton direkt Parlamentit të Kosovës.

Ne kemi pranuar një raport edhe vitin e kaluar, një raport i cili e ka pas jashtëzakonisht ankesa dhe ankesat kanë qenë kryesisht do të thotë nëpërmjet agjencisë dhe po ashtu Ministrisë së Planifikimit dhe Mjedisit Hapësinor. Pra, ende është problemi në aspektin e buxhetit në mes ministrisë dhe po ashtu mes kësaj agjencie, sepse kemi ende buxhet me të cilën menaxhon Ministria e Mjedisit dhe në anën tjetër agjencia ka kërkuar disa herë që këtë buxhet t'i bartet kësaj agjencie me të vetmin qëllim, sepse ky është bartës dhe përgjegjës edhe në kuadër të ligjit për menaxhimin edhe të buxhetit, njëkohësisht edhe për mirëmbajtjen dhe apo ndërtimin e shumë memorialëve me të cilët e kemi një numër jashtëzakonisht të madh.

Kush e ka ligjin e merr dhe e shikon në 27 komuna të Kosovës, do të thotë kemi një numër jashtëzakonisht të madh të memorialëve dhe të varrezave të dëshmorëve me të cilët kanë kërkuar komunat që të mirëmbahen dhe njëkohësisht të ndërtohen memorialë nëpër komuna të ndryshme dhe nëpër regjione me të cilat kanë ra dëshmorë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Prandaj, këtu e kemi një lojalizëm, sepse komunat në nivel vendi nuk kanë mundësi me buxhetin që e kanë nuk kanë mundësi që të merren me ndërtimin e memorialëve ato mund të merren me mirëmbajtjen e memorialëve, po në anën tjetër për ndërtimin e memorialëve kërkohet një buxhet jashtëzakonisht i madh si do të duhet të ndahet nga niveli qendror. Deri më tani ne e dimë mirëfilli që investimet kryesisht kanë shkuar në memorialin "Adem Jashari" dhe akoma po vazhdojnë të shkojnë dhe duhet të shkojnë, por u tha edhe nga parafolësit tjerë këtu që është edhe Beteja e Koshares, është njëra prej betejave më të rëndësishme e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me të cilën edhe në 16-vjetorin sivjet i cili u mbajt u kërkuar edhe nga familjarët, u kërkuar edhe nga institucionet e nivelit qendror që të investohet dhe të bëhet akoma më shumë për memorialin e Betejës së Koshares.

Ne duhet t'i trajtojmë në mënyrë të barabartë të gjithë memorialët, sepse dëshmorët janë të barabartë, nuk duhet bërë dallime dhe konsideroj që investimet duhet të bëhen në gjithë territorin e vendit, sepse është nevoja dhe momenti i fundit që pas 16 vjetëve, do të thotë kemi ende varreza të dëshmorëve, të cilat nuk janë në nivelin e duhur dhe po ashtu kërkoj edhe nga niveli

lokal, por njëkohësisht edhe nga niveli qendror dhe nga përgjegjësit në këtë rast nga agjencia që të bëjë më shumë dhe Parlamenti i Kosovës dhe ne si deputetë, qoftë në rishikimin e buxhetit, qoftë në planifikimin e buxhetit për vitin 2016, duhet të kemi parasysh që këta memorialë të fillojnë të ndërtohen, sepse pa mjete buxhetore është e pamundur që të ndërtohen.

Unë e kam edhe një kërkesë do të thotë deri në vitin 2013, në buxhetin e Ministrisë së Planifikimit Hapësinor ka qenë edhe memoriali i Presidentit Ibrahim Rugova, dhe siç duket për vitin 2015 nuk është dhe kjo duhet të ketë parasysh që ky memorial do të thotë e meriton që të ndërtohet dhe njëkohësisht ndahen buxhete shtesë për vitet që vijnë dhe kërkoj në këtë rast nga agjencia që në planifikimet dhe në kërkesat e veta buxhetore karshi memorialëve tjera që janë shumë të rëndësishme të kërkojë edhe për ndërtimin e memorialit Ibrahim Rugova. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Nisma”, fjalën e ka deputeti Zafir Berisha.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesuese!

Unë fola në emër të grupit, tash do të flas si deputetë. Thënë të drejtën, pas fjalëve të Shaip Mujës mendova që u kuptua çdo gjë, sido që të jetë kjo temë po mendoj se po keqpërdoret dhe unë kur fola, fola si deputet i Kosovës jo si deputet i mëhallëve dhe i provincave.

Si do që të jetë, për disa kolegë, unë po dua të them që ta ndajmë agjencinë prej Idrizit, sepse duke me u marrë me Idrizin, faktikisht kush nuk e di është Idriz Blaka dhe po mendoj që drejtori dhe agjencia janë dy çështje dhe kështu që të mos e shfrytëzojmë foltoren për ta sulmuar dikë në rast se edhe nuk kemi simpati, ndoshta për shkak të gjatësisë.

Si do që të jetë, unë po mendoj që ky Parlament ka miratuar raporte të agjencive që janë pjesë e krimit dhe korrupsionit dhe keqpërdorin miliona e miliona euro të qytetarëve të Kosovës dhe një agjenci me shuma simbolike të sulmohet kështu, unë po mendoj që nuk është korrekte, kështu që siç i keni miratuar raportet e disa agjencive, është mirë ta miratojmë këtë raport, me vërejtjet dhe sugjerime në vijnë e asaj, edhe njëherë po e përsëris që tha Shaipi dhe kështu që të japim mundësinë që edhe një muaj në rishikim buxhetit kjo agjenci, a po vazhdon të ketë plane dhe projekte.

Si do që të jetë, po rikthehem - agjencia është për memorialët e gjithë Kosovës, por jo me provinca kështu, siç po tentohet këtu nganjëherë të paraqitet. Faleminderit!

KRYESUESJA: Dy minuta replikë, deputeti!

SHAIP MUJA: Faleminderit, i nderuar deputet Berisha,

Jo me dëshirë po asnjë nga ne këtu nuk u merr me zotin Blakaj e as me gjatësinë e tij, u morëm me trajtimin e këtij raporti dhe ky koalicion qeverisës dhe këta deputetë këtu i kanë shumicën e votave për ta shkarkuar zotin Blakaj sipas nenit 7, Ligjit për ... po shihet që s’e keni lexuar ligjin fare.

Se po ta kishe lexuar ligjin e kishe kuptuar që s’e kemi qëllimin kundër Idrizit, por qëllimin e kemi me i mbrojt edhe me i ruajt komplekset memorialë, të cilat janë në gjendje të mjerueshme,

e thanë edhe deputetët e të gjitha partive politike. Nuk është mirë që në emër të atyre që kanë ra me ua marr votën për një punë, nëse e ka zgjedhur zoti Blakaj që ju tani e mbron dhe do të duhet ta mbron për ta marrë votën për këtë raport duhet marrë për shkak të punës së tij, jo në emër të atyre që kanë vdekur, as në emër të një mëhale, s'jemi këtu për të mbrojtur as mëhalla e as lagje, por anekënd Kosovës komplekset memorialë janë në gjendje të rëndë.

Ne duhet të mendojmë edhe një fakt, zoti Berisha, a do të ishte mirë ndoshta që këtë agjenci ta trajtojnë te Ministria e Kulturës, për arsye se është një trashëgimi kulturore edhe kjo dhe ne kemi bërë edhe Ligj për trashëgimin kulturore edhe ligjet tjera. Prandaj, është mirë të mendohet në aspektin nacional, e jo në aspektin partiak. Faleminderit!

KRYESUESJA: Një minutë, kundër-replikë!

ZAFIR BERISHA: Zoti deputet, edhe pse s'e përmende emrin, sido që të jetë ju vetë me reagimin treguat se vërtet është aty ku unë e nxora në dritë këtë, pak rëndësi ka a kam lexuar ligjin apo jo, sa ka rëndësi se ju dilni të reagoni edhe nuk dini çka kërkon.

Ju keni qenë deputet në legjislaturën e kaluar dhe a duhet me qenë në ministri është dashur me kohë për të menduar. Por, unë po mendo që njerëzit, të cilët nuk ju përshtaten në momente të caktuar faktikisht po sulmohen edhe unë Idrizin e njoh më pak se ju, por sido që të jetë unë nuk po llogaris korrekte reagimin e veçanërisht të deputetëve të Partisë Demokratike.

Ademi mund të thotë ashtu qysh po e luan kryet, por sido që të jetë unë po mendoj që ky Parlament ka agjenci të tjera, të cilat duhet...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Fjalën e ka deputeti Rustem Berisha.

RRUSTEM BERISHA: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Kosovës,

Sa i përket raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë ne dëgjuam shumë kolegë tanë që biseduan në lidhje me këtë dhe këtu u ngritën disa pyetje a duhet të ekzistojë kjo agjenci për menaxhimin e komplekseve. Unë mendoj që kjo agjenci duhet të ekzistojë, por kjo agjenci ballafaqohet me shumë sfida, me shumë probleme në radhë të parë ka të bëjë me ndërtimin e kompleksit memorial dhe menaxhimin e tyre edhe pas ndërtimit.

Sa i përket unë nuk do të lidhem për individë të caktuar, por mendoj që kjo agjenci kam pasur rastin t'i takoj gjatë problemeve me të cilat janë ballafaquar për kompleksin memorial të Betejës së Koshares, është një problem që kjo agjenci është themeluar në vitin 2013, ndërsa rregullimi apo ndërtimi i shumë komplekseve kanë filluar shumë më herët edhe nuk janë bartë me kohë tek kjo agjenci.

Megjithatë, unë e di që Kompleksi Memorial i Betejës së Koshares tani veç është bartë te Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë dhe nëse duam që vërtet ky komision ta

kryejë punën e vet ashtu si duhet, atëherë patjetër që institucionet e Kosovës duhet ta përkrahin jo me fjalë, por edhe në aspektin financiar.

E marr konkretisht problemin e Koshares, në rast se institucionet e Kosovës mendojnë që me 200 mijë euro që i kanë ndarë për ta rregulluar atë kompleks është shumë problem, sepse dinamikat janë të tilla të ngadalshme, kompleksi është diku 4 milionë e 180 mijë euro edhe nëse vazhdojmë me këtë dinamikë të punimeve, atëherë sigurisht se na duhen diku rreth 20 vjet që të përfundohet ky kompleks.

Pra, duhet institucionet e Kosovës që ta përkrahin, ta mbështetin dhe besoj që jo vetëm kompleksi memorial i Koshares, por të gjitha varrezat e dëshmorëve duhet të rregullohen edhe duhet të mbështeten edhe të menaxhohen edhe pas ndërtimit të këtyre komplekseve. Unë jam më se i bindur se sa i përket folën edhe bashkëluftëtarët e mi për Betejën e Koshares, institucionet e Kosovës, kryeministri kanë qenë në kohën kur janë zhvilluar manifestimet “Ditët e Shqipes” dhe ata e kanë dhënë premtimin publik që do t’i gjejnë format dhe do ta rregullojnë këtë kompleks memorial.

Unë shpresoj se kjo do të rregullohet. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Deputeti Shaip Muja 2 minuta replikë deputetit Zafir Berisha.

SHAIP MUJA: Të falënderoj, unë e falënderoj edhe zotin Zafir që më përkrah në prononcimin tim, sepse siç del unë kam qenë më i lexuar në raportin edhe në konkludimet që i dhashë, ndërsa nga deputetët e Partisë Demokratike një pjesë, të cilët vërtetë po e shprehin atë që janë më të interesuar me e ndërruar Idriz Blakën se sa me e ndërruar situatën, ne nuk mund të japim vota kundër, sepse vetë Partia Demokratike nëpërmjet përfaqësueses së saj tha ne e përkrahin ligjin, dhe tash po dalin 2-3 individ për interesa personale ndoshta, po thonë që ta ndërrojnë.

Unë ju sugjeroj deputetëve që ne të flasim për rolin e agjencisë, për problemet e agjencisë, është agjenci e ri dhe nuk është problem menaxhimi sa është përmbajtja e agjencisë, ne e kemi diskutuar këtu në këtë Parlament dhe kam thënë për Zotin, për varrezat e Koshares që është bërë zoti Berisha si gjenerali i ushtrisë së vdekur, duke kërkuar vetëm në kokë në vete për t’i bërë ato varreza, ato nuk janë vetëm varreza të zotit Berisha, janë të gjithë Kosovës, prandaj ne duhet ta ngremë nivelin edhe të udhëheqjes komunale, por edhe të përgjegjësisë legjislative që e kemi ne edhe asaj ekzekutive që është Qeveria, e cila flet kur i nevojiten votat, por nuk flet kur duhet veprimi. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Salih Salihu.

SALIH SALIHU: Përshëndetje kryesuese!

Të nderuar kolegë,

Unë po flas nga ajo që nga raporti dhe nga prezantimi që bëri drejtori i komplekseve memorialë të Kosovës, aty u pa që kjo agjenci është ende larg dhe e ka të pamundur, thuajse t’i menaxhojë të gjitha kompleksat memorialë në Kosovë.

Prandaj, edhe aty diskutuam në komision, por edhe këtu konsideroj se është më se e nevojshme që të ndahen apo të specifikohen punët se çka duhet të kryejë për shembull agjencia dhe çka duhet të kryejë komuna.

Konsideroj se janë disa punë për shembull aspekti i mirëmbajtjes së pastërtisë duhet të jetë punë e komunës për shembull prerja e barit dhe largimi i pluhurit, dhe unë mendoj që komuna, çdo komunë duhet ta ketë një person një individ që përkujdeset edhe për komplekset memorialë, por edhe për bustet dhe shtatoret në qytete, ndërkaq për mirëmbajtjen e komplekseve në aspektin e dëmtimeve, për shembull të pjesëve të forta qysh është për shembull pllakat apo shtatoret, apo edhe bustet, mendoj se duhet të ketë përgjegjësi thjesht e agjencisë dhe sigurisht agjencia ka përgjegjësi edhe nëse ka punime shtesë apo edhe nëse duhet të ngrihen thjesht punime të reja.

Prandaj, këtu në bazë të kapaciteteve që i kishte agjencia dhe në bazë të financave duket se janë shumë larg dhe për një periudhë shumë të shpejtë nuk kanë mundësi këtë me bë, konsideroj se një pjesë të përgjegjësi duhet ta marrin komunat dhe vetëm përmes angazhimit të një individi në komunë ka mundësi që përkohësisht për 2-3 vjet kjo të menaxhohet, sepse nuk është mirë që bustet, shtatoret edhe komplekset të mbulohen me pluhur dhe me bari dhe të pritët derisa agjencia të shtrihet në tërë Kosovën. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: po janë vetëm një dy fjalë desha t'i them për këtë çështje, unë pajtohem që varrezat e dëshmorëve janë keq, nuk janë shumë mirë në kuptimin e asaj të përgjegjësisë të institucioneve se si do të duhej të dukeshin ato dhe përkujdesjes së vazhdueshme.

Unë pajtohem po ashtu se te disa prej tyre ka edhe thera, mirëpo po ashtu e di shumë mirë që këto thera nuk janë të djeshme. Por, janë prej vitit 2001, dhe para vitit 2013 kur memorialët ishin drejtpërdrejtë nën patronatin e kryeministrit nuk kam dëgjuar prej deputetëve të pushtetit bash asnjë kritik serioze deri atëherë për varrezat e dëshmorëve. Tash që drejtori i agjencisë mund të mos ketë qëlluar shok i tyre, po dëgjoj kritikën më të ashpra. Tash s'pe di a është shqetësimi më kryesor bash te varrezat e dëshmorëve apo tjetërkund.

Mirëpo, sipas kësaj logjike me këtë logjikë unë nuk pajtohem, po i bie që dëshmorët do të prehen në dheun e dashur të Republikës së Kosovës vetëm atëherë kur drejtori i agjencisë është edhe njeriu ynë.

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Faton Topalli.

FATON TOPALLI: Unë po vazhdoj aty ku e la Glauku. Është mirë që edhe qytetarët ta dinë që drejtori i tanishëm i agjencisë ishte edhe kryetar i PDK-së në Istog, i gjithë ky mllef kundër tij si duket ka të bëjë me faktin që nuk është më në PDK.

Ky diskutim i cili po zhvillohet sot po ma kujton diskutimin i cili është bërë para një viti, ku ka qenë pak a shumë diskutim i njëjtë. Unë e kam këtu referatin që kam mbajtur para një viti dhe dua të theksoj disa çështje që po thuhën edhe sot: në arsyetimin e këtij raporti drejtori thotë që ka

mungesë të hapësirave për punë, mungesë stafit, mungesë të vullnetit të ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, mungesë të automjeteve, mungesë të buxhetit.

Por, të gjitha këto ai fajëson Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë. Raporti sjell një varg faktesh që dëshmojnë mungesën e vullnetit të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, për të bërë të mundshëm punën e agjencisë. Faktikisht ministria, faktikisht pushteti i atëhershëm e ka penguar agjencinë ta kryejë punën e tij duke ia ndarë herë 3 milionë, herë 1 milion, duke mos ia caktua personelin i cili është dashur të kalojë në agjenci nga ministria një varg problemesh tjera, të cilat datojnë nga ajo kohë.

Pra, ky diskutim nuk po zhvillohet për varrezat, nuk po diskutohet për dëshmorët, nuk po bëhet për memorialët, por thjesht për ta sulmuar një drejtues të këtij institucioni i cili tashmë nuk është në PDK.

Zoti Muja i përmendi propozimet konkrete, unë dua t'i përkujtoj atij disa propozime që i kam bërë pikërisht kur kemi diskutuar për këtë raport. Kam kërkuar si vijon: të themelohet një komisioni i Kuvendit, i cili do ta hetojë situatën dhe t'i sqarojë Kuvendit cila është e vërteta rreth situatës së krijuar. Të sqarojë dhe konkretizojë se cilat janë përgjegjësitë e Ministrisë së Financave, Ministrisë për Planifikim Hapësinor, dhe drejtorit të agjencisë për dështimet në themelimin dhe funksionalizimin e agjencisë. Të sqarojë çështjen e akuzave të ndërsjella për korrupsion, sepse drejtori akuzon Ministrinë e atëhershme për korrupsion, komisioni t'i raportojë Kuvendit dhe të kërkojë përgjegjësi nga institucioni relevant varësisht nga përgjegjësitë që mban.

Pra, ky Kuvend nuk ka qenë i interesuar as atëherë ta sqarojë këtë çështje, e nuk është i interesuar as tani.

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zonja kryesuese!

Kolegë deputetë,

Është e vërtetë që sa herë të diskutohet për këtë temë kalon fatkeqësisht në banalitet.

Edhe pse ne duhet të jemi shumë të kujdesshëm edhe jo veç me fraza politike, por me punën tonë e që realisht nuk ka ndodhë hala kjo gjë dhe s'është ka donë me ndodhë. Mua po më befasoni sot që të gjithë që politizohet kjo çështje në këtë mënyrë, kur ne të gjithë e dimë që këtë agjenci e ka themeluar Kuvendi i Kosovës. Edhe si Kuvend i Kosovës çka kemi bërë na me përkrahë këtë agjenci dhe kjo agjenci me i dhënë rezultatet e veta të cilat i takojnë me ligj.

Këtu duhet të shtrohet pyetja dhe një gjë tjetër po më shqetëson ose po më befason për shembull në Komisionin e Buxhetit ne jemi të përfaqësuar nga të gjitha partitë politike, asnjë parti politike nuk ka thënë që duhet shkarkuar, larguar apo të mos e aprovojë këtë raport.

Të gjithë jeni pajtuar njëzëri që duhet me aprovuar këtë raport, edhe subjektet politike dalin përfaqësuese, e japin mbështetje, pastaj dalim na herë njëri herë tjetri, jo ky po jo ai. Po kjo është krejtësisht e papranueshme një, dhe e dyta unë mendoj që ne duhet të mbajmë urgjentisht përgjegjësitë tona, kjo agjenci e ka menaxhuar ekskluzivisht vetëm një projekt. E ne duhet të

punojmë që kjo agjenci të funksionojë, t'i kryejë punët e veta për të gjitha projektet ose duhet ta shuajmë. Kjo është esenca dhe s'kemi nevojë këtu kush është më patriot e kush donë më shumë me bë, me i ndërtuar këta memorialë e kush nuk do se ne dimë çka u bë deri sot edhe pse nuk u bë e pse u bë, urgjentisht duhet të punojmë sidomos me projektin e Kompleksit memorial të Koshares, sepse këtu u fol për shumë komplekse por një gjë duhet ta dimë, dëshmorët e Koshares janë jashtë dheut dhe këtë duhet urgjentisht të punojmë dhe të fillojmë projektin e të kryejmë, sepse nuk pret dhe natyrisht siç çdo punë edhe këtyre punëve duhet me iu dhënë prioritet, prioritet është Kosharja, duhet të kryhet këtë vit dhe vitin tjetër. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Daut Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: Më fal, kryesuese, po më duket që edhe u konsumua ajo që pata në plan ta them, domethënë pikërisht drejtorin e agjencisë e kemi zgjedhur këtu në këtë Kuvend, edhe arsyeja pse është heq kjo agjenci prej Ministrisë së Planifikimit Hapësinor, ka qenë pikërisht arsyeja se siç e thash edhe më herët pikërisht në këtë Kuvend janë përfaqësim i gjithanshëm, i të gjitha partive politike.

Ndërsa, për gjeneralët e ushtrisë së vdekur duhet të kemi kujdes doktor vdekjet kur flasim, domethënë duhet të përmbahen fjalët për shkak se nuk ka nevojë kurrkush me fye kërkon, jemi tu fol për një agjenci të cilën e ka krijuar Kuvendi, komisioni e ka rekomanduar për miratim, ndërsa neve vërejtjet që i japim shpresoj që agjencia do t'i merr në konsideratë dhe në të ardhmen do t'i trajtojë me seriozitet. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Dhe, diskutuesi i fundit për këtë pikë është deputeti Enver Hoti.

ENVER HOTI: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Unë mora fjalën dhe fillimisht duhet të them se do të ishte mirë që ne t'ju kërkojmë falje të gjithë familjarëve të dëshmorëve për gjendjen që është krijuar që 15 vjet në trajtimin e komplekseve dhe varrezave të dëshmorëve.

Po ashtu, do t'ju kërkojmë falje për debatin, i cili u zhvillua këtu në Kuvend lidhur me Raportin e Agjencisë për Mirëmbajtje të Komplekseve Memorialë dhe kërkoj që ne t'i lëmë fjalët dhe më shumë ta mbështesim këtë agjenci, Kuvendi dhe Qeveria, si dhe të ngrihet një bashkëpunim ndërmjet Komunës, mes Ministrisë për Planifikim Hapësinor dhe detyrat dhe funksionet që e presin këtë agjenci të kryhen me kohë dhe mos të merren me këtë gjendje e cila është deputetët duke i vajtuar gjendjen thuaja mbi 10 vjeçare të këtyre memorialëve, por t'i përvishemi punës dhe të punojmë në mirëmbajtjen e tyre, në ngritjen e tyre ashtu siç e meritojnë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Meqë nuk kemi kuorum për të votuar, fjalën e ka deputeti Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Ne është e vërtetë që po diskutojmë për një raport të një institucioni që e kemi themeluar vetë, që e kemi debatuar gjerë e gjatë para themelimit të tij dhe së fundi është vendimi i këtij institucioni që kemi ardhur në përfundim se është në interes të mbrojtjes së këtyre memorialëve, për kujdesjes së tyre, ta kemi një agjenci të pavarur.

Absolutisht asnjëherë Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike nuk e ka diskutuar se kush do të jetë udhëheqësi i këtij institucioni, përkundrazi i kemi dhënë mbështetjen, i japim mbështetjen edhe sot. Unë e shpreh keqardhjen time që nuk e di diçka, diçka që ka mbet pa u politizuar. Kur të janë në pyetje varrezat, dëshmorët, Partia Demokratike e Kosovës ka treguar gatishmërinë dhe gjithmonë ka dal jashtë vetvetes, sepse ata janë të pandashëm, ata i takojnë çdo qytetari të Republikës së Kosovës. Ka obligim çdo qytetarë i Republikës së Kosovës ta jap maksimumin e vetë që vërtetë ata të prehen ashtu siç e meritojnë.

Ne plotësisht jam dakord se varrezat e dëshmorëve dhe disa monumente janë në gjendje jo të mirë, por a mund ta fajësojmë ne këtë agjenci apo kryesuesin e kësaj agjencie, absolutisht unë nuk dëgjova shumë pak dëgjova që sa u bë fjalë a pyeti dikush sa i ka kushtet për të punuar dhe për t'i kryer vërtet detyrën e vet kjo agjenci. Po cilido prej nesh të kishte qenë absolutisht nuk do të kishte pas mundësi me e bë më shumë se sa ka bë tu e pas parasysh kushtet dhe mundësitë që i ka kjo agjenci.

Prandaj, nuk është mirë që vërtetë në vazhdimësi të fyhemi mes vete dhe të bëhet përpjeke që çdo gjë të politizohet. Unë nuk ua shoh për të madhe disave që vërtetë janë shumë vonë brenda këtu, nuk kanë informacionet, nuk kanë qenë në korrent të ngjarjeve, por janë shumë të tjerë që vërtetë kanë qenë në vazhdimësi dhe ata kanë argumente edhe dinë çka flasin. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Meqë nuk kemi kuorum për të votuar, mbase është mirë që të marrim tash pauzë apo doni të vazhdojmë me pikën tjetër.

Vazhdojmë me pikën tjetër? Në rregull, atëherë kalojmë te pika në pikën e shtatë:

7. Shqyrtimi i raportit të Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2014

Komisioni Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit e ka shqyrtuar raportin e Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2014 dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

Gjithashtu edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2014 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Nënkryetarja e Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, zonja Selville Halimi për arsyetimin e raportit me rekomandime.

SELVILLE HALIMI: Faleminderit, kryesuese!

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion në harmoni me Rregulloren e Punës së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur, më 28 prill 2015, e ka shqyrtuar raportin e punës të Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe i ka rekomanduar seancës së Kuvendit që të miratojë këtë raport të Institutit Gjyqësor të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, zonja Besa Gaxherri e ka fjalën.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zonja kryesuese!

Raporti vjetor financiar i Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2014, pasqyron të dhënat për buxhetin e miratuar dhe shpenzimet e buxhetit sipas kategorive dhe nënkategorive ekonomike, për vitin 2014, si dhe të dhënat për vitin 2013.

Instituti Gjyqësor të Kosovës për vitin 2014, nga buxheti i Kosovës i janë ndarë 652 mijë e 922 euro. Në bazë të vendimit të Qeverisë për zvogëlimin e kategorive të mallrave dhe shërbimeve dhe komunalive prej 15% janë shkurtuar mjetet buxhetore në vlerë prej 70 mijë e 377 euro. Dhe si rrjedhojë, buxheti përfundimtar i Institutit Gjyqësor të Kosovës ka qenë 597 mijë e 899,16 euro.

Nga kjo shumë janë shpenzuar 587 mijë e 438,80 euro apo 98,25% të buxhetit total. Komisioni për Buxhet dhe Financa në mbledhjen e mbajtur, më 13 maj 2015, pasi e shqyrtoi raportin vjetor financiar të Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2014 vlerësoi se raporti i përmbush obligimet ligjore për raportim që dalin nga Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe i rekomandon Kuvendit për miratim të raportit në fjalë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zonja Selvije Halimi.

SELVIJE HALIMI: Faleminderit, kryesuese!

Instituti Gjyqësor i Kosovës është institucion kryesor që nëpërmjet trajnimeve, përgatit kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë të vendit, për ushtrimin e kompetencave të tyre profesionale e ligjore në sistemin e drejtësisë. Raporti i Institutit Gjyqësor të Kosovës prezanton punën dhe angazhimin në këtë rrafsh, nga analiza e raportit shihen trajnimet e vazhdueshme në të gjitha lëmit e drejtësisë, si: penale, civile, administrative, drejtësia për të mitur, kushtetutë, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të drejtë ndërkombëtare, të drejtë të Bashkimit Evropian, etj.

Gjithashtu, raporti përmban edhe sfidat me të cilat është përballur Instituti Gjyqësor i Kosovës gjatë vitit raportues, do të thotë gjatë vitit 2014, që janë rritja e nevojës për trajnime të vazhdueshme dhe ka pasur probleme pastaj buxhetore, sepse kemi pasur një disproporcion mes rritjes së nevojës për trajnime dhe buxhetit të ndarë, sfidë kjo e cila është tejkaluar me ndihmën e donacioneve të donatorëve.

Pastaj, nevoja për staf të shtuar, si dhe vështirësitë ligjore për shkak të mos harmonisë së Ligjit për gjykatat dhe Ligjit për prokurorin e shtetit me Ligjin e institutit gjyqësor të Kosovës. Meqë këto dy ligje tanimë janë në lexim të dytë dhe janë duke u amandamentuar unë mendoj që do të tejkalohet edhe kjo sfidë sa i përket harmonisë së ligjeve.

Duke parë që Instituti Gjyqësor i Kosovës në raportin e paraqitur për vitin 2014, ka kryer punën e vetë konform ligjit dhe udhëzimeve të nxjerra për këtë çështje, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e përkrah Raportin e Institutit Gjyqësor të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlament të LDK-së, deputeti Agim Ademaj e ka fjalën.

AGIM ADEMAJ: Faleminderit, kryesuese!

Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së ka shqyrtuar raportin e punës për vitin 2014, të Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe mendojmë që është një raport i punuar mirë, i plotëson të gjitha standardet e një raporti ku janë prezantuar të dhëna të sakta statistikore për punën e këtij instituti që u tha, që kryesisht ka të bëjë me trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe Grupi Parlamentar i LDK-së do ta përkrah këtë raport vjetor të punës. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, deputeti Faton Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryesuese!

Të nderuar deputetë,

Sa herë që vjen fundi i marsit agjencitë, organet e pavarura janë në vllug të punës për t'i përfunduar raportet vjetore dhe për t'i prezantuar ato Kuvendit.

Raporti i Institutit Gjyqësor të Kosovës është një prej raporteve të tilla. Nuk mund të mos pranoj që raporti duket i bukur, i lidhur mirë, me shumë tabela dhe ngjyra, me shumë informacione dhe me përpjekje maksimale për të lënë përshtypje të mirë dhe kjo përshtypje e mirë nga ana fizike e tij është evidente dhe nuk mund të mohohet.

Ajo që zakonisht që raportet nuk e thonë drejtpërdrejtë është pjesa që nuk thuhet me fjalë, por megjithatë sjell një mesazh. Cili është mesazhi i këtij raporti? Mesazhi kryesor i raportit të Institutit Gjyqësor të Kosovës është që drejtuesit e shtetit nuk janë të interesuar të kemi prokurorë dhe gjyqtarë kompetentë dhe të përgatitur profesionalisht. Pse nuk janë të interesuar? Nuk janë të interesuar, sepse në një vend ku drejtësia është në krizë, në një vend ku sistemi gjyqësor konsiderohet i dështuar, një Qeveri e cila ka sinjerisht luftimin e krimit, vendosjen e drejtësisë dhe fuqizimin e shtetit, ndanë edhe mjetet e nevojshme që kjo detyrë të jetë e realizueshme.

Shuma e mjeteve që ka ndarë Qeveria e Kosovës për ngritjen e kompetencave të prokurorëve dhe gjyqtarëve është gjithsej 598 mijë euro, nëse kësaj shume i hiqen shpenzimet për rroga dhe disa shpenzime të tjera më të vogla mbesin gjithsej 392 mijë euro në funksion të luftës për vendosjen e drejtësisë në këtë vend.

Pra, janë pak fare pak mjete për të mos thënë kjo është vetëm një shumë simbolike, më shumë për të vendosur një standard ... të Bashkimit Evropian se sa për të vendosur një sistem në shërbim të kualifikimit të ... të drejtësisë.

Fakti që prej vitit 2011 deri në vitin 2014, pra për 4 vjet janë trajnuar 6 mijë e 401 prokurorë, gjyqtarë dhe kandidatë dhe megjithatë nuk kemi një sistem gjyqësor të pavarur, të paanshëm, efektiv, siç pretendon të ndikojë instituti gjyqësor sjell sinjalin e dytë, respektivisht pyetjen se a janë masat e ndërmarra efikase, sa po ndikojnë trajnimet në arritjen e efekteve, për të cilat pretendohet.

Kur e kemi parasysh situatën në terren, numrin e dosjeve të pazgjidhura, kapitullimin e prokurorëve dhe gjyqtarëve si shtylla kryesore të drejtësisë para krimit dhe... të korruptuar shtrohet me të drejtë pyetjen se cili është sukcesi i Institutit Gjyqësor në Kosovë. Në fakt, instituti nuk duhet fajësuar, sepse Qeveria me 392 mijë euro po bën sikur është e përkushtuar për kualitetin e drejtësisë, ndërsa detyrimisht instituti me kaq pak mjete edhe me 50% më pak hapësirë se sa i duhet, duhet të bëjë sikur po rrit kompetencat e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Dorën në zemër, edhe ky Kuvend me qasjen që ka ndaj raporteve të tilla, po bën sikur po mbështetë, po mbron interesat e qytetarëve dhe të shtetit, përndryshe do t'i shfrytëzonim këto raporte jo për të kritikuar përpiluesit e tyre, por për të kërkuar përgjegjësi para udhëheqjes së vendit për dështimet e krijuara.

Buxheti i vitit 2015, është buxhet i ish-kryeministrit edhe pse u aprovua edhe nga Lidhja Demokratike të Kosovës si buxhet i saj. Ftoj kryeministrin e ri që me rishikim të buxhetit të analizojë situatën dhe ta rrisë buxhetin për Institutin Gjyqësor të Kosovës për të bërë kualifikimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve me një kualitet më të mirë.

Karshi kësaj instituti duhet të ketë kritere të qarta, të cilat mundësojnë për të siguruar informacionet e nevojshme për kualitetin e kuadrit të shkolluar dhe sidomos për ndikimin e kualifikimit në ngritjen e kompetencave gjyqësore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Nëse vërtetë duam që të kemi një sistem gjyqësor të pavarur, të paanshëm, efikas dhe efektiv duhet që të krijojmë parakushte që kjo të jetë e mundshme, kjo nënkupton më shumë mjete për kualifikim, rroga më të larta për prokurorë dhe gjyqtarë dhe mbi të gjitha siguri për ta nga dhuna, shantazhet dhe kërcënimet që vijnë nga krimi dhe politika.

Lëvizja “Vetëvendosje” do ta votojë këtë raport, ndërsa pret nga Qeveria që të reflektojë dhe të ndërmarrë masa të nevojshme që Instituti Gjyqësor ta kryejë punën ashtu siç i takon me ligj.

KRYESUESJA: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, fjalën e ka deputeti Daut Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryesuese!

Në mungesë të zonjës Kadaj, edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës do t'i japë mbështetje këtij raporti të Institutit Gjyqësor të Kosovës, siç e tha edhe kolegu im paraprak shihet një përpunim i jashtëzakonshëm i këtij raporti, dhe meqenëse në komision ka pas një votim unanim edhe Aleanca do ta përkrahë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Nisma”, deputetja Shukrije Bytyqi e ka fjalën.

SHUKRIJE BYTYQI: Faleminderit, kryesuese!

Edhe Grupi Parlamentar “Nisma për Kosovën” e ka shqyrtuar Raportin e punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2014, vërtetë është një raport shumë i mirë, është një raport voluminoz, kërkojmë nga Qeveria e Kosovës që të rrisë buxhetin për këtë institut duke e ditur rëndësinë e këtij instituti.

“Nisma për Kosovën” e përkrah raportin e këtij instituti. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “6+” deputetja Duda Balje.

DUDA BALJE: Faleminderit! Parlamentarna grupa „6 + je“ izvršila razmatranje izveštaja Sudskog instituta Kosova za 2014. godinu i podržava isti.

KRYESUESJA: Faleminderit!

Meqë nuk janë lajmëruar të tjerë për diskutim dhe aktualisht nuk kemi kuorum për të votuar atëherë shkojmë për pauzë deri në ora 15:30. Ju kisha lut që ta respektoni kohën e pauzës dhe të jemi në sallë për të vazhduar me votimin.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes plenare pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Atëherë, po mendoj që kemi prit mjaft, gjysmë ore më shumë.

Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër, ministër i Qeverisë së Kosovës

Po fillojmë pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Interpelanca e kryeministrit të Kosovës, z. Isa Mustafa, për ushtrimin e kompetencave Kushtetuese lidhur me nenin 94 paragrafi 1, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës

Kryetarja e Grupit Parlamentar të AAK-së zonja Donika Kadaj-Bujupi e autorizuar nga Grupi Parlamentar i lëvizjes “Vetëvendosje” dhe Grupi Parlamentar “Nisma për Kosovën”, si dhe mbështetur nga 12 deputetë tjerë nënshkrues në bazë të nenit 44, të Rregullores së Kuvendit ka parashtruar kërkesë për të ftuar në interpelancë kryeministrin e Kosovës, zotin Isa Mustafa për ushtrimin e kompetencave kushtetuese lidhur me nenin 94, paragrafi 1, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Të nderuar zonja deputete dhe zotërinj deputetë,

Ju njoftoj se në bazë të Rregullores së Kuvendit interpelanca mund të zgjat deri në 3 orë, përfaqësuesi i interpelancës mban të drejtën e fillimit të debatit në kohëzgjatje deri në 10 minuta dhe në përmbyllje të debatit deri në 5 minuta, neni 44, pika 7 e Rregullores së Kuvendit.

Në bazë të nenit 44, pika 8 të Rregullores së Kuvendit, kryeministri Isa Mustafa paraqet dhe arsyeton qëndrimin e Qeverisë së Kosovës për çështjen e shtruar në interpelancën në kohëzgjatje prej 15 minutash.

Koha e ndarë për diskutim sipas grupeve parlamentare dhe deputetëve pa grup parlamentar është si në vijim: Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës me 35 deputetë ka 52.5 minuta, minus 6.5 minuta për kryeministrin, domethënë 46 minuta në dispozicion. Grupi Parlamentar i LDK-së ka 33 deputetë që do të thotë ka 49.5 minuta minus 6 minuta për kryeministrin që i bie të flas 43.5 minuta. Grupi Parlamentar “Vetëvendosje” ka 16 deputetë ka 24 minuta në dispozicion, Grupi Parlamentar i lëvizjes “Vetëvendosje” në cilësinë e përkrahësit të interpelancës i zbriten 1.5 minuta në fund të debatit për propozuesin e debatit deputeten Donika Kadaj-Bujupi.

Grupi Parlamentar i AAK-së, 9 deputetë 13.5 minuta, Grupi Parlamentar të AAK-së si propozuesi i interpelancës i zbriten 10 minuta në fillim, ndërsa 3.5 minuta në fund të debatit, ndërsa 1.5 minuta i merren nga Grupi Parlamentar i lëvizjes “Vetëvendosje” në cilësinë e përkrahësit të interpelancës. Grupi Parlamentar Lista serbe 10 deputetë, 15 minuta, minus 2 minuta për kryeministrin 13 minuta. Grupi Parlamentar “Nisma” 6 deputetë 9 minuta, Grupi Parlamentar “6+” 6 deputetë 9 minuta, minus 1 minutë për kryeministrin. Pa grup janë pesë deputetë, kanë 7.5 minuta.

Ftoj zonjën Donika Kadaj-Bujupi në cilësinë e propozuesit të interpelancës ta marrë fjalën 10 minuta.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Në bazë të nenit 65.9 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 44, paragrafit 1 të Rregullores së Punës së Kuvendit, në emër të lëvizjes “Vetëvendosje”, Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe “Nisma” thërrasim në interpelancë kryeministrin Mustafa për çështjen në vijim:

Përgjegjësinë e kryeministrit të Kosovës për ushtrimin e kompetencave kushtetuese lidhur me nenin 94, paragrafi 1, pika 3 e Kushtetutës së Kosovës. Arsytim: sipas nenit 94, paragrafit 1, pikës 2 dhe 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kryeministri ka detyrim ekskluziv kushtetues që të sigurojë se të gjitha ministratë veprojnë në pajtim me ligjet në fuqi, si dhe të politikave të përcaktuara të Qeverisë. Po ashtu, bazuar në aktin e brendshëm të Qeverisë Rregulloren 02/2011 për fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrave sipas nenit 6, paragrafi 3 dhe nën paragrafi 3.2 kryeministri është përgjegjës për kontrollin dhe bashkërendimin e punës së anëtarëve të Qeverisë në secilin institucion qeveritar.

Ministria e Drejtësisë si pjesë përbërëse e Qeverisë së Republikës së Kosovës, sipas nenit 18, paragrafit 1, nënparagrafit 1.1 të Rregullores 02/2011, në përputhje me nenin 9, këto kompetenca duhet t’i ushtrojë sipas përkufizimeve për përgjegjësit e ministrave të Qeverisë së Republikës së Kosovës të parashikuara në shtojcën 1, të fushave të përgjegjësisë të ministrave.

Referuar këtyre përgjegjësive kushtetuese dhe administrative gjendja faktike ku u përshkruhet këtyre problemeve të shkaktuara nga Kabineti qeveritar.

1. Krimi i organizuar deri më tani ka treguar që i ka mbijetuar organeve të drejtësisë në përgjithësi dhe po zhvillohet e mobilizohet çdo ditë pa u penguar nga aparati shtetëror i drejtuar nga ekzekutivi i vendit, madje sot veprimet e krimit të organizuar janë të pranishme brenda institucioneve duke i kontrolluar dhe nënshtruar ato për interesa vetjake.

Rasti që ilustron hapur këtë problem të rëndë është afera në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës. E gjithë shoqëria, po edhe ne si përfaqësues të tyre presim nga ky trup prokurorial ta përmbush misionin me të cilin është themeluar. Pra, të luftojë krimin e organizuar dhe veprat penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore. Rasti tjetër, po kaq i rëndë është ai që ndodhi në Gjykatën Themelore të Prishtinës, ku një gjyqtari ju vërtetua fajësia lidhur me transferimet pronësore meqë rast është bartur prona publike në pronësi private. Pikërisht, duke keqpërdorur funksionin e tij, por të njëjtit i shqiptohet vetëm dënimi me kusht.

2. Niveli i lartë i korrupsionit tashmë është përshkrimi që po e përkufizon Kosovën edhe ndërkombëtarisht. Po ashtu, ekziston edhe bindja e thellë tek qytetarët tonë, se korrupsioni ka prekur hierarkinë më të lartë të institucioneve shtetërore. Bindje e cila po vërtetohet çdo ditë e më shumë përballë mos reagimit serioz të Qeverisë ndaj kësaj gjendje.

Krahas asaj që kemi të krijuar mekanizma të shumtë për luftimin e korrupsionit, për shembull Këshilli Kombëtar për luftimin e korrupsionit, Agjencia Kundër Korrupsionit e deri te departamentet e veçanta të themeluara brenda prokurorisë së shtetit dhe Policia e Kosovës e ku më shumë po shpërfaqet lufta e klaneve brenda institucioneve publike se sa luftë kundër korrupsionit.

Kosova, të nderuar kolegë, çdo ditë shpenzon mjete nga buxheti i shtetit për procedurat e prokurimit publik në vlerë prej 400 milionë eurove. Pa llogaritur mjetet e ndërmarrjeve publike të tenderuara për mallra dhe shërbime të ndryshme. Në këtë cikël është stabilizuar tani një proces i detajuar korruptiv, ku operatorët ekonomik dëshmojnë për përjetimet e tyre dhe ku mbyllja e mijëra bizneseve flet se Kosova ka degraduar shumë në mungesë të sundimit të ligjit.

Në vazhdimësi, edhe me të gjitha lëvizjet e tjera të Kosovës drejt Bashkimit Evropian në Raportin e Progresit kërkohet që të kemi përmirësim sa i përket sundimit të ligjit. Kjo lidhet jo veç me funksionimin e brendshëm, por edhe me liberalizim të vizave edhe me realizimin e të drejtave të qytetarëve tonë, të cilat kryesisht nuk po ndodhin në mungesë të sundimit të ligjit.

Procesi i privatizimit është treguesi i ndërhyrjes dhe pranisë së korrupsionit dhe krimit të organizuar në institucionet publike. Nga rasti i kryetarit të AKP-së që u gjet i vdekur në zyrën e tij e deri tek rasti i drejtorit tjetër të dorëhequr brenda disa javësh tek privatizimi i “Ballkanit” në Therandë, “Llamkosit” në Vushtrri, lënies të papunë afër 76 mijë punëtorëve të ndërmarrjeve publike, dështimeve të qëllimshme të AKP-së sa i përket privatizimit me spin of special kanë vërtetuar se gjendja është alarmante sa i takon shtrirjes së veprimtarive korruptive dhe kriminale në çdo valë të privatizimit.

Të gjitha këto janë vërtetuar shumë herë, janë bërë shumë herë publike dhe përfshirjet e aktorëve të pushtetit ekzekutiv. Rasti i fundit që u bë publik është edhe përfshirja e ministrit të Drejtësisë, Hajredin Kuçi në procesin e ndërhyrjes për sabotimin e hetimeve lidhur me privatizimin e Fabrikës së Amortizatorëve në Prishtinë.

Kjo gjendje është e lidhur drejtpërdrejtë me ndikimet korruptive të pushtetit ekzekutiv në sistemin e drejtësisë dhe institucionalisht e lidhur me mungesën e mbështetjes së plotë ligjore kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Si pasojë, sot kemi dukurinë e pasurimeve shumë

të larta shpesh të deklaruara, e shpesh të padeklaruara të zyrtarëve të lartë shtetëror në kurriz të pasurisë publike dhe në kurriz të qytetarëve, të cilët çdo ditë e për më shumë po varfërohen.

Problemi thelbësor në këtë luftë fiktive kundër korrupsionit është mungesa totale e vullnetit politik nga kjo Qeveri aktuale që përfaqëson vazhdimësinë e asaj të së kaluarës, siç e tregon edhe veprimtaria e ministrit të Drejtësisë, i cili mbetet po i njëjti nga Qeveria e kaluar pavarësisht që performansa dhe rezultatet kanë qenë shumë të ulëta.

Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës neni 65, paragrafi 10 përcaktohet se Kuvendi zgjedh anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe të Këshillit Prokurorial të Kosovës në pajtim me këtë Kushtetutë. Edhe përkundër kësaj dispozite kushtetuese deri më tani anëtarët e këshillit prokuroria asnjëherë nuk janë zgjedhur nga Kuvendi.

Ministri i Drejtësisë është anëtari i Këshillit Prokurorial nga marrja e detyrës dhe deri më tash asnjëherë nuk ka marrë iniciativë apo deklarim publik për këtë çështje meqenëse ka qenë dhe është ende anëtarë i një organi kushtetues i cili ka përbërje kundër kushtetuese. Në vend të këtij reagimi të munguar prej vitesh ne kemi qenë dëshmitarë të skandaleve të shumta brendapërbrenda Këshillit Prokurorial ku emri i ministrit është në krye të listës.

Po ashtu, pjesëmarrja e kryesuesve të Këshillit Gjyqësor dhe atij Prokurorial në procesin e negociatave me Serbinë jashtë çdo autorizimi kushtetues dhe ligjor është tregues i qartë i kontrollit të agjendës së ekzekutivit nga organet e drejtësisë. Kryeministri duhet të na tregojë rolin e ministrit të Drejtësisë dhe korrespondencat në mes të Këshillit Prokurorial dhe Qeverisë për pjesëmarrjen e këshillit në këtë proces. Ministri i Drejtësisë, Hajredin Kuçi si anëtar i këtij këshilli ka dëshmuar ndërhyrjet e tij duke krijuar grupe për të cilat madje edhe publikisht vetë anëtarët kanë akuzuar njëri-tjetrin dhe i kanë quajtur publikisht si banda të brendshme në prokurorinë e shtetit.

Kjo qasje e ka paralizuar Këshillin Prokurorial për gati një vit në procesin e zgjedhjes së prokurorit dhe ky është një dëm i pallogaritshëm për Kosovën dhe për vetë sistemin e drejtësisë. Sipas shtojcës 1 të Rregullores për fushat e përgjegjësisë së Ministrisë së Drejtësisë është theksuar qartë që në kompetencë të saj është mbikëqyrja ekzekutive ndaj shërbimit korrektues të Republikës së Kosovës. Ky raporti i përgjegjësisë në mes të ministrit dhe drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit Korrektues ka qenë më shumë koordinues se sa përgjegjës. Deri më sot të gjithë kemi qenë dëshmitarë të skandaleve nëpër institucionet korrektuese, për të cilat ministri i Drejtësisë nuk e ka ushtruar kompetencën e tij për të marrë në përgjegjësi drejtuesin e gjithë sistemit, i cili përgjigjet drejtpërdrejt.

Në këtë rast, ministri Kuçi ka qenë i heshtur në pikëpamje të kontrollit ligjor. Më 10 shkurt 2015, u nënshkrua marrëveshja për drejtësi me Serbinë. Me anë të kësaj marrëveshje u shpërfill në mënyrë flagrante sistemi i brendshëm i drejtësisë në Kosovë. Me këtë marrëveshje u konfirmua që Kosova nuk ka sovranitet të brendshëm në aspektin e ushtrimit të pushtetit shtetëror në asnjërin prej pushteteve, madje as në atë gjyqësor.

Ministri i Drejtësisë është udhëheqës i grupit teknik për formimin e Gjykatës Speciale. Themelimi i kësaj gjykate cenon sovranitetin gjyqësor pasi që ai krijon një sistem paralel nga gjykatat themelore e deri tani...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Vazhdojani, le ta kryejë fjalën!

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Ajo krijon edhe një trup paralel të Avokatit të Popullit dhe Gjykatës Kushtetuese.

Ministri i Drejtësisë në raportimin para Komisionit për Legjislacion pat deklaruar se ky projektligj dhe amendamentet kushtetuese janë përgatitur nga Zyra e Komisionit të Bashkimit Evropian në Kosovë. Të njëjtat materiale ishin klasifikuar si konfidenciale pa asnjë kriter ligjor dhe këto materiale ishin dërguar anëtarëve të komisionit nga ana e ministrit të Drejtësisë, kurse vetë ministri Kuçi ka udhëhequr ekipin e ekspertëve për themelimin e Gjykatës Speciale.

Të nderuar kolegë,

Për të gjitha këto arsye të lartshënuara, Grupet Parlamentare, nga Lëvizja “Vetëvendosje”, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe “Nisma për Kosovën” i propozojnë Kuvendit të Kosovës për miratim këtë mocion përmbajtjesor. Në mbështetje të nenit 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 6.1 të Rregullores së punës së Kuvendit të Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës në seancën plenare të mbajtur, më 21.05.2015, miraton këtë rezolutë: 1. Kryeministri në përputhje me kompetencat kushtetuese nga neni 94, paragrafi 1, pikave 2 dhe 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës të shkarkojë ministrin e Drejtësisë, për shkak të mospërmbushjes së detyrave të dala nga neni 8, paragrafi 1 dhe neni 9, paragrafët 1 dhe 2 lidhur me shtojcën 1 të Rregullores Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive në bazë të përgjegjësisë individuale të anëtarëve të Qeverisë, siç është e përkufizuar në nenin 97, paragrafin 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani radha është e zotit Mustafa, por paraprakisht dua të ju them që minutazhin e kryeministrit nuk e kam ndërmend ta llogaris, as të parashtruesit të kërkesës, kështu që grupet i kanë minutat e veta. Faleminderit!

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Në cilësinë e kryeministrit të Republikës së Kosovës, më 13 maj 2015, kam pranuar mocionin për interpelancë, të parashtruar nga deputetja Donika Kadaj-Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe Grupit Parlamentar Nisma, e cila mban datën 7 maj 2015 dhe është mbështetur dhe nënshkruar nga 12 deputetë.

Siç rezulton nga objektivi i mocionit të parashtruar, unë si kryeministër i Republikës së Kosovës, jam i ftuar për interpelancë lidhur me përgjegjësinë e kryeministrit të Republikës së Kosovës për

ushtrimin e kompetencave kushtetuese lidhur me nenin 94, paragrafi 1, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Të drejtën dhe përgjegjësinë time për këtë interpelancë e realizoj në harmoni me nenin 44, pika 6 e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Duke respektuar secilin nga pretendimet e ngritura, por duke ndarë opinionin tim dhe të Qeverisë lidhur me konstatimet e paraqitura dhe adresimet, më lejoni që të jap qëndrimin tim si kryeministër, për secilën nga pikat e parashtruara në mocion, por para kësaj, po ashtu të jap qëndrimin lidhur me Rezolutën e propozuar.

Konsideroj se kërkesa për shkarkimin e ministrit të Drejtësisë Hajredin Kuçi, rezulton të jetë e padrejtë dhe e pabazuar, sepse asnjë ministër, deputet apo kushdo qoftë, nuk do të duhej të penalizohet për shkak të kryerjes së detyrës së tij në përputhje me ligjin dhe në përputhje me Kushtetutën dhe, këtë e ka bërë edhe zoti Kuçi.

Gjithë ajo që është prezantuar në këtë mocion për interpelancë flet për problemet dhe sfidat, me të cilat ne po ballafaqohemi, por nëse analizojmë më mirë këtë kërkesë, rezulton se është punuar shumë dhe po punohet shumë, rezulton se ka dallime konceptuale politike në vlerësimet e arritura dhe në vlerësimin e punës së ministrit Kuçi.

Si kryeministër i vendit konsideroj, se nëse duhet të aprovohet Rezoluta për këtë interpelancë, atëherë me këtë Rezolutë ne duhet të vlerësojmë të arriturat në forcimin e shtetit ligjor, luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe në ushtrimin e drejtësisë në tërë vendin, për çfarë merita të veçanta, sipas përgjegjësisë së tij, ka ministri i Drejtësisë, Hajredin Kuçi.

Sa u përket pikave konkrete të cilat janë dhënë, pika A - duke analizuar këtë pikë të mocionit të parashtruar, në mes tjerash, vërejmë se është paraqitur se krimi i organizuar deri më tani ka treguar se u ka mbijetuar organeve të drejtësisë në përgjithësi dhe po zhvillohet e mobilizohet çdo ditë, pa u penguar nga aparati shtetëror, i drejtuar nga ekzekutivi i vendit.

Më tutje, parashtrohet po ashtu, se veprimet e krimit të organizuar janë të pranishme sot edhe brenda institucioneve duke i kontrolluar dhe nënshtruar ato për interesa vetjake. Në ilustrim të kësaj, në mocion është përmendur edhe rasti i ish-prokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, i cili është gjetur fajtor për shpërdorim të pozitës zyrtare nga një panel gjyqësor i udhëhequr nga misioni EULEX, si dhe rasti i një gjyqtari të Gjykatës Themelore në Prishtinë, i cili po ashtu është gjetur fajtor nga një panel gjyqtarësh, udhëhequr nga misioni i EULEX-it, por, për aq sa unë jam në dijeni, ky i fundit akoma nuk është përfunduar me aktgjykim të formës së prerë.

Nga arsyetimi i përgjithshëm i dhënë në këtë pikë të mocionit, rezulton se për dështimet në luftën kundër krimit të organizuar është fajësuar direkt vetëm ministri, përkatësisht ministri Drejtësisë, zoti Kuçi. Ndërkaq, në bazë të parashtruesve të interpelancës rezulton se janë ndërmarrë masa, jo vetëm nga ministri, sepse ministri nuk gjykon dhe nuk ndan drejtësi, por nga organet e drejtësisë, përkatësisht nga Prokuroria e shtetit, nga EULEX-i dhe nga gjykata.

Prandaj, për të arritur objektivat për të cilën gjë deputetët angazhohen në këtë mocion dhe për të përmbushur këto detyrime, gjykoj se Republika e Kosovës ka siguruar një infrastrukturë të avancuar ligjore dhe, se këtë infrastrukturë e ka ndërtuar në bazë të kontributit të veçantë të Ministrisë së Drejtësisë dhe zotit Kuçi dhe, se institucionet e pavarura sot janë në gjendje shumë më të mirë për zbatimin e drejtësisë në tërë Republikën e Kosovës.

Prandaj, mbetet detyrim i secilit prej nesh, që të denoncojmë tek organet e pavarura të drejtësisë çdo pretendim për shkelje të ligjit, pavarësisht se kush është subjekt dhe cilës shtresë të shoqërisë i takon. Ndërsa, po aq detyrim mbetet edhe për organet e drejtësisë, që me përkushtim dhe në kuadër të ligjit të hetojnë dhe luftojnë çdo dukuri negative në Republikën e Kosovës.

Lidhur me arsyetimin e pikës B të mocionit, ku në mes tjerash, është parashtruar, si nivel i lartë i korrupsionit tashmë është formë e përshkrimit, që po përkufizon Kosovën dhe ndërkombëtarisht, duke shtuar se ekziston edhe bindja e thellë tek qytetarët e Kosovës, se korrupsioni ka prekur hierarkinë më të lartë institucionale shtetërore, më lejoni të shpreh mospajtimin tim në konstatimin e paraqitur se Qeveria të cilën unë e drejtoj nuk ka reaguar në mënyrë serioze për të luftuar korrupsionin, si një dukuri që ka vazhduar të jetë e pranishme në forma të ndryshme dhe intensitet të ndryshëm, për vite të tëra.

Si Qeveri kemi ndërmarrë masa, që njerëzit e punësuar në ministri të caktuara, në atë të Infrastrukturës dhe në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ndaj të cilëve janë ngritur aktakuza, të suspendohen nga puna.

Kemi suspenduar tre zyrtarë të lartë të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe tre zyrtarë të lartë të Ministrisë së Infrastrukturës, përfshirë edhe dy shefat e prokurimeve në këto dy ministri.

Jemi po ashtu, në përfundim të përgatitjes së implementimit të prokurimit elektronik publik, të cilin do ta aplikojmë në vjeshtë të këtij viti, ndërkaq module të caktuara do të fillojmë t'i aplikojmë edhe tani.

Në mandatin e kësaj Qeverie që unë drejtoj, asnjëherë deri më tani nuk kam dëgjuar se dikush është ankuar, që si rezultat i mungesës së infrastrukturës ligjore janë shkaktuar pengesa në luftën kundër korrupsionit. Edhe unë si kryeministër i Republikës së Kosovës apeloj që të bëhet më shumë dhe të bëjmë më shumë, secili prej nesh, por në veçanti apeli im u drejtohet institucioneve të pavarura të drejtësisë, të cilat kanë për detyrim, që në përputhje me ligjin dhe kurdo që kanë dyshim të arsyeshëm, ta hetojnë secilin rast dhe çdo qytetar pa dallim.

Lidhur me pretendimin e paraqitur në pikën C, në arsyetim të këtij mocioni, si kryeministër nuk e kam asnjë informatë për ndërhyrjen e ministrit Kuçi në hetimet për Fabrikën e Amortizatorëve.

Kjo Qeveri, po ashtu, nuk zhvillon politika të vazhdimësisë, ashtu siç pretendohet të vlerësohet në fund të kësaj pike, por realizon përgjegjësinë për implementimin e programit qeverisës.

Pretendimet e paraqitura në pikën D të arsyetimit, rezultojnë të jenë pretendime për shkelje të ligjit dhe Kushtetutës lidhur me zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Më tutje, këtu parashtrohet po ashtu, se pjesëmarrja e kryesuesve të Këshillit Gjyqësor dhe të Këshillit Prokurorial të Kosovës në procesin e negociatave me Serbinë është tregues i qartë i kontrollit të agjendës së ekzekutivit ndaj organeve të drejtësisë.

Si kryeministër është kërkuar nga unë, që të tregoj rolin e ministrit të Drejtësisë dhe korrespondencat në mes të Këshillit Prokurorial dhe Qeverisë për pjesëmarrjen e Këshillit Prokurorial në këtë proces, me pretendim se ministri i Drejtësisë, zoti Kuçi si anëtar i Këshillit Prokurorial ka dëshmuar ndërhyrjen e tij, duke krijuar grupe për të cilat vetë anëtarët aktualë të Këshillit Prokurorial u quajtën publikisht si” banda të brendshme në Prokurorinë e Shtetit”.

Më lejoni, të parashtroj këtu, se pjesëmarrja e kryesuesit të Këshillit Prokurorial si pjesë e ekipit teknik në negociatat e zhvilluara me Serbinë, në këndvështrimin tim dhe të Qeverisë, jo vetëm se ka qenë e drejtë dhe e ligjshme, por njëkohësisht edhe e domosdoshme për t’u siguruar se marrëveshjet që arrihen dhe detyrimet, të cilat dalin nga këto marrëveshje janë të ligjshme dhe të zbatueshme edhe për Prokurorinë e shtetit si institucion i pavarur.

Unë si kryeministër do të përmbahesha nga komentimi i pretendimeve për parregullsinë e punës së Këshillit Prokurorial, sepse Këshilli Prokurorial është një organ kushtetues tejet i pavarur dhe fakti, që ministri i Drejtësisë është pjesë e këtij Këshilli, nuk na jep të drejtën e ndërhyrjes në mënyrën e organizimit të punës së këtij Këshilli.

Pas një periudhe të gjatë kohore tashmë kemi kryeprokurorin e shtetit dhe puna e Këshillit Prokurorial është duke vijuar pa ndonjë ndërhyrje dhe apeloj që të përmbahemi nga ndërhyrje të tilla. Ndryshimet e Ligjit mbi Prokurorinë e shtetit të prezantuara në seancën e kaluar të Kuvendit nga vetë ministri Kuçi, mendoj se rregullohet plotësisht zgjedhja e Këshillit Prokurorial, ashtu siç është paraparë me Kushtetutë.

Sa u përket pretendimeve të paraqitura në pikën E të këtij mocioni, më lejoni të theksoj se problemet me sistemin penitenciar kanë qenë evidente për një kohë të gjatë në Republikën e Kosovës, por janë trajtuar me seriozitet më të madh nga dita e marrjes së përgjegjësisë për të udhëhequr Qeverinë e Republikës së Kosovës.

As ministri i Drejtësisë dhe as unë si kryeministër dhe, asnjë nga Kabineti qeveritar nuk jemi të veshur me imunitet absolut, për t’u mbrojtur nga ligji, por të gjithë ne e gëzojmë të drejtën që të mbrohemi nga spekulimet, nga insinuatat dhe nga pretendimet me qëllim të hakmarrjes për punën që e bëjmë apo për punën, që një individ e kryen.

Sa u përket pretendimeve të parastruara në pikën F, rezulton se përveç dallimeve konceptuale politike, parashtrohet edhe se është cenuar Kushtetuta e Republikës së Kosovës, duke dëmtuar rëndë sistemin e drejtësisë dhe të respektimit të vlerave universale të drejtave të njeriut.

Ky Kuvend është njoftuar me Marrëveshjen për drejtësi dhe ai nuk i ka dhënë vlerësimin që i japin parashtruesit e kësaj kërke, kësaj marrëveshjeje. Vlerësoj se është një marrëveshje shumë e dobishme, prandaj puna e ekipit tonë dhe ministrit Kuçi, që ka aplikuar punë ekipore në bisedat për një kohë të gjatë lidhur me këtë çështje, është punë e suksesshme.

Ne duhet t'i gëzohemi që kemi arritur të ushtrojmë ligjet e Kosovës në tërë territorin e vendit e jo të kërkojmë përgjegjësi nga ata që punuan më së shumti për këtë.

Kuvendi i Republikës së Kosovës mund t'i trajtojë me gjuhë politike këto pretendime, por për bindjen time, gjuha kushtetuese dhe gjuha ligjore është ajo çfarë duhet t'i japë sqarim secilës nga këto pretendime.

Sa u përket pretendimeve për Ligjin e amnistisë, më lejoni t'ua rikujtoj se ky ligj ishte kaluar dhe votuar në kohën kur ne nuk ishim në krye të Qeverisë. Por, megjithatë shumë nga ne këtu ishim deklaruar pro këtij ligji dhe, si rezultat i këtij deklarimi, u miratua dhe hyri në fuqi Ligji për amnisti. Ligjshmëria dhe kushtetutshmëria e këtij ligji ishte sfiduar edhe në Gjykatën Kushtetuese dhe pas disa korrigjimeve të kërkuara nga Gjykata Kushtetuese, ky ligj hyri në fuqi dhe u aplikua në përputhje me vullnetin e shprehur nga shumica e deputetëve të këtij Kuvendi.

Fakti që ky ligj është sponsorizuar nga Ministria e Drejtësisë, në gjykimin tim, në asnjë mënyrë dhe në asnjë formë nuk mund të mbajë përgjegjës ministrin e Drejtësisë, Hajredin Kuçi, për pasojat e pretenduara me këtë mocion, sepse në çdo vend demokratik shumica e ligjeve dhe në veçanti ligjet e kësaj natyre sponsorizohen nga Ministria e Drejtësisë.

Ashtu sikurse edhe çdo ligj tjetër, por edhe për këtë, përgjegjësia bie mbi secilin nga ne dhe kësaj përgjegjësie nuk do t'i dalim ballë dhe ta mohojmë e t'ia hedhim fajin personave të tjerë, ose një personi të veçantë, varësisht nga pozicionet dhe nga koncepti ynë politik. Këtë ligj e ka aprovuar Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe ne nuk kemi asnjë ankesë, se dikush nga deputetët në momentin e votimit të këtij ligji të jetë shpallur i pandërgjegjshëm.

Sa u përket pretendimeve të parashtruara në pikën H, më lejoni të ripërsëris, se themelimi i dhomave të specializuara vjen si rezultat i detyrimeve ndërkombëtare të trashëguara me shkëmbimin e letrave nga presidentja e Republikës së Kosovës dhe Baroneshës Ashton. Kosova kishte shprehur gatishmërinë për t'i dhënë dritën jeshile hetimit dhe gjyqimit të mundshëm të pretendimeve të hetuara nga prokurori amerikan Williamson.

Në qoftë se, kushdo nga ne vazhdon të besojë se me themelimin e dhomave të specializuara do të cenohet ligji apo Kushtetuta e Republikës së Kosovës, ju ftoj që këto pretendime t'i adresoni tek institucionet relevante të drejtësisë, të cilat kanë për detyrë t'i trajtojnë në mënyrë meritore.

T'ua përkujtoj, se në këtë Kuvend është zhvilluar debat lidhur me Gjykatën Speciale, përkatësisht dhomat e specializuara. Nënshkruesit e kësaj kërke për interpelancë mund ta lexojnë procesverbalin nga ai debat dhe të shohin vlerësimet e shumicës së deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Prandaj, në fund, mbes pranë qëndrimit tim se kjo rezolutë duhet të hidhet dhe, në qoftë se duhet të aprovojë rezolutë ky Kuvend, në të duhet të pranohet si pozitiv dhe shumë i përkushteushëm puna që ministri i Drejtësisë e ka bërë në periudhën e gjertanishme. Faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër Mustafa! Tani është radha e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, e ka fjalën zoti Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Përshëndetje për kryeministrin, Kabinetin qeverisës.

Ne, absolutisht respektojmë të drejtën e çdo deputeti dhe grupi parlamentar për të ngritur shqetësimet e tyre, që kanë të bëjnë në përgjithësi me jetën e qytetarëve të Kosovës, për të dhënë kontributin e tyre, që vërtet të ndryshojë pozitivisht jeta e qytetarëve të vendit. Po kurrresi dhe asnjëherë, nuk pajtohem me shpifjet, fyerjet, pretendimet negative që përkundër asaj e dëmtojnë jetën apo e rëndojnë jetën e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Këtu në këtë Parlament, nga kjo foltore, ne jemi mësuar, tashmë është bërë pothuajse rutinë, të dëgjojmë vetëm akuza dhe njëkohësisht t'i përziejnë edhe nivelet e pushteteve.

Ne duhet ta dimë dhe ta kemi të qartë, se kemi tri nivele të pushtetit: atë legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Të tri këto pushtete zhvillojnë punën e tyre në kuadër, i kanë të përcaktuar kompetencat e tyre me ligj dhe kushtetutën e Republikës së Kosovës, që fatkeqësisht për opozitën aktuale të vendit nuk kanë vlejtur asnjëherë, as ligjet, as Kushtetuta, as këto institucione, të cilat me punën e veprimet e tyre opozita, fatkeqësisht, në mungesë të vizionit dhe të ofertave apo projekteve konkrete për ndryshime pozitive i ka përzier.

Kështu po ndodh edhe sot, fatkeqësisht, me këtë interpelancë. Unë i bëj thirrje edhe opozitës dhe çdokujt tjetër, se jetën tonë duhet ta ndërtojmë ne vetë. Përgjegjës për mirëqenien tonë jemi ne vetë qytetarët e Republikës së Kosovës. Nuk kemi të drejtë ta fajësojmë askënd, por kjo ndërtohet, vërtet duke i pranuar vlerat tona pozitive, duke i pranuar dhe respektuar ndryshimet pozitive, që kanë ndodhur e po vazhdojnë të ndodhin në vendin tonë, por, gjithsesi duke mos hezitur dhe duke i luftuar të gjitha dukuritë negative, që ndodhin në vendin tonë, sepse këto veprime do të shkojnë në të mirën e familjeve tona, të fëmijëve tanë dhe në përgjithësi të popullit tonë dhe të fuqizimit të shtetit tonë.

Ne, këtu shohim akuza në adresë të njërit nga ministrat dhe njerëzit më të suksesshëm në jetën institucionale, lirisht, ndër më të suksesshme në jetën institucionale të vendit, siç është ministri i Drejtësisë. Akuzohet këtu për disa gjëra që absolutisht, është absurde të mendojë dikush e lëre më t'i thotë e aq më tepër, kur kemi parasysh që këtë mocion apo interpelancë e ngrit opozita, prej të cilës vërtet priten ide, priten kritika të argumentuara dhe jo shpifje dhe akuza të pabaza.

Prandaj, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, në vazhdimësi ka qenë, është dhe do të mbetet që të krijojmë një unitet, një bashkëpunim bashkëpunues, t'i respektojmë idetë e dobishme që vijnë nga kushdo qoftë, po kurrresi dhe gjithnjë do të jemi kundër atyre tentativave, të cilat dëmtojnë proceset, bëjnë përpjekje që ta denigrojnë jetën tonë institucionale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Grupi ynë Parlamentar i LDK-së, sigurisht që e mirëkupton çdo kërkesë për debat, për interpelancë, për mocion, për çështjet, të cilat vlerësohen ose pretendohet të vlerësohen që janë të interesit të veçantë për qytetarët tanë. Fundi i fundit, ky është edhe obligim yni, pavarësisht se edhe mund të mos ia qëllojmë në atë që e shtrojmë. Por, është një e drejtë që i garantohet çdo grupi parlamentar këtu dhe çdo deputeti edhe individualisht.

Është shumë e qartë, që ne nga teksti i interpelancës dhe nga ajo që e kemi lexuar, që në shumë pika pikërisht do të ishte e kundërta, po që se zoti Kuçi do të interferohej si ministër dhe ne ishte dashur të shqetësohemi në interferimin e ndërhyrjen e tij në punën, gjegjësisht në pavarësinë e organeve të pavarura të drejtësisë, gjyqësisë, sepse u tha edhe më herët, ne e kemi të qartë që pushtetet janë të ndara dhe si të tilla edhe duhet të veprojnë.

Dhe, shumëçka vërtet që është thënë në këtë tekst të interpelancës, po e them edhe njëherë, po të bëhej e kundërta vërtet do të duhej të shqetësohemi dhe ne do të duhej të kërkonim llogari, sepse po ndërhyhet në pavarësinë e institucioneve tona.

Sigurisht, të nderuar kolegë, që ne si grup parlamentar, po ashtu vlerësojmë se zoti Kuçi si ministër ka kryer punën e vet me kompetencë të plotë karshi kompetencave dhe përgjegjësi që i ka. Është shumë e qartë, që ne jemi shtet dhe ashtu edhe duhet të sillemi, si shtet dhe t'i kryejmë obligimet tona, sepse të qenit shtet nuk nënkupton, nëse mund të thuhet, vetëm privilegje dhe benefite, që mund t'i kemi si shtet, por nënkupton edhe përgjegjësi dhe kryerje obligimesh, që në disa raste edhe mund të mos na pëlqejnë, po si të tilla janë dhe si të tilla duhet t'i përmbushim. Duke qenë të vetëdijsëm, po ashtu që ne nuk themi asnjëherë që jemi të kënaqur me të gjitha institucionet tona, por kjo nuk nënkupton që të kemi, ose të bëjmë linçimin të atyre që nuk është përgjegjësi e tyre.

Ne kemi vërejtje, kemi thënë disa herë, në punën e Prokurorisë, në punën e organeve të gjyqësisë dhe në punën e shumë institucioneve tjera, po në këtë rast, kjo absolutisht nuk ndërlihet, për mendimin tonë, me punën që e bën zoti Kuçi si ministër.

Duke mos dashur ta zgjas më tepër, ne si grup parlamentar mbështesim plotësisht edhe fjalën e kryeministrit, sepse ishte shumë argumentues, ishte e bazuar në fakte dhe e tha atë, që edhe ne jemi të bindur se ashtu edhe qëndron.

Ne si grup parlamentar, si Lidhje Demokratike, nuk do të votojmë, gjegjësisht do ta votojmë kundër një rekomandim, që është i shkruar në këtë tekst të rezolutës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Albulena Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Fillimisht, më duhet të them që një ndër kërkesat e protestave të organizuara nga opozita, jo më pak e rëndësishme ishte edhe kërkesa për shkarkimin e ministrit të Drejtësisë, Hajredin Kuçi.

Natyrisht që nuk do të kishte nevojë as për këtë interpelancë, nëse kryeministri Isa Mustafa do të reflektonte dhe në përputhje me obligimet që ka, do ta shkarkonte një ministër, si pasojë e së cilit është duke u mbajtur peng gjyqësia dhe Prokuroria dhe po cenohet sovraniteti dhe integriteti territorial.

Nuk ka nevojë për shumë analiza për të kuptuar, se kërkesa për shkarkimin e Hajredin Kuçit është e drejtë, është e domosdoshme dhe është e nevojshme.

Janë thjesht të pamjaftueshme minutat e kësaj interpelance, për t'i listuar dështimet e ministrit të Drejtësisë, Hajredin Kuçi dhe, natyrisht që unë do të ndalem vetëm në dy, ose tri dështime të tij dhe pjesën tjetër, sigurisht që do ta prezantojnë deputetët e Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe deputetët e subjekteve opozitare.

Së pari, kur flasim për ministrin e Drejtësisë, nuk ka se si të mos na kujtohet prezenca dhe ndikimet e tij të paligjshme dhe jokushtetuese në Këshillin Prokurorial.

Natyrisht, për të gjitha ato çfarë kanë ndodhur janë përgjegjës edhe vetë anëtarët e Këshillit Prokurorial, por përgjegjësia më e madhe bie mbi Hajredin Kuçin, si ministër i Drejtësisë.

Është pikërisht ky Këshill, nga i cili janë pritur betejat kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe i cili në vazhdimësi ka amnistuar zyrtarët e korrumpuar. Pikërisht, ky këshill, që në përbërjen e tij ka Hajredin Kuçin, është shndërruar në arenë përplasjesh të interesave klanore e mafioze, nuk ka as se si të mos na kujtohet, kur ministri i Drejtësisë i thërriste një për një anëtarët e Këshillit Prokurorial në zyrën e tij. A është ky ndikim? Po, sigurisht që po!

Në vend se ministri i Drejtësisë, si anëtar ex-officio të siguronte një funksionim efikas dhe të pavarur të këtij këshilli, ai kontribuoi në degradimin e tij saqë askujt më nuk mund t'i kthehet besimi i humbur në këtë institucion, që të paktën Kushtetutën e Republikës së Kosovës thuhet që është i pavarur.

Më tej, siç edhe e dimë, një nga kompetencat kryesore të ministrit të Drejtësisë është edhe mbikëqyrja ndaj Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Shpesh Hajredin Kuçi ka thënë se ai vetëm emëron drejtorin e burgjeve dhe nuk ka asnjë kompetencë tjetër. Në Kosovë, jemi dëshmitarë që të paraburgosurve VIP u lejohet që t'i koordinojnë deklaratat me dëshmitarët e proceseve penale, ku janë të pandehur. E kemi të freskët këtu rastin Tolaj.

Të burgosurve, po ashtu VIP u lejohen të gjitha mjetet e ndaluara për ata që vuajnë dënimin për shkak të kryerjes së veprës penale. Në burgjet tona trafikohet gjithçka, bash gjithçka, nga produktet e luksit e deri tek narkotikët. Anëtar i PDK-së kryetar komune nga paraburgimi doli dhe në QKUK në Prishtinë për orë të tëra u ngujua brenda dhe pas një negocimi të gjatë mezi arritën që ta nxirrnin e ta kthenin në paraburgim.

Tani, ju thoni zoti ministër, që nuk keni përgjegjësi direkte, por vetëm për drejtorin e burgut. Pse nuk e keni shkarkuar, pra?

Edhe nëse i besojmë fjalës suaj, për disa sekonda, se nuk jeni i përfshirë në këtë rrjet kriminal, pse nuk e keni shkarkuar dhe dërguar për ndjekje penale drejtuesin e Shërbimit Korrektues? Por, siç e dini dhe ju shumë mirë, ai është bashkëpunëtor i juaj dhe zbatues i urdhrave tuaj.

Kjo çfarë keni bërë ju është sabotim total i Prokurorisë së Kosovës. Nëse edhe për pak qaste i pandehuri e dëshmitari apo personat rreth tij u lehet mundësia që të koordinohen apo rregullojnë deklaratimet, gjithë puna e prokurorit vihet në pikëpyetje.

Në vend se pikërisht Shërbimi Korrektues të ishte shtylla bazë, strikte, e pakompromis, që i mbulon krahët e prokurorëve dhe ua garanton atyre punën, përkundrazi është në fakt, thikë pas shpine e çdo procesi hetimor, ku janë të përfshirë klientët tuaj, ose njerëzit e klanit tuaj, zoti ministër.

Përveç kësaj, ne e dimë se ju keni toleruar aq shumë, sa që çdo i dënuar i afërt me klanin tuaj të ketë mundësi t'i vazhdojë aktivitetet e veta kriminale, duke u lënë i lirë të qarkullojë nëpër Kosovë, madje edhe në qendër të Prishtinës.

Po, si munden pra, prokurorët e këtyre rasteve apo gjyqtarët të marrin vendime e veprime kurajoze, siç ua kërkon ligji, kur në çdo kohë personi që akuzojnë apo dënojnë, ose bashkëpunëtorët e tyre, mund t'u vijë para syve dhe t'i kërcënojë. Këtë tolerancë që kanë në raport me të dënuarit apo të paraburgosurit e klanit tuaj apo klientëve tuaj, vartësit tuaj e përkthejnë në shtypje dhe shkelje të të drejtave për të burgosurit dhe të paraburgosurit e zakonshëm, përgjithësisht të varfër e të pamundur apo edhe për rastet e aktivistëve të Lëvizjes "Vetëvendosje".

Ne kemi qenë brenda atyre ambienteve dhe kemi parë se si ndryshon gjendja e punonjësve pas një urdhri politik për keqtrajtim, ose për sjellje korrekte. Të gjithëve këtu, zoti ministër dhe zoti kryeministër, mund t'u shisni përralla, po neve jo. Ne i kemi parë me sytë tanë dhe i kemi provuar vetë kushtet e tmerrshme të këtyre institucioneve korrektuese.

Pra, ju po aq fajtorë për keqpërdorime keni brenda këtij shërbimi, sa që jeni përgjegjës për raste të shkeljeve të të drejtave të qytetarëve të zakonshëm, që vuajnë dënimin. Dhe, kur jemi këtu, jeni pikërisht ju, zoti ministër, që për vite me radhë i keni mashtruar të burgosurit, se do ta sillni në Kuvend Ligjin për amnisti. Dhe, ju e sollët, mirëpo jo për ata, e sollët për strukturat kriminale në veri, të cilët e kanë luftuar aktivisht shtetin e Kosovës dhe po vazhdojnë ta bëjnë një gjë të tillë.

Dhe, kur flitet për krimin e organizuar dhe korrupsionin, nuk ka se si të mos na kujtohen premtimet e ministrit të Drejtësisë, se do ta sjellë në Kuvend Projektligjin anti-mafia. Dhe, përveç që nuk e solli, ai tentoi që përmes Kodit Penal t'i amnistonte zyrtarët e korruptuar. Sigurisht, se ai projektligj do të kalonte, po mos t'i bëjë presion ministri që ta tërhiqte një të tillë.

Gjithashtu, është po ky ministër i përmbauresve privatë, që nëpërmjet mekanizmave kërcënues po i zhvat qytetarët e Republikës së Kosovës, të cilët në fakt po jetojnë në varfri dhe mjerim.

Dhe në fund, më duhet të them se qytetarët, jo vetëm se duan drejtësi, por kanë nevojë për drejtësi, nuk mund të ketë zhvillim në Kosovë, pa drejtësi e nuk mund të ketë drejtësi me ministër të Drejtësisë, Hajredin Kuçin.

Dhe sigurisht, që kërkesa që e tha zonja Kadaj, që është edhe në rekomandimin e kësaj interpelance, është e drejtë, është e ligjshme dhe është e domosdoshme. Ministri i Drejtësisë Hajredin Kuçi duhet sa më parë të shkarkohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kush e do fjalën nga AAK-ja? Zonja Kadriaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Sistemi i drejtësisë në Kosovë është totalisht i dështuar. Nuk ka shtrirje të juridiksionit në tërë territorin e vendit, pastaj dhe krijimi i Gjykatës Speciale tregon më së miri se në çfarë situatë jemi, në besueshmërinë e sistemit të drejtësisë në Kosovë.

Po ashtu, korrupsioni mungesa e vizionit, drejtësia jofunksionale dhe padashja e kësaj Qeverie për të vepruar është një ndër shkaktarët kyç të mbytjes së shpresës së qytetarit të Kosovës.

Nëse i referohemi një shprehjeje se Kosova ka probleme me sistemin e drejtësisë, atëherë kjo tregon më së miri se kush i ka fajet për këto probleme dhe kush ka më së shumti probleme me drejtësinë. Pra, janë këta politikanë që janë në pushtet, të cilët duke përdorur pushtetin kanë kriminalizuar drejtësinë në vend.

Në rrethanat që gjendet sot Kosova dhe sistemi i drejtësisë, kur asnjë institucion apo lider në pushtet nuk ka guxim të dalë në krahun e drejtësisë, në rastet kur bashkëpartiakët e tyre janë të akuzuar, Kosova nuk mund të presë progres në sundimin e ligjit, që është baza themelore e një shteti funksional e demokratik, apo ndoshta e vërteta është edhe më dëshpëruese, sepse janë liderët e partive në pushtet, që kanë në dorë edhe institucionet, ato që e kanë kriminalizuar sistemin qëllimshëm duke shndërruar Kosovën në një vend oazë të krimit, ku pushteti merr gjithçka e populli dënohet me asgjë.

Problemi për drejtësi kaq të dobët nuk është vetëm te politika, një pjesë të përgjegjësisë e ka edhe vetë sistemi i drejtësisë, i cili përbrenda vuan nga korrupsioni, ndërsa është i nënshtruar nga jashtë përballë presionit dhe kontrollit politik.

Gjykatësit dhe prokurorët, por edhe organet e hetuesisë po dëshmojnë në ndërtimin e një shteti ku ligji nuk i trajton të gjithë njësoj. Për politikanin e pushtetit drejtësia është si vëlla e motër, ndërsa për qytetarët ajo është një njerë e keqe, po në të njëjtën vepër.

Qeveria e Kosovës sikurse ajo e djeshmja, po ashtu edhe kjo e sotmja, në vend që t'i bënin partnerë të mirëfilltë misionin ndërkombëtar të drejtësisë, për të përmirësuar funksionimin e saj në Kosovë, këto qeveri kanë pasur dhe kanë si qëllim vetëm pazaret me ta, për të bërë edhe linçime politike, vetëm e vetëm për të qëndruar rehat në pushtet, pa i trazuar kush.

Për qytetarin e Kosovës e tëra kjo dëshmon vetëm për dështime në sistemin e drejtësisë në Kosovë. Krejt çka ka bërë Qeveria e kaluar edhe kjo e sotmja, në të cilat mandate është i njëjti

ministër, e s'e kanë shprehur bindjen e tyre, se bashkë me infrastrukturën që është në ndërtim e sipër, gjyqësori dhe përgjithësisht sistemi i drejtësisë, do t'i nënshtrohen reformave të nevojshme, që të jetë një shembull i mirë për gjithë rajonin. Në realitet, kjo as që ka ndodhur dhe as që po shihet në horizont, se do të ndodhë diçka e tillë.

Në bazë të raporteve paraprahe të progresit dhe së fundit edhe në sundim të fizibilitetit të Komisionit Evropian, po bëhen vlerësime për të arriturat dhe ngecjet në Kosovë, sistemi i drejtësisë përfshin gjyqësorin dhe Prokurorinë, mbeten në një shkallë shumë të ulët të zhvillimit. Por, kjo nuk do të thotë se sektorët tjerë janë më mirë në këtë vend.

Bazuar në këto raporte, drejtësia mbetet ende e varur nga politika, kështu që investimet dhe reformat në këtë sektor shihen jo vetëm të rëndësishme, por edhe të domosdoshme për shtetin më të ri evropian.

Për fund, më duhet të them se nuk pritet mirë, sepse sot shumica e udhëheqësve vendimmarrës të sistemit të rendit dhe ligjit, por edhe në fusha të tjera jetike për vendin, janë trashëgimi juridike dhe politike e ish-sistemit, njerëz të cilët nuk ndërtojnë sistem demokratik profesional dhe të mirëfilltë të rendit dhe ligjit.

KRYESUESI: Zonja Bajrami në emër të Grupit Parlamentar "Nisma".

VALDETE BAJRAMI: Faleminderit, zoti kryesues!

Pikërisht interpelanca e ditës së sotme është thirrur nga opozita dhe pritet të thirret nga opozita, jo siç e parashtuan parafolësit nga pozita, dhe nuk presim që ata të merren me kryeministrin e me Kabinetin qeveritar.

Kjo interpelancë e ka si pikë kryesore ose pikë referimi pikërisht sistemin e drejtësisë, sistem, për të cilin ne e kemi ngritur si çështje në seanca radhazi, për të gjitha ato shkelje dhe gjithë ato parregullsi, të cilat kanë kapluar sistemin e drejtësisë, qoftë atë vendor, po edhe atë ndërkombëtar.

Po e them këtë, pasi që skandalet që e kanë përfshirë gjithë sistemin e drejtësisë janë alarmante dhe medoemos sot do të duhej që kryeministri të na jepte shpjegime për gjithë ato skandale që kanë kapluar këtë sistem. Por, ne sot realisht çka dëgjuam nga kryeministri në fjalimin e tij-lëvdata të pafundme për ministrin e Drejtësisë, që në një moment mu krijua përshtypja athua është duke folur për ndonjë shenjtor apo është dashur këta sot këtu t'ia përgatisin ndonjë Çmim Nobel për Drejtësi apo jemi duke folur për realitetin, i cili po mbretëron këto shtatë vjet, që e ka udhëhequr dikasterin ky ministër.

Unë po i përmend vetëm disa nga skandalet që kanë të bëjnë me sistemin e drejtësisë. Nuk e di a ju kujtohet juve, por besoj që e keni të freskët, pasi që ka ndodhur skandali i dytë me pasaporta ku kemi pasur një prononcim të një zyrtari të MPB-së, që publikisht e denoncoi korrupsionin, por edhe keqpërdorimin që është bërë me pasaporta me argumente. Po, çka ndodh këtu tek ne, të nderuar qytetarë dhe ju kolegë deputetë?

Në momentin që raportohet një keqpërdorim në mënyrë shumë të shpejtë ai person largohet nga puna dhe sistemohet automatikisht ajo çështje.

Skandalet në misionin ndërkombëtar të EULEX-it, për të cilat po ashtu janë ofruar dëshmi dhe askush nga ju dhe nga Qeveria nuk është deklaruar për të gjitha ato skandale dhe po ashtu, kjo është një dëshmi që sistemi i drejtësisë këtu tek ne është sistem i Qeverisë, po e them më mirë, sistem i klaneve të cilat kanë shtrirë rrjetin kudo, por edhe në drejtësi.

E ju zoti kryeministër, e dini fort mirë gjatë fushatës se si e keni cilësuar punën e zotit Kuçi, e sot ju këtu të dilni e ta mbronni me aq mburrje, kjo është për t'u habitur. Do të duhej të jetë alarmante kjo gjendje e sistemit të drejtësisë, për ju kryeministër, po edhe për vartësin tuaj.

Është për habi se si ka mbetur dhe po mbretëron kjo qetësi tek ju në lidhje me të gjitha rastet të cilat janë të njohura edhe për ju, por edhe për qytetarët ku sistemi i drejtësisë ka dështuar.

Ne i kemi pasur edhe deklaratimet e prokurorëve, ku pohojnë se bandat kriminale e kanë kapluar Prokurorinë e Shtetit, Këshillin Prokurorial, Gjykatën Supreme dhe gjithë sistemin e drejtësisë, se sistemi i drejtësisë është i kapur dhe se është para shkatërrimit, dëshmohet në të gjitha skandalet që i kemi përmendur radhazi në të gjitha prononcimet tona.

I gjithë ky sistem i drejtësisë në vendin tonë është i ndikuar politikisht dhe këtë e kanë dëshmuar rastet, të cilat unë i përmenda edhe më lart, po edhe në seancat e kaluara dhe të cilat ju i dini shumë mirë. Kjo që e potencova është dëshmi se sistemi i drejtësisë dhe sistemi gjyqësor në tërësi është duke shkuar drejt shkatërrimit dhe degradimit total. Kjo është dëshmuar edhe në rastet skandaloze të misionit ndërkombëtar, i cili është i thirrur pikërisht për sundimin e rendit dhe ligjit.

Nga dështimi i sistemit të drejtësisë, të vetmit të cilët po atakohen janë qytetarët dhe mosfunksionimi i gjithë këtij sistemi, i cili po luan me të drejtat e njeriut, të drejta të cilat janë të garantuara me Kushtetutë, por edhe me aktet ndërkombëtare e që vetëm këtu tek ne nuk respektohen, pasi që nuk ka barazi të palëve. Këtu vendimet merren në baza familjare, në baza partiake, kënd ta eliminojmë e kënd jo. Faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kuçi e ka fjalën.

MINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit!

I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

I nderuar kryeministër,

Zëvendëskryeministër,

Të nderuar deputetë,

Unë e kuptoj debatin dhe interpelancën që e ka kërkuar sot opozita dhe unë besoj që e kuptoj si pjesë të debatit demokratik që bëhet në këtë shoqëri, por njëkohësisht si pjesë e përpjekjeve tona për ta përmirësuar çdo pjesë të sistemit të shoqërisë sonë, por në veçanti edhe sistemin e drejtësisë.

Para se të hy në esencë, më lejoni të falënderoj publikisht kryeministrin për fjalën dhe për mbështetjen e tij dhe kjo është një përkushtim shtesë, që do të jetë për mua për angazhimet në fushën e drejtësisë.

Por, po ashtu, më lejoni të them që gjatë viteve të shkuara në Qeveri, qoftë si zëvendëskryeministër, pastaj ministër i Drejtësisë dhe tash prapë ministër i Drejtësisë, qëllimi im ka qenë gjithmonë ta trajtoj drejtësinë, jo si pjesë të pozitës dhe opozitës, por si pjesë të konsensusit nacional. Dhe, kjo për mua është brenga kryesore që unë nuk dua ta shoh në asnjë rast veten, që jam i pranueshëm për opozitën ose për pozitën dhe nuk jam për një pjesë tjetër.

Pse po e them këtë? Drejtësia në këtë vend, ose do të jetë për të gjithë qytetarët e vendit, ose nuk do të jetë për asnjë.

Më lejoni ta jap një vërtetim politik dhe pastaj edhe një personal. Kur e them politik, këtë vuajtjen e ministrave të drejtësisë, tërë vendet ish-komuniste e kanë më shumë a më pak. Çdo kund identifikohen dhe adresohen, se ministrat e drejtësisë janë përgjegjës për zhvillimet në gjyqësor dhe Prokurori, por po e them po ashtu, që nuk kanë fuqi.

Dhe, në këtë drejtim personal, më lejoni të shpreh, jo për ta shtirë dikë në hatër, por për dy parti politike, jam i befasuar në kuptimin pse po e bëjnë një gjë të tillë, kur bashkëpunimi ka qenë në nivelin më të mirë të mundur në çdo drejtim, por, sido që të jetë, politikën e kuptoj.

Më lejoni të them që angazhimi im në mandatin e parë ka qenë që të ndërtoj arkitekturën e drejtësisë dhe të ndërtoj standarde në drejtësi. Shikoni sot, në vitin 2011 kur jam bërë ministër dhe shikoni sot arkitekturën e drejtësisë, ka riemërim të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe, ka buxhet për ata të nivelit të ministrave dhe në propozimin e tashëm edhe më shumë. Ka mandat të përjetshëm për të gjithë ata, të përhershëm dhe po ashtu, ka noteri, ndërmjetësim, arbitrazh dhe shumë segmente të tjera që ndihmojnë drejtësinë, përfshirë edhe përmbaruesit privatë, që është koncept yni pro-perëndimor liberal që kemi bërë. Ky është dallim konceptual me të tjerët.

Më lejoni të them që nga ajo kohë kam proceduar mbi 50 ligje dhe, po ashtu, t'ju falënderoj, përfshirë edhe ligjet e fundit, të gjitha janë votuar me konsensus. Të gjitha, po e përsëris, ligjet që i kam dërguar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, përfshirë edhe Lëvizjen "Vetëvendosje", se nga AAK-ja dhe Nisma e kam pritur, që janë votuar me konsensus, me një votë abstenim ka qenë herën e fundit dhe për Prokurorinë e Shtetit.

Çka dua të them unë? Dua të them, që nuk e kanë bërë këtë për mua, por e kanë bërë për sistemin e drejtësisë dhe, unë jam i bindur, që secili në këtë vend e ka perceptimin e njëjtë për drejtësi. Por, ta shohim drejtësinë pak më shumë se sa një individ. Unë habitem me konstatimet, ku një individ po mund të bëka veprime ose fuqi të tilla. Unë e di, që identifikohet me fuqinë politike. Për nder, ministrat e drejtësisë, ju mund të shihni në ndonjë vend tjetër të rajonit, kush hesap s'i bën.

Qe po e marrim shembull me Shqipëri, kam shumë respekt për zotin Naço, ka pasur shumë telashe, muajt e fundit, kush s' ka folur për të. Unë e di që keni problem me fuqinë time politike, jo me fuqinë time si ministër. Si ministër i Drejtësisë, unë jam i bindur që, po ua them një fakt,

që nga koha ime si ministër i Drejtësisë, asnjë individ që e ka emëruar një kohë Aleanca dhe LDK-ja, pastaj LDK-ja, pastaj të tjerët, asnjë individ s'e kam ndërruar. Asnjë individ s'e kam larguar nga puna. Shikoni, kjo nuk e di a ka qenë mirë a keq, por s'kam pasur orientim partiak.

Po ashtu, dua të them që edhe në veprimet që i kemi bërë në infrastrukturë, shumëkush nuk ma përmend infrastrukturën, se unë s'jam marrë me prokurim, por mbi 100 milionë, në mandatin e kaluar si ministër i Drejtësisë, ia kam sjell sistemit të drejtësisë donacione. Gjashtë prokurori dhe gjykata, katër burgje të nivelit të lartë dhe sistemit tjetër të drejtësisë, të gjitha këto me donacione nga bashkësia ndërkombëtare, këtë do të vazhdoj ta bëj edhe në të ardhmen.

Më lejoni të them që ndarja e pushteteve ka tri mentalitete. Mentaliteti i parë është i atyre që kanë perceptimin politik për mua dhe i kuptoj tërë jetën, i dyti, është ata që nuk e dinë që ndahen pushtetet shumë edhe ata i kuptoj.

Mentaliteti i tretë është, ata që thonë: "Me pas qenë në vend të tij, e kisha bërë këtë." Unë po ju them, që edhe po të ishit ministra të drejtësisë s'do të mund të bëni asgjë, se pushtetet janë të ndara. E di që puna e gjyqësorit është për t'u përmirësuar, edhe puna e Prokurorisë është e njëjtë. E di që ka vend për shumë përmirësime, sikurse e dini edhe ju dhe po ashtu e di që ka shkarje në këto sisteme, por asnjë sistem nuk është i veçantë për t'i ndihmuar tjetrit në mënyrë të veçantë. Të gjitha të tjerat i ndihmojnë njëra- tjetrës, nuk ka ekzekutiv të mirë pa legjislativ të fortë dhe, s'ka gjyqësor nëse s'i kemi edhe këto dy pushtete të ndara dhe të fuqishme.

Më lejoni të them, që këto çështjet e ndërhyrjeve që mund të jenë politike, fisnore, kulturore, familjare, po e them vetëm një fakt, ai gjyqtar dhe prokuror, që s'mund ta mbrojë veten nga ndërhyrjet, duhet ta lëshojë zanatin. Ai duhet të na mbrojë edhe neve, jo vetë veten.

Dhe, po ashtu, dua të them qartë, sa herë që flasim në Këshill Prokurorial edhe diku tjetër, ka qenë ajo zjarrmia e zgjedhjes së kryeprokurorit, bile po ju them që kanë pasur zjarrmi edhe njerëzit në këtë Kuvend më shumë se disa të tjerë. A e keni parë se në mbledhjen e fundit janë qetësuar? U zgjodh kryeprokurori, u pajtuan të gjithë, kurrkush s'reagoi. Në mbledhjen e fundit 23 pikë kanë shkuar si hallvë, si thotë një fjalë popullore. Domethënë, s'paskan qenë problem anëtarët e Këshillit Prokurorial, por paska qenë diku tjetër.

Po ju premtoj edhe një fakt, pas shtatë vjetëve kur të zgjidhet kryeprokurori tjetër, besoj që jemi shëndosh e rehat, edhe që s'jemi ministra ose deputetë, do ta shihni se do të ketë prapë telashe. Pra, ka pasur edhe në këtë vend telashe edhe kur u zgjedh kryetari i Kuvendit edhe kur u zgjodh Qeveria, kështu ka qenë edhe, atje.

Nuk janë as ata më të mirë se ne, as ne më të mirë se ata, gati si njësoj jemi. E tha që u thirr në zyrën time, s'i kam thirr asnjëherë në zyrën time, është e vërtetë që kam kontribuar, por asnjëherë për pesë vjet nuk kam marrë pjesë në emërim apo në disiplinim të prokurorëve, asnjëherë, edhe pse fuqia ligjore kushtetuese ma ka lejuar një gjë të tillë.

Duke dashur t'u ikë këtyre fjalëve, kam propozuar që të mos jetë ministri fare fizikisht, as anëtar, as sipas detyrës zyrtare.

Më lejoni të them, për çështjen e Shërbimit Korrektues. E di që ka telashe, atje. Besoj, se e dimë të gjithë ne, e di që ka edhe probleme. E di që ka pasur probleme të natyrave që tërë punën time si ministër e ka mbuluar ajo hije dhe, nuk më ka ardhur mirë, mu së pari e besoj edhe të tjerëve. Por, po ashtu po e them, mbi 1900 veta janë mesatarisht në Shërbimin Korrektues, ata janë njerëz. Unë them, sundimi i ligjit me ligj.

Të gjitha të drejtat që i kanë do të mundohem t'ua respektojme, por duhet ta kryejnë obligimin ligjor. Ndonjë rast apo incident që ka ndodhur, janë organet kompetente që e kryejnë. Por, unë po e them një fakt, si ministër i Drejtësisë, në mandatin e kaluar, me Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale e kam emëruar Shërbimin Korrektues të Kosovës si Agjenci të Pavarur, sikurse është Policia e Kosovës, është edhe Shërbimi Korrektues i Kosovës.

Dhe, një fakt shtesë, në Kodin Penal që po ashtu, e kam sponsorizuar unë, është një kapitull i veçantë për ikjen dhe ndihmën që jepet gjatë kohës së vuajtjes së dënimit, pra, këto janë çështje të dikujt tjetër.

Dhe, po ashtu ta them, e di që i përmendni do emra, i keni në kokë, mos e harroni një fakt, 1900 akademikë, profesorë për t' i mbledhur në një vend, ke ngapak telashe. Mos u merrni shumë vetëm me ata. Për pesë vjet nuk më ka ikur kurrkush, dy ditë ka ikur dikush e është kthyer, nuk është vrarë kurrkush, ka pasur fatkeqësi, dy vetëvrasje dhe, çka dua të them? Unë megjithatë, mendoj se po e menaxhojmë, por, ma gjeni një burg në rajon dhe më larg, që s'ka pasur telashe të tilla.

Mos t'i shohim tash njerëzit atje... e di, kanë bërë veprime pa procedura, e tjera... por mos t'i stigmatizojmë. Dhe, në fund të fundit, nuk dua ta mbroj asnjë veprim kundërligjor, për ne, disa do të jenë heronj edhe nëse dënohen 100 vjet. Kurrë, mos pritni se do t'i trajtoj njëjtë. Ua kam thënë edhe në Bruksel edhe në Uashington edhe ku t'ua merr mendja juve, por jo për ta shkelur ligjin, brenda ligjit kanë trajtim tjetër, jo vetëm te ne, por edhe në vendet tjera.

Dhe, unë besoj që këtu duhet të jemi korrekt, mos flisni nëpër dhëmbë, por të flasim shumë konkretisht dhe, këtë e bëj me krenarinë më të madhe të mundur, jo vetëm për ata, nuk janë në pyetje të partisë sime. Bile, në daç ta dish një fakt, gjema një shtet demokratik në krejt Evropën, që ka më shumë të dënuar të partisë në pushtet si në Kosovë. Ma gjeni një shtet.

Po e përsëris prapë, çka i bie kjo? Kjo i bie që rendi dhe ligji s'e ka amnistuar partinë në pushtet. Kjo i bie, që rendi dhe ligji s'i ka amnistuar. Dhe e fundit, që u përmend edhe rasti me EULEX-in e të tjerët, shikoni, unë mendoj që për sistemin e drejtësisë është mirë të flasin ata të cilët duhet t'i shohin dy forma, edhe formën e mjekut edhe të pacientit.

Ne jetojmë në një sistem juridik, që unë e kam bindjen e plotë dhe unë drejtësinë e kam mision, që 20 e diçka vjet.. nuk më lidhet me ministri, por po e them një fakt, i kemi dy çështje si mision mes mjekut dhe pacientit.

Shikoni, nuk mund ta shohim drejtësinë ndryshe, pacienti ka nevojë për mjek, mjeku për pacient, por, qëllimi i mjekut është për ta shëruar pacientin, nuk është qëllimi ynë kënd e kemi futur në

burg për ta mbytur atje, qëllimi ynë është për t'i rikthyer në shoqëri dhe të jenë qytetarë të barabartë.

Më lejoni t'i them edhe dy-tri çështje, që besoj aty fle gjuha dhe mendja e të gjithë juve - çështja për amnistinë. Nuk dua t'i përmend me emra, por e kam marrë transkriptin prej Kuvendit të Kosovës dhe e kam parë. Disa prej nënshkruesve të këtij mocioni kishin pas votuar për Ligjin për amnisti, 93 vota i kishte pasur. Nëse ka dikush pengesa... nuk jeni ju të "Vetëvendosjes", por mund t'jua jap kopjen. Jo, unë nuk, nuk...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Vazhdoja, se i ka minutat e Grupit Parlamentar.

MINISTRI HAJREDIN KUÇI: Besoj që PDK-ja do të kursehet për të folur në këtë drejtim.

Dhe, çka dua të them te çështja e amnistisë? Shikoni, disa herë e kanë përmendur, këtu. Unë kam pas pru disa nene edhe për shqiptarë dhe, po them, mi keni fshirë. Shikoni. Dhe, m'i keni fshirë. Unë e kam formuar prapë grupin punues, javën tjetër prapë e keni në Kuvend, por mos m'i fshini më!

Shikoni, çështja e dytë, që është... ju do t'i shihni veprat. A t'ua them një punë, pyetja është kënd po e amnistion? A t'ua them një punë, amnistohet ai që ka kryer vepër penale, burrat e mirë s'amnistohen, s'ka nevojë ata të amnistohen, po, ju këtë çështje duhet ta dini për amnistinë.

Një çështje tjetër, të fundit, që besoj se kjo është çështja më e ndjeshme, jo për sot, jo vetëm për të kaluarën, por edhe për të ardhmen e vendit, raporti me Gjykatën Speciale. Shumë zhurmë kam ndier për këtë.

Unë po ua them një, mua më lidh Gjykata Speciale në tri drejtime: interesi i vendit; mbrojtja e luftës dhe puna ime si ministër i Drejtësisë. Asnjë arsye tjetër, as s'e kam pasur, as s'e kam kurrë për Gjykatën Speciale. Shikoni. Këtë ua them me përgjegjësi të plotë.

Është votuar herën e kaluar. Cilindo vendim që merrni, asnjëherë nuk do të kundërshtoj, do të aplaudoj dy orë. A po e vëreni çka po ju them? Mos i arsyetoni veprimet që i keni bërë me 93 vota në këtë Kuvend, te një individ. Votoni prapë, asnjë veprim juridik s'është kryer, nuk do të dalë Gjykata Speciale të funksionojë pa i marrë votat e juaja. Që ku jeni, të nderuar deputetë, fatmirësisht unë s'kam të drejtë të votoj.

Dhe, tash po e them një fakt, jo po i shikoj, se disa në këtë anën tuaj, si zonja Haxhiu, ju keni nënshkruar në një vend ku disa kanë votuar e ju jo, kështu që keni kujdes edhe për të kaluarën edhe për të ardhmen, se memoria institucionale është pak më e gjatë.

Po e them edhe një fakt, u përmendën çështjet me... dhe unë besoj në këtë drejtim duhet të ketë konsensus. Cilindo vendim, po e përsëris, asnjë vendim që dëmton imazhin e luftës sonë të drejtë, që dëmton sovranitetin e shtetit, që e dëmton drejtësinë e vendit, kurrë mos e votoni. Absolutisht, dhe është e drejtë juaja, do ta keni mbështetjen time të plotë, por, po e them një fakt,

po kthej kokën edhe në këtë anë Rexhë, po ua them një fakt, unë kam qenë disa raste, kur i kam marrë 2/3-at e votave, kam qenë kryetar i Komisionit të Rregullores së parë të këtij Kuvendi, jam mirënjohës dhe i kam marrë 2/3-at. Kam qenë kryetar i Komisionit të Kushtetutës, i kam marrë 2/3-at, kam qenë kryetar i Komisionit për Përfundimin e Pavarësisë së Mbikëqyrur, i kam marrë votat.

Urdhëroni, si të votoni ju. Po ta kishit kundërshtuar ju, s'do të ishin në fuqi, kështu që prapë do ta keni fuqinë juridike, ligjore, të gjithë deputetët e nderuar të Kuvendit. Dhe, mos e bëni, nuk e njoh një njeri, po e përsëris, nuk e njoh një njeri që mund ta bëjë, ose ta ndalë Gjykatën, që është në pyetje Gjykata Speciale, pra s'keni nevojë të më thoni dy herë, moti do të jepja dorëheqje. Ju po mendoni, se ma matni burrërinë mua?! Po, unë Gjykata Speciale... po mendoni me Gjykatë.

Unë po e them një, nëse mendoni se një individ, Hajredin Kuçi apo kushdo të jetë, ne do të çohemi të gjithë, e ndal këtë Gjykatë, do të çohemi të gjithë, e ta lusim, a çka do t'i thuash, hiq prej aty. Gjykata Speciale, fatkeqësisht, nuk është punë e një individi.

Dhe, disa akuza që janë bërë. Shikoni, unë besoj që asnjëri prej nesh s'ka qenë shumë imun prej mediave. Dhe, nganjëherë kur i shoh disa gjëra në medie, unë mendoj se janë të mira për skenarët e Spillbergut apo të Hiçkokut. Por, nëse i qesim në këtë Kuvend krejt çka shkruhet në medie, ku ta di ku përfundojmë, krejt kush ka fakte, le t'i paraqes në Prokurori.

Por, po ua them vetëm një fakt, unë kam qenë dhe jam shumë i kujdesshëm në raport me ligjin. Shikoni, nuk e bëj këtë hatri juaj, as s'e bëj hatri i punës që jam ministër i Drejtësisë, e bëj hatri im, i familjes sime. Faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Mendoj, që kur të flas PDK-ja për Hajredin Kuçin, ma merr mendja që është një konflikt interesi, për arsye se ministri është i tyre, vjen prej strukturave të larta partiake, ka qenë me përgjegjësi të mëdha shtetërore prej vitit 2007 – 2008, si zëvendëskryeministër dhe, tash mandatin e dytë e ka si ministër i Drejtësisë. Kështu që, kur thonë këta që ky e ka kryer punën më së miri, ata edhe pritjet prej tyre të flasin kështu, sepse përndryshe, të flasin të kundërtën do të thotë që ta gjykojnë vetveten e kjo nuk do të ndodhte kurrë.

Por, kur flet Isa Mustafa tash për Hajredin Kuçin, është me interes një gjë, në mandatin e kaluar unë mbaj në mend jo vetëm kryeministrin Mustafa, por edhe shumë deputetë të LDK-së të cilët nuk kanë folur në emrin e tyre personal, dua ta theksoj, nuk kanë folur në emrin e tyre personal, por në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës, duke hedhur kritika shumë serioze sa i përket përgjegjësisë së Hajredin Kuçit dhe drejtësisë që funksionon në Kosovë.

Dhe, tash po e shohim që po ndodh e kundërta, që atij po i thurin lavde, vetë kryeministri Mustafa mund të themi që fjalimi i tij ishte një thurje lavdesh për ministrin Kuçi, dhe tash ne edhe si deputetë, por edhe qytetarët, ma merr mendja, shtrojnë pyetjen, kur e keni pas thënë të vërtetën? A e keni pas thënë atëherë, në vitin 2012, 2013 e 2014 apo e keni thënë tash? Apo, më

saktë për ta shtruar pyetjen: Kur keni mashtruar, a keni mashtruar atëherë, apo keni mashtruar tash?

Çka tregon kjo? Kjo tregon se bazamenti i koalicionit të mazhorancës, nuk janë parimet e shëndosha politike, por bashkimi qeveritar i grupeve të interesit, më shumë. Le të mundohemi që ta supozojmë po ashtu, që fjala e kryeministrit ishte për diçka që prej kur ia ka filluar ky mandatit si kryeministër, hajde t'i lëmë ato në mandatin e kaluar, Isa Mustafa s'paska pasur përgjegjësi, por ky po thotë, prej në janar, kur e kam marrë unë qeverisjen, çështja është mirë. Pra, prej janarit Hajredin Kuçi është ministër i mirë.

Por, problemi është tjetërkund, problemi është se për shumicën e problemeve që po fliten këtu, çështjeve që po ngritën këtu, këto janë të mandatit jo të Isa Mustafës, sa e ka në ministri Hajredin Kuçin, por janë të mandateve të kaluara. Edhe përgjegjësia është po ashtu e vendosjes së një ministri, i cili mund të mbahet përgjegjës për aq shumë gjëra të dëmshme, që i kanë ndodhur sistemit të drejtësisë prej vitit 2010. Edhe për këtë duhet të merret përgjegjësi, ma merr mendja.

Me vetë faktin se tash po kemi lavdërim të atyre çështjeve të cilat i kritikonin, kjo tregon për diktatin e vërtetë që ka Partia Demokratike mbi kryeministrin Isa Mustafa.

Do dalim te administrimi i drejtësisë nga ana... ato përgjegjësi që i ka për të shkuar puna mirë në drejtësi, si ministër Hajredin Kuçi.

Te Ligji për amnisti. Ligji për amnisti është, mendoj, një zgjidhje skandaloze për Kosovën. Vetëm shihni se çka amnistohet, aty. Sulmi kundër rendit kushtetues të Republikës së Kosovës, kryengritjet e armatosura, rrezikimi i tërësisë territoriale të shtetit të Kosovës, të Republikës së Kosovës, spiunazhi e shumë çështje të tjera.

Tash, çka do të thotë kjo? Kjo do të thotë që këta kanë miratuar ligje me përmbajtje shumë të dëmshme, por në krye të këtij procesi ka qenë ministri Kuçi. Kjo është e para.

Dhe, e dyta, kemi të bëjmë me amnistimin e veprave shumë të rënda penale, të cilët dënohen me shumë vite burg dhe amnistia është deri më 20 qershor të vitit 2013. Unë e shtroj publikisht pyetjen, këtu në Kuvend të Republikës së Kosovës, a ka ndodhur edhe pas 20 qershorit të vitit 2013, kryerja e veprave penale nga strukturat kriminale të Serbisë, në veriun e Kosovës?

Unë mendoj se kanë ndodhur. A do të gjykohen ato? Nuk po duket që do të gjykohen, për arsye se politika ka bërë marrëveshje përmbi drejtësinë. Çka do të ndodhë me ato vepra penale, pas 20 qershorit të vitit 2013?

Tjetra, unë mendoj që Marrëveshja për drejtësinë, prapë këtu e kemi përgjegjësinë e ministrit. Marrëveshja për drejtësinë, të cilën unë e kam këtu, është një debakël, një debakël i përfaqësimit politik në negociata, atje me Beogradin, më ç'rast përgjegjësi kryesor, sërish ka qenë ministri Kuçi.

Shikoni çfarë thotë pika 3, në të vërtetë pika 4: "Gjykata Themelore e Mitrovicës përfshin Zubin Potokun, Leposaviqin, Skenderajin dhe Vushtrrinë". Pra, është përfshirë një rajon prej katër

komunave goxha të mëdha të Kosovës, dy prej të cilave absolutisht shqiptare me banorë dhe, Gjykata Themelore e Mitrovicës e përbën këtë rajonin e Mitrovicës, në kuptimin gjyqësor të kompetencave të Gjykatës. Dhe tash, thuhet që... pika 6... në Kosovë, kryetari i kësaj Gjykate Themelore, që i mbulon ato katër komuna, vendos për caktimin e lëndëve. Ai është personi kryesor që vendos për caktimin e lëndëve, ky kryetari i Gjykatës Themelore, që i mbulon ato katër komuna.

Dhe, shihni çfarë na kanë sjell, nenin 13, i cili thotë: “Kryetari i Gjykatës Themelore, ky që i cakton lëndët edhe për Skenderaj edhe për Vushtri, është serb nga veriu i Kosovës”. Ky kryetari i Gjykatës Themelore që i cakton lëndët edhe për Skenderaj edhe për Vushtri është serb nga veriu i Kosovës.

Këtë marrëveshje skandaloze të drejtësisë, e cila është më keqe se në kuptimin etnik është kjo, se në kuptimin etnik janë këto ndarjet e prokurorëve dhe të gjyqtarëve, për shembull, gjyqtarë shqiptarë në pjesën veriore 10, gjyqtarë serbë 14. Në pjesën jugore, gjyqtarë shqiptarë 14, gjyqtarë serbë 11. Edhe stafi mbështetës është i ndarë 54 shqiptarë e 26 serbë dhe, në veri është anasjelltas: 54 serbë, 26 shqiptarë.

Mirëpo, këtu, kjo marrëveshje, ministri i Drejtësisë, më së pari e din edhe vetë që është kundër-evropiane, kundër konventave evropiane të mbrojtjes të drejtave të njeriut, kur ti për institucionet publike njëjtë qysh ia kanë bërë për kryetarin e Policisë, atje, për rajonin e veriut, e caktojnë që duhet të jetë patjetër serb. Dhe, jo vetëm kaq. Çka është më skandaloze, edhe ai tani duhet të jetë serb, duhet të jetë i veriut të Kosovës, edhe kryetari i Gjykatës edhe për këto komunat shqiptare.

Pra, unë mendoj se vërtet kjo marrëveshje, s’po di unë qysh ju e vlerësoni, por kjo definitivisht nuk mund të jetë në mbrojtje të sovranitetit, siç po thuhet e të gjitha këto që i dëgjova deri tash.

Tjetra është Gjykata Speciale. Unë mendoj se ministri i Drejtësisë duke qenë në krye të atij Komisioni, i cili e ka negociuar me Bashkimin Evropian, përmbajtjen e draftligjit për Gjykatën Speciale, ka përgjegjësi të drejtpërdrejtë sa i përket figurimit të nenit për gjenocidin me të cilin do të gjykohej Ushtria Çlirimtare e Kosovës, pjesëtarët e UÇK-së.

Shikoni, 16 vjet pas gjenocidit të Serbisë në Kosovë, të akuzohen shqiptarët e Kosovës, pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me një nen atje i cili thotë: “ju nuk duhet të paragjykoni, ndoshta në fund, gjetjet e Gjykatës janë ndoshta që edhe ju shqiptarët keni bërë gjenocid”. Duhet të presim të shikojmë. Kjo është e pafalshme. Kjo është përgjegjësi vendimtare për ministrin e Drejtësisë.

Dhe në fund, kam edhe një çështje shumë praktike konkrete. Unë e mbaj në mend si sot para dhjetë vjetëve kur thoshim, sistemi ynë i gjyqësisë është shumë joefektiv, 200.000 lëndë gjyqësore të pazgjidhura.

Tash në vitin 2015 ne themi janë mbi 300.000. Ky është një sistem, me të vërtetë, joefektiv dhe për këtë duhet të mbajë përgjegjësi edhe politike dikush. Po të ndodhte kjo në Perëndim, ministri moti ishte dashur të shkojë te shtëpia, por kjo po ndodh në Kosovë.

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë zoti Kuçi.

MINISTRI HAJREDIN KUÇI: S'e kam ndërmend për tjetër gjë, zoti Konjufca, por vetëm për çështjen e përmbajtjes që e the te draftligjit. Unë besoj se duhet të jemi korrekt, edhe ju edhe unë besoj, e dini, e kam thënë disa herë- draftligjin e ka sjell BE të shkruar. Ne po këqyrim çka të ndryshojmë. Po ai kurrë nuk hyn në fuqi pa e ngritur dorën ky Kuvend, kështu që nuk e ka bërë as Hajredin Kuçi, as grupi teknik që jemi 10 veta, e kanë sjell atë të shkruar, bile prej anglishtes na e kanë përkthyer. Kështu që mos i identifikoj njerëzit me gjëra të tilla. Jo unë, por asnjë shqiptar nuk besoj se e pranon këtë logjikë, kështu që mos shko me gjëra boshe, shko me gjëra konkrete, na jemi këtu dhe këtu jetojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Hajde, kundër-replikë!

GLAUK KONJUFCA: Zoti Kuçi, ju përfaqësues i Republikës së Kosovës, a mendoni që duhet ta keni fjalën e juaj qysh do të duket ky ligj apo ju pranoni gjithçka çka shkruajnë të tjerët. Edhe me këtë matet serioziteti i një zyrtari publik, i cili thotë: unë jam zgjedhur për ta mbrojtur interesin, sovranitetin e Republikës së Kosovës.

KRYESUESI: Edhe një herë, zoti Kuçi e ka fjalën.

MINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit!

Zoti Konjufca, unë bashkë me ekipin teknik i kemi dhënë 18 vërejtje që kanë qenë edhe në Komision për Legjislacion edhe i kemi qitur në opinion publik, kanë dalë edhe në Koha Ditore dhe në gazeta tjera. 18 vërejtjet ne i mbrojmë maksimalisht. Tash, krejt a i pranojmë a s'i pranojmë, në fund a votohen në Kuvend apo jo. Pra nuk mund të jetë gjenocidi dhe as unë as ju nuk duhet të pranojmë që në një ligj të jetë gjenocidi. Absolutisht, le të propozojnë çka të donë, edhe ne duhet t'i kemi do vija të trasha. Faleminderit!

KRYESUESI: Ne s'kemi hyrë në atë temë, dilni pak, se e keni bërë një kërkesë për një çështje tjetër dhe po hyni te çështja e Speciales. Edhe me atë do të merremi. Zoti Pal Lekaj e ka fjalën.

PAL LEKAJ: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryeministër, ministër,

Deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Kjo që po debatohet sot, është me rëndësi të veçantë për funksionimin e shtetit të Republikës së Kosovës. Kjo që po debatohet sot është interes vital i gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe i vetë segmentit që quhet drejtësi.

Më bëri përshtypje lavdërimi i kryeministrit, zotit Mustafa, për ministrin e Drejtësisë dhe mendoj që në anën profesionale askush nuk ka vërejtje. Mirëpo, nëse e shohim atë çka ndodh në Kosovë, mendoj që ajo që u tha këtu nuk korrespondon me interesat dhe me veprimet e Qeverisë dhe asaj ndarjes së pushteteve që ne e dimë se si ndahet dhe nuk kemi nevojë këtu për ligjërata, por mund të them lirshëm që e keni prurë gjendjen që t' i thuhet dikujt që jam ministër apo jam politikan-thotë: "ik bre prej këtu e mos të shoh me sy". Kjo është gjendja faktike e jona në Kosovë. Nëse

çdo mik i yni vjen në Kosovë dhe fjalën e parë a-në e ka korrupsionin, krimin e organizuar, mos funksionalitetin e segmentit që quhet drejtësi, mendoj që kjo s’do koment.

Dhe, nëse nisemi nga marrëveshjet ne këtu jemi për mos ndarje etnike, por vetë drejtësia ka bërë një ndarje etnike, vetë ka krijuar drejtësi etnike dhe merreni atë marrëveshje që u tha këtu në veri, a nuk tregon diçka ajo?

Nëse flasim për themelimin e Gjykatës, mendoj që m’i përkujton vitet e kahershme kur janë munduar që ndërrimi i Kushtetutës nuk është në disfavor të Kosovës, të autonomisë së Kosovës, por është dashur pas atyre ndërrimeve të Kushtetutës të bëhet luftë në Kosovë dhe të vjen ai synimi i qytetarëve.

Prandaj në këtë drejtim, unë mendoj se jemi larg synimeve. Ministri i Drejtësisë e përmendi konsensusin që vërtet ky Kuvend është për të pruar ligje. Ministri i Drejtësisë u bë peshojë analitike dhe ashtu duhet të jetë, por e kundërta flet.

Ministri i Drejtësisë e tha që ajo që Prokuroria tha se janë miratuar si hallva, por diçka e dinë qytetarët. Dhe, mund të them me një fjalë se gjithçka kemi, por nuk është guximi për të luftuar korrupsionin. Nuk është guximi që politika të heqë duart nga korrupsioni. Një qytetar më tha rastësisht në Gjakovë: “Këqyre, tutu mos i merr 10 euro se menjëherë shkon në burg, por merri sa të duash miliona dhe askush nuk merret me ty”.

Këtu e kemi pru gjendjen dhe këto i kemi peshqesh të atij mos guximi të Qeverisë dhe atyre që e kanë përgjegjësi të merren me luftimin e krimit të organizuar, të korrupsionit dhe për ta vë një gurthemel të shtetit, që quhet Republika e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Shala e ka fjalën!

HAXHI SHALA: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryeministër,

Kemi pritur nga ju që çështja e drejtësisë të ketë prioritet në Qeverinë tuaj, por deri më tash nuk është parë asnjë veprim nga ana e juaj si kryeministër. Kur e themi këtë, besoj se kemi të drejtë dhe unë si deputet dhe qytetar i Republikës së Kosovës, sepse në vendin tonë nuk ka dhe nuk është krijuar asnjë sistem i qartë i drejtësisë. Dhe edhe e kemi një sistem në letër, ai keqpërdoret për interesa të pushtetarëve dhe në dëm të qytetarëve tanë.

Për këtë arsye të mosfunksionimit të një sistemi të mirëfillt të drejtësisë, sot në vendin tonë ka lulëzuar ose me atë fjalën popullore: është pjekur korrupsioni i cili do të na marrë kohë për ta çrrënjësuar këtë dukuri të keqe në vendin tonë.

Sot, në të gjitha konferencat, takimet që i kemi si deputetë me përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare të gjithë shkurt e qartë na thonë: luftone korrupsionin sepse nuk ka liberalizim të vizave si një gjë elementare për lëvizjen e lirshme të qytetarëve tanë e lere më të mendojmë për anëtarësim në BE.

Edhe sot unë dhe qytetarët e Republikës së Kosovës nuk kemi besim që ju si kryeministër dhe Kabineti i juaj nuk keni treguar së paku që keni një vullnet politik për të luftuar korrupsionin dhe për të shkapur shtetin nga individë të caktuar, e në veçanti në sistemin e drejtësisë ku përgjegjës kryesor për ardhjen e shtetit tonë në këtë gjendje është pikërisht kapja e sistemit i drejtësisë dhe mosfunksionimi i drejtësisë në standarde demokratike.

Zoti kryeministër,

Nuk kam dashur të lëshohem në skandalet që kanë ndodhur në sistemin gjyqësor, se çdo qytetar i Republikës së Kosovës e din, por kërkoj nga ju si kryeministër i vendit, me një moshë para pensionit që të bësh një vepër të mirë, që të mbahesh në mend për së miri nga qytetarët e Republikës së Kosovës. Me të vërtetë do të jesh një kryeministër i guximshëm t'i shkarkosh ministrat e papërgjegjshëm që i ke në Kabinetin tuaj, e jo me presione dhe protesta të marrësh vendime të tilla, sepse atëherë do të mbahesh në mend si kryeministër i dështuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Salih Salihu e ka fjalën.

SALIH SALIHU: Unë e dëgjova me vëmendje fjalën e kryeministrit, i cili po flet me admirim për Qeverinë aktuale, sidomos për ministrat e PDK-së, ndërkaq nuk e kam qare pa e lëshuar një deklaram të kryeministrit aktual kur e ka bërë para fushatës dhe është me interes për qytetarët e Republikës së Kosovës, por edhe për kolegët këtu që të dëgjojnë këtë deklaram dhe besoj se kryeministri më pastaj na tregon se cili nga këto deklarime është real, është i saktë, do të thotë, për deklarimin që e ka bërë para zgjedhjeve dhe për deklarimin e tanishëm që e bën për ministrat e vet.

“Kjo qeverisje, në një formë e ka ngulfatur shtetin, e ka kapur shtetin, e ka lëshuar rrjetin e strukturave aq thellë nëpër tërë organizimin, edhe në media, edhe në kompani publike, edhe në institucione qeveritare, edhe në agjenci, edhe në polici, edhe në Prokurori, edhe në gjyqësi dhe ne s’do të bëjmë... në qoftë se ne edhe më tutje vazhdojmë të qeverisim me ta, se pastaj ata qeverisin në rrjetin e tyre dhe ne do të jemi...”.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ndërpreje. Atë e kemi dhënë në televizion dhe tash nuk ka nevojë e as kuptim për ta bërë këtë.

(Reagime)

Vetëm një sekondë. Nuk ka kuptim, jemi kolegë. Jo, jo s’ka kuptim dhe nuk e lejoj.

Salih, a do të vazhdosh diskutimin, apo do ta lëshosh prapë atë? Veç, të lutem, atë mos e lësho më! Le ta kryen ai, e pastaj ju. Urdhëro, vazhdo Salih, por mos lësho ato incizime, sepse prapë ta ndaloj.

SALIH SALIHU: Deklarimi është në emisionin “21 Clilk”, që e shikojnë tërë qytetarët e Kosovës.

KRYESUESI: Mirë de, ne e kemi parë!

SALIH SALIHU: Posti i kryeministrit është post publik dhe unë mendoj se ka përgjegjësi publike dhe duhet të përgjigjet para qytetarëve se cila deklaratë qëndron. Nuk ka asgjë të keqe këtu, ne e kemi përgjegjësi ndaj qytetarëve të Kosovës.

KRYESUESI: Zoti Beqiri, e keni fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Sigurisht çdo metodë, nuk po them që s'lejohej, edhe e tillë çfarë po e përdor Salihu, po unë e kam një lutje tash publikisht: Sillni incizimin që ju "Vetëvendosja" keni incizuar në zyrën time. Ju e sillni incizimin në zyrën time me emër Egzon Azemi, që më ka incizuar, është aktivisti i juaj. Dhe përdorni edhe këto.

Nuk mohohet e drejta juaj për të lëshuar gjëra të tilla. Sillni incizimin që është në polici që ai më ka incizuar në zyre. Dhe kjo është e turpshme! Kjo lidhje nuk ka me deputetllëk. Unë po flas për veti. Me cilën të drejtë ka ardhur në zyrën time për të më incizuar?! Mos, mos u merrni me këto gjëra.

(Ndërhyrje)

KRYESUESI: Unë ju kisha lutur që mos të hyni në këso polemika me njëri-tjetrin sepse secili këtu ka bërë diçka fushata, kundër njëri-tjetrit, kështu që edhe brenda llojit kemi bërë kundër njëri-tjetrit ngapak, edhe kundër partive ngapak, kështu që më mirë mos t'i kemi tash ato. Fjalën e ka Teuta Haxhiu!

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Për atë që njerëzit i thonë, nuk duhet me i ra pishman. Prandaj ia vlejti ta dëgjojmë edhe atë fjalë të kryeministrit.

Ndonëse kemi hyrë në vitin e tetë të pavarësisë së Kosovës, pavarësi kjo që përveç tjerash nënkupton edhe pavarësinë e të gjitha pikëpamjeve të organizimit të mirëfilltë shtetëror dhe zhvillimin e tij, si domosdoshmëri bazike për të qëndruar në këmbët tona, për fatin më të keq një gjë e tillë nuk po ndodh.

Dëshmitë për këtë gjendje alarmante tashmë janë bërë të panumërta, edhe në nivelin ndërkombëtar edhe në atë vendor e qytetar, shifrat flasin për një gjendje të zymtë që e ka kapluar vendin.

Në rastin më të keq, Qeveria e Kosovës, përkatësisht kryeministri që në fakt është mekanizëm kryesor dhe përgjegjës për kontrollin dhe bashkëpunimin e punës së anëtarëve të Qeverisë, me secilin institucion qeveritar, nuk ka bërë asgjë në luftimin e këtyre dukurive, që në jetën e qytetarëve të vendit po bëhen gjithnjë e më të rëndë dhe të pamundur.

Krimi i organizuar sot, më shumë se kurrë është i pranishëm brenda vetë institucioneve shtetërore. Niveli i lartë i korrupsionit pothuaj se në të gjitha fushat e shoqërisë sonë, sidomos në disa nga segmentet kyçe të zhvillimit është shndërruar në një akt të kryer edhe para

ndërkombëtarëve, ndërsa tek qytetarët është betonuar bindja se korrupsioni për një kohë të gjatë ka prekur edhe hierarkinë më të lartë të institucioneve shtetërore, bindje e cila po vërtetohet çdo ditë e më shumë përballë neglizhencën e pakuptimtë të vetë Qeverisë dhe kryeministrit ndaj këtyre dukurive shkatërrimtare.

Këto të meta janë evidentuar edhe shumë herë në Raportin e Progresit dhe nga ish kryeministri Thaçi dhe tani nga kryeministri Mustafa asnjëherë nuk “e çan kokën”.

Në institucionet publike në përgjithësi nuk është rregulluar asnjëherë juridikisht dhe nuk përfilllet parimi i transparencës e veçanërisht i llogaridhënies. Thënë shkurt e shqip për Qeverinë e Kosovës nuk ka ligj, por vetëm akt qeveritar të nivelit nënligjor, sekondar dhe pa bazë ligjore.

Sot, në Kosovë institucionet e sistemit të drejtësisë, përkatësisht të judikaturës ndodhen nën influencime, madje trusni të fuqishme, veçanërisht të ekzekutivit dhe prandaj nuk mund të jenë të pavarura, të drejta, apolitike, të paanshme e as të sigurojnë qasje të barabartë në Gjykatë a Prokurori.

Prandaj, sot as prokurorët, përkatësisht gjykatësit e caktuar nuk mund të jenë as të pavarur dhe të devotshëm për ligjin e aplikuar, as të paanshëm gjatë ushtrimit të funksioneve të besuara.

Krimi i organizuar, ekonomia joformale dhe korrupsioni në Kosovë, sot janë bërë dukuri dhe po i largojnë investitorët potencialë nga vendi.

Nga fjala e kryeministrit dhe ministrit të Drejtësisë, sikur të ishte ashtu, ne si vend dhe si Qeveri e Kosovës do të ishim model edhe për shtetet e Evropës. Por, realiteti dhe qytetarët e kanë krejt një pamje tjetër, andaj ju lutem, është momenti i fundit që një herë të vendosni dhe të thoni se dikush duhet të japë llogari. Në këtë rast ministri i drejtësisë kishte mund të tregojë një gjest shumë të mirë në qoftë se jep dorëheqje ose më mirë e shkarkon vetë kryeministri. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Berisha e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Po flasim për një çështje të ngritur në formë mocioni, që e preokupon shoqërinë që nga pas lufta.

Në fakt drejtësia në Kosovë është vazhdimësi e dështimit të drejtësisë edhe atëherë kur e kishin ndërkombëtarët, por ajo që e karakterizon këtë fushë është se elementet destruktive, korruptive, keqmenaxhuese të ndërkombëtarëve që janë quajtur UNMIK, me mjeshtri janë bartur te organet e drejtësisë së vendit dhe që për mendimin tim ministri në fjalë është dashur të jetë më azhur dhe më profesional që ta bëjë një shkëputje, sepse ky fenomen i kombinimit të politikës, drejtësisë dhe mafisë që kanë ndodhur në vitet e 70-ta, e 80-ta në Itali e që për fat të keq në vitet e 90-ta kanë qenë me një tryezë edhe në Shqipëri, si model është bart në Kosovë dhe jo rastësisht e kemi këtë situatë që e kemi ku të gjitha raportet ndërkombëtare, por edhe të shoqërisë civile, flasin për korrupsionin e lartë që është në drejtësinë e Kosovës e cila është bërë pikë e zezë edhe në pretendimet e arsyeshme të qytetarëve për integritet në struktura evropiane.

Te them të drejtën, kur e dëgjova kryeministrin, aq e lavdëronte dhe e mbronte Hajredin Kuçin, që as vetë Adem Grabovci që ka obligim ta mbrojë, nuk e mbrojti aq, por edhe vetveten ministri s'mund e mbrojti. Mu kujtua maji i vitit të kaluar që një kolegë e kishte, do të thotë, një fjalim të kryeministrit dhe kur ka folur për kapjen e shtetit, për korrupsionin, në majin e vitit të kaluar, a e ka pasur fjalën edhe për Hajredin Kuçin, apo ky ka qenë i ndarë prej asaj Qeverie për të cilën keni folur dhe kërkuar besimin nga qytetarët.

Sido që të jetë, unë po mendoj se kulmimi i keqqeverisjes në këtë fushë është me Gjykatën paralele në veri, që ministri ka treguar jo profesionalizëm dhe të them të drejtën ajo që mua më bën , përkundër jaranisë së vjetër që kemi pasur dikur, të kem qëndrim tepër të qartë deri në largim nga ky pozicioni – fjala e tij rreth Gjykatës Speciale, ku ka thënë se nuk garantoj barazi.

Të them të drejtën, një ministër që e llogarit veten profesionist dhe e di që një institucion që do të merret, gjëja me “drejtësinë” nuk garanton do të thotë barazi dhe është pjesë e skenarit për ta realizuar atë, kjo më bën shqetësuese dhe vë në pikëpyetje e dilemë, domethënë, sinjeritetin e ministrit, prandaj me të drejtë opozita ka kërkuar skajimin nga pozicioni i ministrit, me qëllim që duke e skajuar nga pozicioni për të dhënë shenja pozitive edhe karshi miqve ndërkombëtarë se Kosova dalëngadalë ka filluar të kthehet në binarët e jetës normale dhe ata që keqmenaxhojnë, ata që nuk qeverisin, ata që legalizojnë krimin dhe korrupsionin, ata që janë pjesë të krimit dhe korrupsionit, do të thotë do të gjykohen dhe do të dënohen, kështu që mocioni i opozitës ka për qëllim që t'ua rikthejë normalitetin institucioneve të vendit dhe t'ua rikthejë edhe imazhin e dëmtuar mjaft nga kjo keqqeverisja në vend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hajdar Beqa e ka fjalën.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës!

I nderuar kryeministër i Republikës së Kosovës, i nderuar ministër Kuçi,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sistemi i drejtësisë është sfidë në çdo shtet e në veçanti në shtetet që dalin nga lufta dhe kalojnë fazën e tranzicionit, siç e ka kaluar vendi ynë si shtet i ri.

E shqyrtova me vëmendje tekstin e parashtruesve të interpelancës, por një dua ta kemi parasysh se ndarja e pushteteve në Republikën e Kosovës, është rregulluar me Kushtetutën e këtij vendi, ku kemi tri pushtete. Kemi pushtetin legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, dhe të tri këto pushtete kanë të garantuar me Kushtetutën e këtij vendi që ta kryejnë punën e vet në formën më të pavarur të mundshme dhe nuk kanë mundësi që të interferojnë njëri pushtet në tjetrin me pavarësi të plotë.

Shumë pika në këtë tekst nuk kanë të bëjnë me përgjegjësinë e ministrit të Drejtësisë. Unë do t'i them vetëm disa, si për shembull cilat masa i shqyrtojnë gjykatat, respektivisht lartësia apo forma e dënimit është kompetencë ekskluzive e paneleve gjyqësore, e jo e ministrave të drejtësisë. Në përgjithësi ministrat e drejtësisë apo ministrat tjerë duhet të ftohen nëse interferojnë në masën e dënimit, nëse interferojnë në sistemin e gjyqësisë e jo në të kundërtën nëse nuk i kalojnë kompetencat e veta.

Çështja e privatizimit, nuk mendoj se ka të bëjë asgjë me ministrin përkatës, në këtë rast me ministrin e Drejtësisë. AKP-ja është një Agjenci e pavarur e cila ka bordin e vet dhe menaxhmentin e vet dhe të gjitha përgjegjësitë, nëse i kanë shkelur ligjet, hartuesit e këtij testi duhet t'i ndërtojnë aktakuzat dhe t'u drejtohen organeve kompetente për shkelje të ligjeve, ne e dimë që kemi prokuroritë dhe gjykatat dhe mund të shkojmë aty ku duhet të shkojmë.

Sa i përket te ligjit, që e pashë, dhe ligjet që janë aprovuar nga ky Kuvend, unë mendoj që në këtë rast nëse sponsorizuesi i ligjeve, respektivisht Qeveria e Republikës së Kosovës apo edhe Ministria e Drejtësisë, nëse bien ligje jo të kompletuara apo ligje të dobëta, ne si deputetë për këtë jemi këtu, për këtë kemi kërkuar votën e qytetarëve të vendit dhe duhet të jemi të përgjegjshëm që ato ligje t'i përshtatim me kërkesat e qytetarëve të vendit tonë dhe t'i bëjmë ligje funksionale, ligje që e rregullojnë jetën dhe janë në favor të qytetarëve të vendit tonë dhe përgjegjësia është edhe e ne deputetëve, e kam fjalën te Ligji për amnisti, sepse ai ligj këtu ka kaluar me votën e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Sa i përket Gjykatës Speciale, nëse ndodh, ne e dimë të gjithë këtu se aty duhet të kemi edhe ndryshime apo amendamente të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe ajo nuk mund të ndodhë pa një konsensus politik dhe nëse ndodh ajo Gjykata Speciale do ta ketë mbështetjen edhe të parashtruesve të kësaj rezolute, në këtë rast të opozitës së Republikës së Kosovës.

Me këtë rezolutë dhe kur e shohim tekstin e rezolutës nuk kam parë asgjë tjetër më shumë se sa opozita ia ka shpjeguar apo i ka përshkruar kompetencat e kryeministrit që i ka në Kushtetutë dhe unë mendoj se kryeministri i vendit i di ato kompetenca, por nuk kanë marrë asnjë bazë të arsyetimit. Pra, këto arsyetime të tua më shumë kanë të bëjnë për ndonjë ndërtim të ndonjë aktakuze sesa për debat parlamentar dhe kurrkush nuk e pengon askënd si deputetë, as si opozitë, as si grup t'u drejtohet organeve të drejtësisë në këtë vend se sa të bisedojmë për disa çështje që, ndoshta edhe nuk janë kompetente e jona, sa janë kompetencë e gjykatave dhe të prokurorive.

Si deputet i këtij vendi pajtohem me atë se ne duhet të angazhohemi të gjithë më shumë për përmirësimin e infrastrukturës ligjore, që të kemi një sistem të drejtësisë edhe më efikas, edhe me një pavarësi të plotë të veprimtimit të bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Mendoj se ministri, karshi situatës, gjendjes, zhvillimeve që i kemi ne në vend, me sukses e ka kryer punën e vet si ministër i Drejtësisë, por megjithatë pajtohem se ka vend që të gjithë, edhe ministri i Drejtësisë, Qeveria, kryeministri, por edhe të gjithë ne të angazhohemi më shumë për një jetë më të mirë për qytetarët e vendit tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Daut Haradinaj e ka fjalën.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryesues!

Kryeministër, ministër,

Po çuditë se shumë të dobët, zoti ministër, e ke gjetur zëdhënësin, Hajdar Beqa dhe nuk mendoj se të përfaqëson mirë, por është e drejtë e juaja.

Po ndalem pak dhe po i referohem fjalës tënde të mëhershme. Ismet, të dëgjova me kujdes, parëz.

E the në fillim se partitë opozitar në legjislaturën e kaluar rreth 50 apo 70 ligjeve u kanë dhënë besim. A mendon që është gabim, apo kanë bërë drejt?

Thatë se kur është zgjedhur kryeprokurori i shtetit, edhe këtu, në këtë sallë ka pasur guzhmim. Kujt u referove, zoti ministër? Në kë aludove? Edhe ti nëse je përzier, kah i more këto informata?

Më pëlqeve kur the i kemi dorëzuar 18 rekomandime e ato nuk janë pranuar dhe do të isha njeriu më i lumtur nëse kjo Gjykatë nuk kalon. Për Gjykatën Speciale, a je duke folur në emër të Qeverisë apo personale, sepse këtë dallim nëse mund ta bëni.

Është në dorën tuaj se si do të vendosni. Me sa unë jam i vetëdijshëm, dhe unë nëse jam duke jetuar në Kosovë dhe po i besojmë këtyre transmetimeve të drejtpërdrejta, sepse zakonisht portaleve më pak, ju jeni duke iu lutur, duke u bërë apel jo vetëm deputetëve të pozitës që i keni shumicë, por po kërkon edhe nga deputetët e opozitës, siç tha edhe zoti Hajdar Beqa, për t'u dhënë besim.

Ndërsa, para pak minutash ju thatë: “Do të isha njeriu më i lumtur nëse kjo gjykatë nuk votohet”. Dhe, sa më përket mua, unë jam i gatshëm qysh sot dhe me çdo çmim të përgjigjem për këtë temë.

Do të thotë këtu ka një kontradiktë. Është e vërtetë që janë bërë punë të mëdha, edhe pakot ligjore të cilat i thatë, mbi 70 ligje, edhe ajo është një infrastrukturë ligjore, një bazë e mirë ligjore. Shpresoj se edhe ato që i tha kryeministri do të jenë në perspektivë.

Edhe ne si opozitë i gëzohemi lajmeve të mira në Kosovë, të arriturave të cilat i arrin Qeveria e Kosovës, sepse në fund të fundit ne të gjithë jetojmë këtu në Kosovë, por nuk duhet t'u buzëqeshemi të këqijave që po na ndodhin, dhe askush të mos tentojë të paraqet se Gjykata Speciale është në të mirën e Kosovës. Është absolut e padrejtë, nuk është në të mirën e Kosovës.

Në rast se ne kemi krijuar ligje për amnistinë e pjesëtarëve të veriut, të cilët na i kanë djegur pikat e kufirit, si qenka mirë atëherë që ne të krijojmë kushte të reja juridike jashtë Kosovës për t'i gjykuar pjesëtarët e UÇK-së.

Mendoj se ju jeni të vetëdijshëm për këtë punë. Natyrisht se presioni ndërkombëtar është, dhe është krejt e vërtetë, e ne nuk ta bëjmë me gisht vetëm ty, por ju jeni titullari i parë i negociatave të kësaj fushe.

Për këtë arsye, edhe një herë po them, shumë t'u kisha lutur - qëndrimin parëz a e pate personal apo fole në emër të Qeverisë? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë Hajdar Beqa.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetar!

Nuk e dëgjova mirë zotin Haradinaj çka tha, diçka dëgjova, jo zëdhënës, nuk e ka përfaqësuar mirë apo mbrojtur mirë. Mendoj se ne po themi diçka çka është reale dhe mendoj shumë më

dobët është ajo çka po thotë zoti Haradinaj pra teksti i kësaj rezolute se sa atë çka po e themi ne, sepse atë që e thamë ne u bazuam në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe në detyrat që i ka secili dikaster veç e veç, në këtë rast Qeveria dhe ministrinë përkatëse. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Haradinaj, paraqitet për kundër-replikë.

DAUT HARADINAJ: S'e kuptova zotin Beqa. Faleminderit, zoti Beqa!

KRYESUESI: Zoti Shqip Muja e ka fjalën.

SHAIPI MUJA: Faleminderit, zoti kryesues!

Për të biseduar për problemin e drejtësisë mendoj se duhet ta kuptojmë definicionin e drejtësisë dhe drejtësia është pjesë integrale e sistemit ligjor.

Drejtësia është e lidhur ngushtë me ligje ose vetë ligjin, është e drejtë. Prandaj para se ta diskutoj kuptimin dhe përkufizimin e drejtësisë, është e nevojshme për të parë në Ligjin e drejtësisë apo ligjin. Drejtësia ligjore është e përbërë nga dy aspekte: njëra është ligjmarrja mbi drejtësinë, drejtësia mund të quhet legjislacion, i dyti është zbatimi i drejtësisë ligjore.

Të gjitha këto, nëse mbesin në lajthitje, quhen gënjeshtër apo lojë fjalësh. Prandaj shumë herë kemi dëgjuar edhe nga pala mbrojtëse e legjislacionit, lojë fjalësh dhe nganjëherë edhe nga goditjet tona, jemi quajtur se po godasim nën brez.

Se drejtësia ka dështuar, ka një emër dhe ajo tregon vetë aktet ndërkombëtare që janë duke u marrë sot me Republikën e Kosovës, 8 vjet pas pavarësisë, dhe ne e kemi një emërim. Nëse Gjykata Speciale po formohet është se ne kemi marrë vlerën se drejtësia nuk ekziston në Kosovë dhe nuk funksionon drejt, prandaj duhet t'i nënshtrohem mekanizmave ndërkombëtar.

Nëse ministri i Drejtësisë ka deklaruar se unë nuk jam personalisht ta votojmë Gjykatën Speciale ose këto, duhet të tregohet dhe jo të bëhen ndasitë se me votën e kujt kaloi gjykata dhe me propozimin e kujt nuk kaloi.

Para disa ditësh, ministri tha për krimet e luftës. Ne mund të ngremë aktakuzë edhe për ata që kanë bërë krime të luftës në Republikën e Kosovës. Ashtu sikur që po e menaxhojmë ne Kosovën nuk është larg mendësh që Serbia do të dalë e dëmtuar në Kosovë nga vetë sjellja jonë, sepse themi që dëshmitarët nuk janë këtu, se aktorët nuk janë këtu.

Pavarësisht asaj, në mungesë mund t'i ngrihet aktakuza secilit dhe mund të kërkohet ndihmë ndërkombëtare dhe të ballafaqohen faktet. Prandaj, shumë të vërteta ka, të cilat jemi duke i humbur dhe jemi duke i humbur përgjithmonë dhe në këtë mënyrë Serbia mund të dalë shumë më e dëmtuar nga Republika e Kosovës se sa që na ka dëmtuar neve faktikisht, në faktorin ndërkombëtar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës, të përfaqësuar nga krerët e këtyre dy institucioneve publike, që menaxhojnë sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës, kanë marrë pjesë aktivisht në procesin e negociatave me Serbinë.

Të njëjtit kanë qenë të përfshirë edhe në procesin e lidhjes së marrëveshjes në Bruksel, më 19 prill 2013 ku si pasojë e kësaj marrëveshjeje u nxorën dy ligje - Ligji për amnistinë dhe Ligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për buxhetin e vitit 2013 për Fondin zhvillimor për veriun.

Ligji për amnisti, si rrjedhojë, është sponsorizuar dhe përgatitur nga Ministria e Drejtësisë. Si i tillë, ligji madje është kontestuar nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” për shkak se ligji i tillë ka cenuar të drejtat subjektive të palëve të dëmtuara dhe ky ligj është kontestuar në Gjykatën Kushtetuese.

Mirëpo, këtu problemi qëndron në faktin se kryetari i Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, mbi të cilën bazë kushtetuese dhe ligjore krerët e këtyre dy institucioneve kanë marrë pjesë në procesin e negociatave, me kërkesë të Qeverisë dhe me vendim të organeve të tyre.

Këtu shtrohet pyetja më e rëndësishme - cili ka qenë roli i ministrit të Drejtësisë si anëtar i Këshillit Prokurorial në vendimmarrjen e KPK-së për pjesëmarrjen e kreut të këtij institucioni në procesin e negocimit, si në Marrëveshjen e Brukselit të vitit 2013 ashtu edhe në marrëveshjen e fundit për drejtësinë.

Tjetra çështje që dua të shtroj, është ajo që ka të bëjë me Fabrikën e Amortizatorëve. Pasi kryeministri mohoi se është në dijeni për çfarëdo implikimi të ministrit të Drejtësisë në procesin e privatizimit e veçanërisht në procesin e privatizimit të Fabrikës së Amortizatorëve, mjafton të përmendet fakti i dyshimit të pretenduar për ndikimin e ushtruar nga ministri i Drejtësisë tek rasti i hetimit të këtij rasti.

Për këtë kanë dëshmuar edhe përfaqësuesit e Sindikatës së punëtorëve të Fabrikës së Amortizatorëve, ku kryetari i kësaj Sindikate ka deklaruar: lëndën në EULEX e kanë dërguar që prej vitit 2011. Gati katër vjet dhe katër prokurorë janë ndërruar, por edhe pse kanë thënë se janë duke punuar asgjë deri më sot nuk ka ndodhur, ka rrëfyer Morina, duke iu referuar prokurorëve Joachim Stollenberger, prokurorit të dytë, Miroslav Petkiçek dhe prokurores së tretë Maria Bamie.

Morina përmend Hajredin Kuçin për zvarritjen dhe pengimin e hetimeve, ndërkaq kreu i Sindikatës, Enver Morina ka edhe emra përgjegjës që kanë penguar drejtësinë për ta hetuar privatizimin e Fabrikës së Amortizatorëve.

Njëri prej tyre sipas Morinës është ministri i Drejtësisë, Hajredin Kuçi. Një prokuror i quajtur Joachim Stollenberger, i cili tashmë ka shkuar por që ka qenë prokuror i parë që e ka marrë lëndën, më ka thënë se që 14 muaj nuk ka guxuar të nxjerrë lëndën me direktivë të ministrit të Drejtësisë, Hajredin Kuçi.

Pra, ministri i Drejtësisë, duke e shfrytëzuar pozitën e anëtarit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, madje ka dyshime për ndikim dhe keqpërdorim të detyrës zyrtare, pengimin e hetimeve dhe ndjekjen penale.

Dhe e treta, që dua të shtroj këtu është edhe çështja e...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! I keni kryer minutat! Zoti Kuçi, replikë!

MINISTRI HAJREDIN KUÇI: Zoti Topalli,

Lëre pak atë kompjuter e këqyr. Po më vjen marre që ke jetuar në Zvicër e mendon me kësi mentaliteti. Këqyrëm në sy. Kurrë në jetë, ata kurrë në jetë, as nuk i njoh, as në filma të Hiçkokut, mundesh t'i shohësh. Nuk merrem unë me ato hetime. Dhe po ta them një: Nëse në këtë vend dikush ka hetime, urdhëro tregona o burrë, se për të filluar hetimet, dhe të thuash 4 prokurorë të EULEX-it i ka ndal dikush, ai qenka Spaindermen, apo çka tek është? Mos, bëni hajgare!

Nëse ke fakte, shko në prokurori, shko ku të duash. Mos fol, po të lutem, me fjalë të rrugëve. Po të flasësh çka flitet nëpër gazeta duhet “me të qit në top”.

KRYESUESI: Kundër-replikë, zoti Topalli!

FATON TOPALLI: E para, këto që i deklarova, janë deklaratat e përfaqësuesve zyrtarë të Fabrikës së Amortizatorëve.

E dyta, rastet i kanë dorëzuar në prokurori.

Dhe e treta, zoti Kuçi, mos kërkoni nga unë si deputet të merrem me Prokurorinë, sepse po flas në organin më të lartë të këtij vendi, po flas në Kuvendin e Kosovës.

Prokurorët duhet të ngritën në këmbë kur deputetët flasin dhe t'i hetojnë rastet. Ajo që nuk mu la të them, është se ju jeni tre persona këtu që jeni përgjegjës për mos pagesën e parave të punëtorëve të Fabrikës së Gypave, për të cilën ekziston një vendim i organit më të lartë, të Gjykatës Kushtetuese.

Të tretë keni premtuar, si gjatë fushatave, si ndryshe që do të kërkoni të paguhen sepse ekzistojnë të gjitha vendimet për këtë çështje dhe deri më tani asnjëherë nuk e keni realizuar këtë çështje.

Vetë kryeministri aktual i Kosovës ka deklaruar po në këtë foltore, duke ua bërë gjyqin punëtorëve të Fabrikës së Gypave se nuk i paguajmë paratë. Si ka mundësi që kryeministri ta shkelë ligjin, ta shkelë vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Pra, këtu po shihet se sa është i kapur shteti nga politika. Ky është një...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka, i fundit, zoti Enver Hoti!

ENVER HOTI: Faleminderit, kryesues!

Unë derisa e dëgjoja ministrin pak për relaks, jam kanë duke filluar të duartrokas në fjalën e ministrit, por sigurisht duke iu referuar gjendjes dhe asaj që e kemi në sistemin e drejtësisë, duhet t'i referohem asaj thënies popullore: "Rrofshin fjalët, e punët qysh të vijnë".

Unë do të kthehem pak për mbrapa, se ndikimi i politikës në sistemin e drejtësisë e ka një zanafillë dhe bukur një bazament të fortë, sidomos nga viti 2008 në koalicionin PDK dhe LDK dhe nuk është aspak befasi për mua kur këtu dy parti e mbrojnë ministrin aktual, sepse atëherë janë ndarë pozitat në sistemin e drejtësisë, prandaj, edhe si përfaqësohen nuk ka kurrfarë vetë iniciative nga Prokuroria për të kryer hetime të paanshme dhe efektive.

Unë do të doja të shkoqis disa çështje tjera, që nga ajo kohë, janë vënë bazat e korrupsionit dhe të komprometimit në të gjitha nivelet e qeverisjes, të cilat kanë vazhduar me keqpërdorimin e pozitave zyrtare, ngritjen dhe fuqizimin e ekonomisë jo formale, tjetërsimi i pronave publike në të gjitha nivelet e Qeverisë, korrupsioni dhe monopolet e krijuara, janë fuqizuar dhe po vazhdojnë çdo ditë dhe nëse i referohem edhe dokumenteve të auditimit këtu po ua jap edhe një përgjigje të nderuar qeveritar se po thonë që deputetët duhet t'i dërgojnë në prokurori lëndët.

Unë mendoj se raportet e auditimit janë të mjaftueshme që Prokuroria të veprojë. Por, këtu shihet qartë se ka ndërhyrje politike dhe nuk veprohet dhe aq shumë ndërhyrja politike ia ka zënë frymën sistemit të drejtësisë sa që po shihet se edhe në Pallatin e Drejtësisë ka vazhduar kjo frymë të bartet atje dhe atje u është zënë frymëmarrja nga korrupsioni dhe nga ndërhyrjet politike në Pallatin e Drejtësisë, është një projekt që është realizuar sikur që e përmendi, mu duk më herët, ministri i Drejtësisë dhe e përgëzoj për atë angazhim që e ka bërë atje, por po shihet në çfarë mënyre, në çfarë standarde dhe në çfarë niveli gjendet i gjithë sistemi, pra me një frymëmarrje të nxënë nga korrupsioni dhe nga ndërhyrjet politike.

Edhe një pyetje ministër, besoj se nuk do të ndjeheni mirë për gjendjen çfarë është në sistemin e drejtësisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Konsideroj se është shteruar debati i deputetëve. Zoti Kuçi ka edhe një replikë.

MINISTRI HAJREDIN KUÇI: Zoti Hoti, mbasi u relaksove, edhe unë po them kështu, dhe e dëgjova edhe Zafirin më herët, po e përmendi. Po thotë, kemi qenë miq dikur. Besoj se jemi hala miq dhe nuk është befasi se një 13 – 14 vjet i kemi rrah aplauz njëri-tjetrit sa herë kemi folur. Mirëpo, edhe me pas ndodhur sot, s'është kurrëgjë.

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zoti Hoti!

ENVER HOTI: Unë mendoj se duartrokitjen do ta meritonte në formë të elegancës dhe retorikës që e paraqiti, por punët nuk janë për duartrokitje. Faleminderit ministër!

KRYESUESI: Zafir, ke edhe di diçka të thuash? Një minutë e ke!

ZAFIR BERISHA: Unë nuk e përjashtoj që kemi qenë bashkë, bile së paku për duartrokitje asnjëherë nuk kam qenë i shquar, por të ishit burra të mirë isha unë në PDK dhe do të duartrokitsha ende.

KRYESUESI: Pra, debati është shterur. Tani është fjala përfundimtare e zotit kryeministër në fillim dhe pastaj e propozuesve, respektivisht propozueses ose përfaqësueses së kërkuesve për interpelancë. Zoti kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar zëvendëskryeministër, ministra,

Unë mendoj se debati i cili është zhvilluar sot, pa marrë parasysh kërkesën, përkatësisht propozimin e Rezolutës, flet për interesimin tonë që ne të forcojmë shtetin ligjor, të forcojmë sistemin e drejtësisë, të luftojmë korrupsionin, krimin e organizuar, sepse nuk shoh asnjë dallim dhe asnjë interes të asnjë deputeti dhe asnjë grupi parlamentar këtu, që këtë mos ta bëjmë bashkërisht.

Sa i përket kërkesës për shkarkim të ministrit Kuçi, unë mendoj se po që se unë do ta vlerësoja këtë dhe se kjo është zgjidhja për përparimin e sistemit të drejtësisë tek ne, dhe se kjo do ta forcojë shtetin ligjor dhe do të krijojë kushte që të punojmë ndryshe, unë do të ulesha dhe do të merresha vesh me partnerin e koalicionit që ne ta bëjmë këtë në interes të shtetit. Por në asnjë rast, argumentet të cilat janë dhënë këtu nuk më bindin as mua, as s'mund të ju bindin as juve, se problemet të cilat ne i kemi në funksionimin e sistemit të drejtësisë janë probleme të cilat lidhen me personalitetin, në fuqinë shtetërore dhe me fuqinë politike të ministrit të Drejtësisë.

Në qoftë se ne themi këtu se kur të flas unë duhet të çohet prokurori në këmbë, ajo flet se ne nuk e respektojmë pavarësinë e shtyllës së drejtësisë, sepse ata duhet të na rrinë neve gatitu. Ata s'janë për të na ndenjur neve gatitu këtu, por ata janë që t'i zbatojnë ligjet të cilat ne i bëmë pa ndërhyrje të drejtpërdrejtë tek këta. Prandaj ne duhet t'i sqarojmë.

Kjo vlen edhe për ministrin. Ministri e kryen punën e tij në fushëveprimin e vet dhe unë jam i bindur se ministri po e bën këtë punë dhe po e kryen këtë punë. Por, jam i bindur po ashtu që gjyqësia duhet ta bëjë shumë punën më të mirë të veten se sa që po e bën tash, se Prokuroria po ashtu duhet ta bëjë punën më mirë dhe se në qoftë se shtrohet pyetja se a qëndroj prapë asaj që kam thënë më parë, unë ju them se qëndroj. Sepse ne duhet ta çkapim këtë shtet, duhet të mundësojmë që prokurorët dhe gjyqtarët të mos jenë të lidhur, që ata ta bëjnë punën në mënyrë të pavarur, që ata ta realizojnë dhe kryejnë funksionin e vet dhe që po ashtu ministri i Drejtësisë dhe Ministria e Drejtësisë, ta bëjë punën e vet, sepse këta nuk mund t'i diktojnë Gjykatës dhe t'i diktojnë Prokurorisë se çfarë ata duhet të bëjnë.

Në qoftë se mendojmë se ashtu duhet ta bëjmë, atëherë ne do ta shkelim sistemin dhe ne nuk do të realizojmë autoritetin tonë që e kemi këtu si Kuvend ose autoritetin tonë që e kemi si Qeveri.

Sa i përket ligjeve të caktuara të cilat ndërlidhen me emrin e ministrit, unë mund t'ju them se Ligji për amnistinë është aprovuar këtu në Kuvend dhe është aprovuar më shumë se me 2/3 e votave të deputetëve. A është i mirë a është i keq, ajo është çështje tjetër, por nuk është ligj personal, as i ministrit as i Qeverisë, është ligj të cilin e ka aprovuar Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Sa i përket Gjykatës Speciale, unë po ju them diçka këtu sot, të cilën ndoshta nuk e kisha thënë haptas, po qe se mos të ishte zoti Kuçi, i cili me përgjegjësinë më të madhe është sjell deri më tani, edhe te ndryshimet kushtetuese, edhe te Ligji për dhomat e veçanta ndoshta kjo punë kishte për të shkuar pak më shpejt se sa po shkon tash.

Unë ju garantoj se ky njeri po angazhohet dhe është angazhuar me këmbëngulje që të bëhen ndryshime dhe që të ushtrojmë ndikim në mënyrë që ligjet mos t'i marrim bash ashtu si janë propozuar, por ato të jenë ligje të cilat reflektojnë më shumë në specifikat tona dhe në interesin tonë. Dhe këtë e ka bërë zoti Kuçi, s'po e lavdëroj, sepse në qoftë se shikojmë mbi baza partiake, edhe pse jemi në koalicion, unë do të flisja ndryshe, mirëpo në këtë rast unë flas si njeri, sepse zotin Kuçi nuk e njoh si ministër, e njoh edhe si profesor, e njoh edhe më parë, prandaj nuk e lidhi as subjektivitetin as angazhimin e tij dhe moralin e tij profesional vetëm me pozitën e tij si ministër të Drejtësisë së Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Mirëpo është angazhuar dhe po angazhohet dhe në qoftë se e gjithë kjo ndërlidhet si kërthizë me problemin e Gjykatës Speciale, po ju them se ky ministër është angazhuar maksimalisht, por mbetet ashtu siç tha ai në vullnetin e deputetëve, a do ta përkrahin apo s'do ta përkrahim. Ato do të vinë në Kuvend, do të vjen edhe propozimi lidhur me ndryshimin e Kushtetutës, do të vjen edhe propozimi lidhur me Ligjin për dhomat e veçanta.

Sa i përket luftës së korrupsionit, ju lutem këtë punë ne duhet ta bëjmë të gjithë. Më së pari korrupsionin duhet nisur luftuar te vetvetja. Hajde ta shikojmë ne këtu në Kuvend dhe në Qeveri, kah e kemi krijuar pasurinë tonë, çfarë pasurie keni, kah e kemi bërë, a jeni në rregull apo s'jeni, të nisemi prej veti dhe të shikojmë më tutje, edhe në gjyqësi, edhe në Prokurori, edhe në agjenci të pavarura, edhe në kompani publike, sepse gjithkund mund të gjejmë hapësirë. Dhe në qoftë se ne e bëjmë këtë, atëherë ne nuk kemi nevojë ta kritikojmë njëri-tjetrin, me u nda pozitë dhe opozitë, hajde të shohim si individë ku jemi në këtë aspekt dhe po ashtu mbetem i obliguar që ta jap një përgjigje lidhur me Fabrikën e Gypave.

Nuk është kryeministri ai i cili nuk po e realizon vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Në qoftë se vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka karakter ekzekutiv, atëherë do të ekzekutohet vendimi i Gjykatës Kushtetuese. Do të gjenden mjetet, më mirë është mjetet të prehen nga buxheti dhe ne s'kemi çfarë të bëjmë.

Ai vendim është sjellë dhe në qoftë se ne fillojmë të përkrahim vendime të tilla dhe të zbatojmë vendime të tilla, unë ju garantoj se ne do ta shesim Kosovën për të paguar kompensimet prej vitit 90 e këndeje të punonjësve që kanë mbetur pa punë. Është e vërtetë që ata janë dëmtuar, mirëpo urdhëroni ju si deputetë dhe ne si Qeveri t'i gjejmë paratë, ku i kemi paratë për shitjen dhe kompensimin e të gjitha kompanive publike dhe për kompensimin...

(Ndërhyrje)

Jo, jo! S'është e vërtetë që kemi thënë se do t'i paguajmë. Të gjithë kemi thënë se ato mjete të cilat janë në AKP, të destinuara, në AKP e dini ju mirë, sepse asnjë prej jush s'është që s'e din do të thotë si ruhen mjetet e AKP-së në mirëbesim dhe ato mjete në mirëbesim ruhen në çdo llogari për çdo firmë e cila është shitur dhe ne s'mund t'i përdorim paratë e firmave të tjera për Fabrikën e Gypave. Mund të përdoren aty – që janë 2 milionë e 700 mijë, me pretendime edhe të tjerëve, pasi që të kompletohet Bordi i AKP-së.

Prandaj, edhe po përfundoj. Ne jemi të interesuar që të forcohet shteti ligjor, jemi të interesuar që maksimalisht ta përkrahim sistemin e drejtësisë, jemi të interesuar që ta përkrahim dhe inkurajojmë Ministrinë e Drejtësisë që ta bëjë punën e vet edhe më tutje dhe vlerësojmë se në këtë mandat, sepse unë flas për këtë mandat, a ju pëlqen apo s'ju pëlqen është punë tjetër, unë flas për këto 5 muaj, unë s'flas për mandatin e kaluar, sepse mandati i kaluar ka pasur autoritet tjetër dhe përbërje tjetër, prandaj për këtë mandat, ministri Kuçi është duke e bërë punën e tij si duhet dhe për këtë mandat, pa marrë parasysh dallimet tona partiake, për të cilat ne jemi shprehur në fushatë dhe unë s'i tërheq ato fjalë, sepse i kemi thënë në fushatë, jemi marrë vesh që ne të kemi një përbërje të Qeverisë, prej anëtarëve të Qeverisë, në momentin kur e kemi bërë koalicionin, e cila mund të korrespondojë në mes veti, e cila mund të punojë në mes veti dhe në cilën ne s'mund ta kemi asnjë njeri i cili ka problem me ligjin dhe i cili ndiqet penalisht ose ka kryer ndonjë vepër penale.

Prandaj, ne këtë po e respektojmë dhe këtë do ta bëjmë. A na pëlqen apo s'na pëlqen të gjithë neve, është punë tjetër. Natyrisht që opozita pozicionin e ka për të mos e pëlqyer e të bëjë vërejtje dhe unë fare nuk ia shoh për të madhe, mirëpo po ashtu shoh interes që të bashkëpunojmë me opozitën dhe ne të gjejmë zgjidhje e cila do të çonte te forcimi i shtetit ligjor dhe te funksionalizimi shumë më i mirë i sistemit të drejtësisë, jo i Ministrisë dhe ministrit, por i sistemit të drejtësisë në përgjithësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Donika Kadaj-Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Faleminderit kolegë deputetë, të cilët morët pjesë në këtë interpelancë dhe në këtë debat!

Më lejoni që ta përmbyll me disa konkluzione që i nxjerri kjo interpelancë, edhe pse u thirr për çështjen e drejtësisë ne, në fakt kuptuam edhe disa veprime të tjera të cilat erdhën nga kryeministri Mustafa.

Kryeministri Mustafa, me qëllim të qëndrojë në pushtet, sot provoi të amnistojë veprimet dhe veprat të cilat jo shumë kohë më parë i quajti si në vijim.

Më 4 qershor të vitit 2014, ju i nderuar kryeministër thatë kështu:

S'mund të qeverisim me PDK-në se e kanë lëshuar rrjetin thellë. Po citoj “Kjo qeverisje e ka ngulfat shtetin, e ka lëshuar rrjetin e saj aq thellë, dhe ne nuk do të bëjmë asgjë nëse vazhdojmë të qeverisim me ta. Do të qeverisim me rrjetin e tyre”, Kështu ka deklaruar kryeministri Mustafa.

Më 24 korrik 2014, përsëri keni deklaruar kështu: “Qeverisja e PDK-së e ka rrënuar shtetin ligjor, e ka kultivuar korrupsionin dhe e ka ngulfatur fjalën e lirë. Është vjedhur Dhoma e Dëshmive në objektet e Ministrisë së Punëve të Brendshme, është korrumpuar procesi i shtypjes së pasaportave, ekzekutivi vendos se kush duhet të burgoset e kush të prangoset, e jo shtylla e drejtësisë.

Edhe një herë po theksoj, e keni thënë: Ekzekutivi vendos se kush duhet të prangoset e jo shtylla e drejtësisë.

Në krye të shtyllës së drejtësisë, në ekzekutiv ka qenë i njëjti ministër për të cilin ju tash deklaruat se po e bën një punë të shkëlqyeshme, të jashtëzakonshme dhe që jeni shumë i kënaqur. Do të thotë, bëhet fjalë për ministrin e njëjtë për të cilin pak kohë më parë, ende një vit nuk është, ju keni thënë eksplicit që e ka thelluar, e ka shtrirë rrjetin e krimit, të korrupsionit dhe po vendos kush të prangoset dhe kush mos të prangoset. Do të thotë, këto janë deklarata publike, kryeministër!

Tashti, në momentin në të cilin ne po flasim, si mund të besojmë si Kuvend që ju keni vullnet të mirë? Si mund të ju besojnë qytetarët e Republikës së Kosovës që ju atë çfarë e thatë se keni vullnet të mirë ta vazhdoni luftën kundër korrupsionit, krimit, çkapjen e shtetit, i thatë ju, do të ndodhin për deri sa jeni i njëjti person i cili jo shumë kohë më parë në publik i tha këto fjalë për njeriun të cilin sapo e lavdëruat.

Prandaj, në emër të tri partive të opozitës ne edhe një herë po e lexojmë pikën e parë të Rezolutës, e cila kërkon shkarkimin e ministrit të Drejtësisë, por duhet t’ia shtojmë dhe një pikë të dytë ku t’ju kërkohet juve dorëheqja, sepse në këtë formë është krejt e pamundur të besohet se ju mund të përmirësoni sistemin ose që keni vullnet politik, ose guxim, ose që keni energji dhe kurajë që t’i luftoni të këqijat që e kanë kapluar Republikën e Kosovës.

Faleminderit dhe të nderuar kolegë deputetë, që vini nga partitë e opozitës, mos lejoni që në proceset që na presin të abuzohet me votën tuaj, mendoni mirë para se të votoni, sepse sot u pa se Qeveria po provon të largohet nga përgjegjësia për tema të cilave u ka pri. Ne jemi Kuvend, jemi përgjegjës për veprimet tona dhe si të tillë ju thërras që të veproni konform përgjegjësisë që e kemi marrë në emër të qytetarëve të vendit tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani do të futemi në votim, por para se të futemi në votim, propozimin e dytë për kryeministrin nuk e votojmë, sepse në qoftë se domi të bëjmë mocion për kryeministrin, rrugën e kemi të lirë të bëjmë mocion të ri. Pjesën tjetër të mocionit që e keni bërë të tri partitë, e vë në votim dhe votojmë tani:

Pra, 39 vota janë kundër, 1 abstenim dhe 22 për, nuk miratohet. Prandaj, konstatoj se Kuvendi nuk e miratoi Propozim rezolutën të propozuar nga deputetja Donika Kadaj-Bujupi, për ushtrimin e kompetencave kushtetuese lidhur me nenin 94 paragrafi 1.

Të nderuar kolegë, ju lutem! Zotërinj deputetë, ju lus edhe për 5 minuta që t’i votojmë pikat që kanë mbetur. Prandaj kemi vetëm votim dhe ju kisha lutur që të qëndroni në sallë, e të mos na mbeten barrë për seancën e ardhshme.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat personale

Të nderuar kolegë, ju lus të votoni!

Konstatohet se me 52 vota për, 1 abstenim dhe 10 kundër, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin numër 05/L-28 për tatimin në të ardhurat personale.

Kërkohej nga Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, të shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportin me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave

Regjia dhe deputetët bëhemi gati për votim dhe votojmë tash.

Konstatohet se me 46 vota për, 3 abstenime dhe 13 kundër, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin numër 05/L-29 për tatimin në të ardhurat e korporatave.

Kërkohej nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit të shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportin me rekomandime.

6. Shqyrtimi i Raportit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2014

Votojmë tash!

Konstatohet se me 52 vota për, 6 abstenime dhe 3 kundër miratohet Raporti vjetor i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për vitin 2014.

7. Shqyrtimi i raportit të Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2014.

Votojmë tash!

Faleminderit! Konstatohet se me 58 vota për, 3 abstenime dhe 1 kundër, Kuvendi e miratoi raportin vjetor të Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2014. Mirupafshim në seancën e ardhshme!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*